



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në  
“Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni”  
iInstitucionit të Arsimit të Lartë  
“Instituti Kanadez i Teknologjisë (IKT)”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Arjan Qefalia

2. Dr. Adisa Daberdini

Korrik 2022

**Raport i Grupit Të Vlerësimit Të Jashtëm**  
**Për Programin e Studimit Bsc Në Administrim Biznesi Dhe Teknologji Informacioni**  
**Ofruar Nga Institucioni i Arsimit Të Lartë Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i**  
**Teknologjisë (CIT)”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Administrim biznesi dhe Teknologji Informacioni
4	Urdhëri/VKM i licensimit:	VKM e MASH nr.781, datë 10.11.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr.420, datë 09.12.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër iMAS nr.138, datë 25.03.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	19 PAE/0 PAK v.a. 2021-2022 21 PAE/0 PAK v.a. 2020-2021 19 PAE/1 PAK v.a. 2019-2020
18	Numri i studentëve:	16 Studentë v.a. 2021-2022 29 Studentë v.a. 2020-2021 30 Studentë v.a. 2019-2020
19	Komente / të tjera:	-

# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Përshkrim përmbledhës

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni” është një program studimi me kohë të plotë, me 180 kredite, që ofrohet në 6 semestra apo 3 vite akademike, në përfundim të të cilave merret diploma me profilin përkatës. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është licencuar në zbatim të ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë si shkollë e lartë universitare private bazuar në Vkm Nr.781, Datë 10/11/2011 “Për Licencimin E Shkollës Së Lartë Universitare Private Instituti Kanadez I Teknologjisë, Tiranë”. Me Urdhërin Nr.68, Datë 27/02/2012, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, ky institucion është pajisur me leje për fillimin e veprimtarisë mësimore e kërkimore dhe akademike të programeve të studimit në përputhje me licencën e dhënë, duke filluar veprimtarinë e saj akademike qysh në fillim të vitit mësimor 2011-2012.

Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni”, ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit, njësi e vendosur në Fakultetin e Ekonomisë.

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” ka përcaktuar qartë drejtimit prioritarë akademike në dokumentat e veta strategjike dhe synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave në përputhje me kërkesat e “Kartës së Bolonjës” dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës. Realizimi i këtyre prioritetëve synohet nëpërmjet përmbushjes së misionit të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” të përcaktuar në Statutin e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (siç cilësohet tek Aneksi I & I.1 i tij).

Përgjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me këto prioritetë. Ofrimi i programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni”, emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”. Ky program studimi ofron njohuri teorike dhe aftësi praktike në menaxhim dhe administrim biznesi, teknologji informacioni, ekonomiks, financë, kontabilitet, etj. Studenti, i cili zotëron një diplomë të tillë mund të punësohet në institucione të ndryshme si specialist në sektorin e Menaxhimit/Administrimit dhe Teknologjisë së Informacionit, si në sektorin publik edhe atë privat.

Ky raport u përgatit nga ana e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm dhe ka për qëllim vlerësimin në kuadër të ri-akreditimit për programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni”.



## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të kontratuar nga ASCAL. Për hartimin e raportit, veç raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentave mbështetës të sjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën dy ditore që kreu në institucion, si dhe mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacion të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm dhe Cilësisë, etj.

Në bazë të vlerësimit kanë qenë kriteret e vendosura në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i dokumentave dhe rishikimi i kriterëve e kërkesave ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit Bachelor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Vizitat në institucion u kryen në datën 16 dhe 17 Mars 2022. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që ligjërojnë, sigurimit të cilësisë, etj.

Institucioni dorëzoi dokumentat dhe evidencat e nevojshme për akreditimin në format elektronik tek ASCAL, dhe gjithashtu gjatë vizitës së GVJ në institucion u paraqitën evidenca të ndryshme për të mbështetur aplikimin e tyre për akreditimin e programit të studimit të nivelit Bachelor në “Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni”. Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni është i atashuar pranë Fakultetit të Ekonomisë.

Koordinator teknik i ASCAL gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm është MSc. Muhamed Prezja.

GVJ pasi u njoh me komentet e insitucionit rreth draft RVJ-së, shprehet si më poshtë:

**Sqarim:**GVJ në hartimin e RVJ është bazuar në evidencat e dorëzuara nga IAL IKT pranë ASCAL para dhe pas vizitës fizike në IAL IKT, si dhe bazuar në vizitën dhe diskutimet & takimet e bëra në IAL IKT. Lidhur me komentet e IAL IKT në shkresën e cituar më lart, keqkuptimi ka ardhur bazuar tek **file i llojit pdf** (i dërguar nga IAL IKT në mënyrë elektronike tek ASCAL) i titulluar:**Plani mesimor BSc Administrim Biznesi dhe IT shqip 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022.pdf** ... ku nga formatimi i tabelës së skanuar ... është pak më e spostuar majtas pjesa e poshtme e tabelës në faqen e dytë dhe faqen e tretë, dhe duke mos patur emërtim të rreshtit në krye (të kokës) së tabelës (në faqen e dytë dhe të tretë) me lëndët, tipologjitë dhe kreditet për vitin e tretë, ku kreditet e lëndëve për kategorinë B janë spostuar (janë në të njëjtën linjë) në kollonën e lëndëve të kategorisë A ... gjë që ka sjellë një keqkuptim?!

Sa më sipër, në mënyrë më të detajuar, qëndrimet e GVJ jepen si vijon:

**Lidhur me kriterin e Standardit I.3.3:** Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij ... **Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë**

*përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve; dhe Lidhur me kriterin e Standardit II.1.1: Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi ... *Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS):**

Komenti i GVJ: Tek kriteret më lart, komenti do të jetë: Por sugjerohet nga GVJ që veprimtaritë formuese: kategoria C (përqindjet e krediteve të lëndëve) të përshtaten sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018 - PËR ELEMENTËT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA IAL, e ndryshuar.

Lidhur me kriterin e Standardit II.1.6: Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi ... *Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite:*

Komenti i GVJ: Tek kriteri më lart, komenti do të jetë: Duke u mbështetur në dokumentat e vëna në dispozicion, GVJ konstatoi se programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacionii ka të përcaktuara veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori:

- Kategoria A: Lëndë të formimit të përgjithshëm (bazë), 5 lëndë (30 ECTS).
- Kategoria B: Lëndë të formimit karakterizues - përgatitje për disiplinën shkencore, 16 lëndë (96 ECTS).
- Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese - grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje, 5 lëndë (30 ECTS).
- Kategoria D: Lëndë plotësuese - gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 3 lëndë (18 ECTS).
- Kategoria E: Detyrime përmbyllëse - punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues, (6 ECTS).

Por sugjerohet nga GVJ që veprimtaritë formuese: kategoria C (përqindjet e krediteve të lëndëve) të përshtaten sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018 - PËR ELEMENTËT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA IAL, e ndryshuar.

Lidhur me kriterin e Standardit II.3.2: Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë ... *Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi:*

Komenti i GVJ: Tek kriteri më lart, komenti do të jetë: Duke u mbështetur në dokumentat e vëna në dispozicion, GVJ konstatoi se programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni është i organizuar në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. IAL IKT ka hartuar dhe miratuar rregulloret e veta të funksionimit dhe organizimit (të cituara dhe në kriteret e mëparshme të RVJ) në


përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, dhe në përputhje me këto rregullore, kurrikula e programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni ka të përcaktuara qartë lëndët, modulet, praktikën dhe aktivitetet formuese të këtij programi studimi. Ky program studimi i ka të përcaktuara veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori:

- Kategororia A: Lëndë të formimit të përgjithshëm (bazë), 5 lëndë (30 ECTS).
- Kategororia B: Lëndë të formimit karakterizues - përgatitje për disipinën shkencore, 16 lëndë (96 ECTS).
- Kategororia C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese - grupe disipinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje, 5 lëndë (30 ECTS).
- Kategororia D: Lëndë plotësuese - gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 3 lëndë (18 ECTS).
- Kategororia E: Detyrime përmbyllëse - punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues, (6 ECTS).

Ndarja specifike është e pasqyruar tek Plani Mësimor i Programit të Studimit të Ciklit të Parë BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni. Numri i lëndëve-moduleve më vete të ndara është 28, duke shtuar edhe praktikën mësimore dhe mbrojtjen e diplomës, janë 30. Sipas planit mësimor, në vitin e tretë përgjatë një muaji të semestrit të dytë, studenti frekuenton Praktikën Mësimore e cila është 6 ECTS, ose 120 orë, ndërkohë që po në fund të semestrit të dytë të vitit të tretë ai mbron edhe temën e diplomës e cila është 6 ECTS. Sugjerohet nga GVJ që veprimtaritë formuese: kategororia C (përqindjet e krediteve të lëndëve) të përshtaten sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018 - PËR ELEMENTËT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA IAL, e ndryshuar.

Lidhur me kriterin e Standardit II.4.5:Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënimit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës ... Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve:

Komenti i GVJ: Tek kriteri më lart, komenti do të jetë: Sugjerohet nga GVJ që veprimtaritë formuese: kategororia C (përqindjet e krediteve të lëndëve) të përshtaten sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018 - PËR ELEMENTËT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA IAL, e ndryshuar.



## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

### I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në VKA nr.86, datë 02.11.2015 miratuar me Urdhër MAS Nr. 138 datë 25.03.2016, janë:

Programi është akredituar për herë të parë me Urdhër të MAS nr.138 datë 25.03.2016 për një periudhë 6-vjeçare bazuar ne VKA nr.86, datë 02.11.2015, vendim në të cilin nuk janë dhënë rekomandime.

### II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Institucioni nuk ka marrë asnjë rekomandim nga vlerësimi i mëparshëm i programit të studimit Bachelor në “Administrim biznesi dhe Teknologji Informacioni”.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në**  
**“Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni”**

**I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “IKT” ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare, gjë që theksohet qartë në vizionin dhe misionin e KU “IKT”, të përcaktuar në nenin 4 të Statutit dhe në Planin Strategjik të tij, ku thuhet se vizioni është ... që të përgatisë studentë me aftësi të mbështetura mbi edukimin, vlerat dhe shpirtin etik, mendimin kritik, atë analitik dhe të orientuar drejt zgjidhjes së problemeve, kreativitetit, inovacionit dhe lidershit, të cilat ata do t'i përdorin për t'i dhënë formë jetës, karrierës dhe shoqërisë; dhemisioni ... është që përmes promovimit të kurrikulave të përgatitura me kujdes, mësimdhënies, kërkimit shkencor, hapjes së programeve të reja, IKT synon zhvillimin e aftësive personale dhe mundësive, nxitjen e konkurrencës dhe përmirësimit të cilësisë së edukimit në shërbim të vlerave, duke vlerësuar dhe respektuar diversitetin kulturor dhe vlerat kombëtare.</p> <p>Mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstaton se programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioninuk bie ndesh me interesat kombëtare.</p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016; neni 4 Aneksi 3. Plani Strategjik dhe Biznesi Plani KU IKT , miratuar me VSA nr.5/1, 24.05.2012</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Kolegji Universitar “IKT” i ka hartuar programet e studimit në përputhje me ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. GVJ e konstaton këtë, në dokumentat strategjike të institucionit, konkretisht tek Statuti dhe Plani Strategjik, sipas të cilave vizioni është ... që të përgatisë studentë me aftësi të mbështetura mbi edukimin, vlerat dhe shpirtin etik, mendimin kritik, atë analitik dhe të orientuar drejt zgjidhjes së problemeve, kreativitetit, inovacionit dhe lidershit, të cilat ata do t'i përdorin për t'i dhënë formë jetës, karrierës dhe shoqërisë; dhemisioni ... është që përmes promovimit të kurrikulave të përgatitura me kujdes, mësimdhënies, kërkimit shkencor, hapjes së programeve të reja, IKT synon zhvillimin e aftësive personale dhe</p>





	<p><i>mundësive, nxitjen e konkurrencës dhe përmirësimit të cilësisë së edukimit në shërbim të vlerave, duke vlerësuar dhe respektuar diversitetin kulturor dhe vlerat kombëtare.</i></p> <p><i>Evidenca:</i>  Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016; neni 4  Aneksi 3. Plani Strategjik dhe Biznes Plani KU IKT , miratuar me VSA nr.5/1, 24.05.2012</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit, misionin si dhe qëllimet e KU "IKT" për tu profilizuar në programe të ciklit të parë dhe të dytë në fushën e administrimit të biznesit dhe teknologjisë së informacionit. Ky program është hapur dhe ka funksionuar në përputhje me Studimin e Tregut si dhe Planin Strategjik &amp; Biznes Planin, miratuar prej Senatit Akademik përmes vendimit nr.5/1, datë 24.05.2012.</p> <p>Sipas nenit 4 të Statutit, IAL IKT e shpreh angazhimin drejt misionit të tij sipas qëllimeve të përcaktuara si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ofrimin e arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese në fushën e inxhinierisë dhe ekonomisë.</li> <li>- Zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike.</li> <li>- Formimin e studjuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit në inxhinieri dhe ekonomi.</li> <li>- Thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e inxhinierisë dhe ekonomisë.</li> <li>- Kryerjen e studimeve kërkimore-shkencore për të zhvilluar aplikime dhe inovacione.</li> <li>- Kontribuimin në mbështetjen e prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit.</li> </ul> <p>Mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstaton se programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit duke ofruar kurrikula dhe mësimdhënie cilësore &amp; bashkëkohore.</p> <p><i>Evidenca:</i>  Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016; neni 4  Aneksi 3. Plani Strategjik dhe Biznes Plani KU IKT , miratuar me VSA nr.5/1, 24.05.2012</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Sipas dokumentave të vëna në dispozicion, GVJ konstaton se nëpërmjet këtij programi, Kolegji Universitar "IKT" ka synuar të ofrojë studime në përputhje me nevojat aktuale të tregut lokal dhe kombëtar. Studimet që ka bërë IKT mbi kërkesat e tregut në këtë drejtim, kanë ndihmuar në përputhshmërinë e këtij programi me nevojat e tregut të punës. Programi BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni është</p>



	<p>projektuar për të përgatitur studentët për karrierë sipas kërkesave teknike të industrisë vendase dhe asaj të huaj në fushën e administrimit dhe menaxhimit të biznesit &amp; teknologjisë së informacionit, etj., si dhe për studime të mëtejshme në nivelin master në këtë fushë ose në fusha të ngjashme. Baza e programit është fokusuar në ndërtimin e mendimit kritik me të cilin merren vendime profesionale si dhe për të qenë një vlerë e shtuar për vendin dhe të ardhmen në vend dhe më gjerë. Si një program i ciklit të parë, ai përgatit specialistë të aftë në fushat përkatëse të cilët kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar, qoftë ky kontribut në rang specialisti ose në rang sipërmarrësi.</p> <p>Të diplomuarit në këtë program studimi fitojnë njohuri teorike dhe aftësi praktike në menaxhim biznesi, informatikë, ekonomiks, financë, kontabilitet, etj, dhe studenti i cili zotëron një diplomë të tillë mund të punësohet në institucione të ndryshme në sektorin e Menaxhimit të Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit, si në sektorin publik edhe atë privat.</p> <p><i>Evidenca:</i>  Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016; neni 4  Aneksi 3. Plani Strategjik dhe Biznes Plani KU IKT , miratuar me VSA nr.5/1, 24.05.2012</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/Bachelor-in-Business-Administration-and-Information-Technology">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/Bachelor-in-Business-Administration-and-Information-Technology</a></p> <p>Aneksi D1. Studim i Tregut dhe Plan Financiar 2016  Aneksi 18. Studimi i Tregut (Feasibility Study) 2011</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

**Standardi I.2**

**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni është hapur në përputhje me Studimin e Tregut të bërë në vitin 2011. Gjatë studimit të tregut vendas ashtu si dhe duke marrë parasysh tendencat kombëtare dhe ndërkombëtare të kohës, është konstatuar kërkesa e lartë për specialistë në fushën e ekonomisë e më konkretisht në fushat specifike si ajo e administrimit të biznesit dhe IT. Nga KU IKT, ky program studimi është parë si mundësi për të ofruar edukim cilësor dhe bashkëkohor si dhe për tu dhënë mundësinë studentëve shqiptarë për tu punësuar edhe përtej vendit të tyre, duke qenë se kurrikula e këtij programi do të ofrohej në gjuhën angleze. Që në fillim objektivat e programit për formimin e studentëve kanë qenë në përputhje me kërkesat ligjore dhe ato të akteve nënligjore sipas të cilave njohuritë që studentët duhet të fitonin duhet të ishin të thelluara,



	<p>shkencore, si dhe të fitonin aftësi dhe kompetenca profesionale. GVJ konstaton se programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni është hartuar në përshtatje me strategjinë e zhvillimit të vetë IAL, kjo e mbështetur tek dokumentat strategjike të tij: planin strategjik të biznesit, strategjinë e zhvillimit, studimin e tregut, etj. Sistemi i njohurive që ofrohet nga programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, si dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhdimit të studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale.</p> <p><i>Evidenca:</i>  Aneksi 18. Studimi i Tregut (Feasibility Study) 2011  Aneksi D1. Studim i Tregut dhe Plan Financiar 2016  Aneksi 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017  Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016  Aneksi 3. Plani Strategjik dhe Biznes Plani KU IKT , miratuar me VSA nr.5/1, 24.05.2012</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni ofrohet në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të institucionit, Rregullores Institucionale, Statutin e KU “IKT” neni 2, pika 1-a, 1-b, 1-c për ofrimin e programeve të studimit, dhe nenin 4: misionin &amp; vizionin e tij. Sipas Statutit të IAL IKT, misioni e përcakton qartë fushën dhe drejtimit kryesore të veprimtarisë ku theksohet se fushat kryesore në të cilat institucioni synon që të ofrojë programe studimi, si dhe të ndërtojë veprimtarinë e vet janë ato të ekonomisë dhe inxhinierisë.</p> <p>GVJ konstatoi se Kolegji Universitar “IKT”i ka përcaktuar qartë drejtimit prioritar akademike në dokumentat e veta strategjike sipas të cilave institucioni synon ndërtimin e kurrikulave të tij në përputhje me kërkesat e ‘Kartës së Bolonjës’ dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës. Gjatë vizitës në IAL IKT dhe në bazë të dokumentave të tjera të programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me këto prioritete.</p> <p><i>Evidenca:</i>  Aneksi 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017  Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016  Aneksi 1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar</p>

	<p>Aneksi6. Rregullore Institucionale e KU IKT</p> <p>Aneksi 18. Studimi i Tregut (Feasibility Study) 2011</p> <p>Aneksi D1. Studim i Tregut dhe Plan Financiar 2016</p> <p>Aneksi 3. Plani Strategjik dhe Biznes Plani KU IKT , miratuar me VSA nr.5/1, 24.05.2012</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se sipas Strategjisë së Zhvillimit, Planit të Biznesit, Statutit dhe Studimit të Tregut, Kolegji Universitar “IKT” i ka dhënë përparësi ndërtimit të kurrikulave, strukturës së programeve dhe diversitetit të diplomave e profileve në funksion të kërkesave të tregut të punës, dhe këtë gjë IAL “IKT” e ka bërë nëpërmjet ofrimit të programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, ku emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e të cilit është në përputhje me fushat e drejtimet akademike të tij.</p> <p>Sipas drejtuesve të IAL IKT, programi u projektua për të plotësuar ofertën akademike jo vetëm të institucionit por dhe mungesës që kishte në tregun e punës për specialistë cilësorë në fushën e administrimit të biznesit dhe të teknologjisë së informacionit. Programi i studimit do ishte një vlerë e shtuar dhe një mundësi e mirë për studentët që të njiheshin me fushat e kombinuara të administrimit të biznesit dhe teknologjisë së informacionit, aplikacionet e tyre, tendencat e kohës si dhe mundësinë e përfshirjes së tyre në tregun e punës vendas e ndërkombëtar. KU “IKT” ka vlerësuar nevojat e tregut, mundësitë dhe synimet strategjike kombëtare, duke hartuar një plan fizibiliteti të detajuar në të cilin janë përfshirë kryesisht tregu i punës, oferta akademike, parashikimi i përafërt i numrit të pritshëm të studentëve, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017</p> <p>Aneksi 18. Studimi i Tregut (Feasibility Study) 2011</p> <p>Aneksi D1. Studim i Tregut dhe Plan Financiar 2016</p> <p>Aneksi6. Rregullore Institucionale e KU IKT</p> <p>Aneksi 3. Plani Strategjik dhe Biznes Plani KU IKT , miratuar me VSA nr.5/1, 24.05.2012</p> <p>Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016</p> <p>Aneksi 1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi I.3

**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Mbështetur në Rregulloren e Programit të Studimit, thuhet se programi i studimit synon të pajisë studentët me: Njohuri dhe koncepte bazë në fushat përkatëse të studimit dhe njohuri të thelluara të fushës kryesore të studimit; aftësi për një profesion apo licensë profesionale; Formimin teorik dhe praktik në fushën e zgjedhur; Aftësi të zhvilluara për kërkim shkencor në fushën e studimit; Aftësi praktike, të zbatueshme dhe kërkimore; Aftësi për promovim personal dhe profesional; Tezë e punuar origjinale që tregon se si kuptohet puna e studiuesve të tjerë në fushën përkatëse.</p> <p>Programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni iu jep studentëve njohuritë bazë formuese në fushat e menaxhimit të biznesit dhe informatikës, si dhe të ekonomisë, matematikës, komunikimit në biznes, kontabilitetit, etj. me objektiv kryesor formimin e specialistëve të menaxhimit të biznesit dhe teknologjisë së informacionit dhe mundësisë për realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë. Të diplomuarit nga ky program studimi përgatiten për karrierë &amp; mundësi punësimi në çdo sektor të ekonomisë, biznesit privat dhe administratës publike. Pra, programi i studimit ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, i cili përfshin dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi D1. Studim i Tregut dhe Plan Financiar 2016</p> <p>Aneksi2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017</p> <p>Aneksi75. Studim Periodik i Punës në BA &amp; IT</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/faculty-of-economy/">https://cit.edu.al/faculty-of-economy/</a> (Programet bachelor dhe ato master ku jepen target skills dhe program structure)</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/faculty/faculty-of-engineering/">https://cit.edu.al/faculty/faculty-of-engineering/</a> (Programet bachelor dhe ato master ku jepen target skills dhe program structure)</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2021/10/Bachelor-in-Business-Administration-and-Information-Technology">https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2021/10/Bachelor-in-Business-Administration-and-Information-Technology</a>.</p> <p>Aneksi 18. Studimi i Tregut (Feasibility Study) 2011</p> <p>Aneksi6. Rregullore Institucionale e KU IKT</p> <p>Aneksi 3. Plani Strategjik dhe Biznes Plani KU IKT , miratuar me VSA nr.5/1, 24.05.2012</p> <p>Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016</p> <p>Aneksi 1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të</p>	<p>Në bazë të dokumentave të shqyrtuara si dhe nga bisedat e zhvilluara me drejtuesit e institucionit, GVJ konstatoi se Kolegji Universitar “IKT”ka zhvilluar një studim të tregut të punës periodik së këtij programi studimi, i bazuar tek të dhëna të marra nga fokus grupet, intervistat dhe anketimet&amp; pyetësorët, mbi bazë të të cilave ka qartësuar elementët bazë</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>të programit të studimit, emërtimin e programit, profilet, si dhe mundësitë për punësimin e të diplomuarve. KU "IKT" që në fillim ka vlerësuar nevojat e tregut, mundësitë dhe synimet strategjike kombëtare, duke hartuar një studim tregu të detajuar në të cilin janë përfshirë kryesisht tregu i punës, oferta akademike, parashikimi i përafërt i numrit të pritshëm të studentëve, etj, gjë e cila reliktohet dhe tek Strategjia e zhvillimit dhe Biznes Planin i IKT, dhe kuinstitucioni këtë e ka bërë duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me kompanitë më të mira në këtë fushë.</p> <p>Sipas drejtuesve të IAL IKT, Strategjia për Zhvillimin e institucionit (hartuar edhe një analizë SWOT si dhe një analizë GAP, në të cilat merren në konsideratë të gjithë elementët që duhen për mbarëvajtjen e institucionit, njësisive kryesore dhe atyre bazë si dhe programeve të ofruara) erdhi si rezultat i studimit të tregut, tryezave të ndryshme të kryera me grupet e interesit, si dhe angazhimit të institucionit për të hapur programe të reja në fushën e inxhinierisë dhe atë të ekonomisë, për të rritur ofertën institucionale, si dhe atë të njësisive kryesore.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi D1. Studim i Tregut dhe Plan Financiar 2016</p> <p>Aneksi 18. Studimi i Tregut (Feasibility Study) 2011</p> <p>Aneksi75. Studim Periodik i Punës në BA &amp; IT</p> <p>Aneksi2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/faculty-of-economy/">https://cit.edu.al/faculty-of-economy/</a> (Programet bachelor dhe ato master ku jepen target skills dhe program structure)</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/faculty/faculty-of-engineering/">https://cit.edu.al/faculty/faculty-of-engineering/</a> (Programet bachelor dhe ato master ku jepen target skills dhe program structure)</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2021/10/Bachelor-in-Business-Administration-and-Information-Technology">https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2021/10/Bachelor-in-Business-Administration-and-Information-Technology</a>.</p> <p>Aneksi6. Rregullore Institucionale e KU IKT</p> <p>Aneksi 3. Plani Strategjik dhe Biznes Plani KU IKT , miratuar me VSA nr.5/1, 24.05.2012</p> <p>Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016</p> <p>Aneksi 1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësi, shkathësi dhe kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni është një program me 180 ECTS, i cili organizohet në tre vite akademike me nga 60 ECTS në secilin vit. Struktura e programit i është përmbajtur kategorive A, B, C, D, dhe E për lëndët sipas kategorive formuese dhe objektive formuese të lidhur ngushtësisht me pritshmëritë e të nxënit. Programi BSc në "Administrim biznesi dhe Teknologji informacioni" synon t'u ofrojë studentëve aftësi, njohuri dhe kompetenca thelbësore në fushat kryesore të: Menaxhimit, Administrimit, Teknologjisë së informacionit, Softeve dhe harduereve,</p>

etj. Ky program është krijuar për të përgatitur studentët për të manaxhuar biznese dhe për të shërbyer te bizneset me aspektet e menaxhimit, administrimit dhe teknologjisë së informacionit për të maksimizuar fitimet si dhe u jep studentëve mundësinë për të zhvilluar aftësi analitike dhe sasiore, duke i pajisur ata me njohuritë e nevojshme për të ndjekur karrierë në fushën e administrimit të biznesit dhe teknologjisë së informacionit.

Përveç kombinimit të disiplinave teorike dhe praktike, menaxhimit dhe teknologjisë së informacionit, një vlerë e shtuar e këtij programi studimi është se studentët nxënë në mënyrë të integruar të dy fushat e sipërpërmendura si fusha që plotësojnë mirë njëra-tjetrën dhe bëjnë të mundur që përmes përvetësimit të njohurive mbi to studentët të ndjekin një karrierë të suksesshme në tregun e punës.

Aftësitë e synuara të programit BSc në “Administrim Biznesi dhe Teknologji informacioni” janë: Zhvillimi i kompetencave kritike të menaxhimit në disiplinat kryesore të biznesit; Zhvillimi i një baze të fortë teorike dhe të aplikuar në teknologjinë e informacionit dhe shkencat kompjuterike; Zhvillimi i aftësive matematikore dhe statistikore të nevojshme për analizën financiare; Zhvillimi i një kuptimi të detajuar të teorive ekonomike që mbështesin vendimmarrjen e biznesit; Zhvillimi i një kuptimi të detajuar të ndikimit të globalizimit në praktikën dhe mundësitë e menaxhimit; Zhvillimi i aftësive efektive të punës në ekip dhe lidhshmëri; Zhvillimi i aftësive të komunikimit dhe prezantimeve; Zhvillimi i aftësive të komunikimit me shkrim; Zhvillimi i aftësive kërkimore kritike dhe analitike, etj.

Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi dhe Teknologji informacioni” është zhvilluar për të kontribuar në ndërtimin e kapaciteteve shumë të nevojshme dhe ngritjen e vazhdueshme profesionale në fushën e administrimit të biznesit dhe teknologjisë së informacionit. Nga ana tjetër për të garantuar që dijet e përfituara i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve, IAL IKT ka kryer takime të vazhdueshme ku ka ndarë me ish studentë/alumni mendimet mbi përvojat e tyre personale në tregun e punës dhe ka kërkuar sugjerime për ndryshime dhe përmirësime të mundshme.

***Por sugjerohet nga GVJ që veprimtaritë formuese: kategoria C (përqindjet e krediteve të lëndëve) të përshtaten sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018 - PËR ELEMENTËT E PRORAMAVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA IAL, e ndryshuar.***

*Evidenca:*

Aneksi 10. Rregulloret e programit BA&IT

Aneksi D1. Studimi i Tregut dhe Plan Financiar 2016

Aneksi 18. Studimi i Tregut (Feasibility Study) 2011

Aneksi 75. Studim Periodik i Punës në BA & IT

Aneksi 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017

Linku: <https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2021/10/Bachelor-in->



	<p>Business-Administration-and-Information-Technology.</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2021/10/Bachelor-in-Business-Administration-and-Information-Technology_(Program_structure)">https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2021/10/Bachelor-in-Business-Administration-and-Information-Technology (Program structure)</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2021/10/SKILLS-BA-Business-Administration-and-Information-Technology">https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2021/10/SKILLS-BA-Business-Administration-and-Information-Technology</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/faculty-of-economy/">https://cit.edu.al/faculty-of-economy/</a> (Programet bachelor dhe ato master ku jepen target skills dhe program structure)</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/faculty/faculty-of-engineering/">https://cit.edu.al/faculty/faculty-of-engineering/</a> (Programet bachelor dhe ato master ku jepen target skills dhe program structure)</p> <p>Aneksi6. Rregullore Institucionale e KU IKT</p> <p>Aneksi 3. Plani Strategjik dhe Biznes Plani KU IKT , miratuar me VSA nr.5/1, 24.05.2012</p> <p>Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016</p> <p>Aneksi 1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar</p> <p>RVB e IAL IKT</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi I.4

**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>GVJ u informua gjatë bisedave me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit BSc në "Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni" se institucioni ofron kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e këtij programi studimi duke marrë në konsideratë bashkëpunimin e departamenteve. Konkretisht, KU IKT dhe Fakulteti i Ekonomisë për realizimin e këtij programi mësimor është mbështetur dhe vijon të mbështetet nëpërvojën e stafit akademik me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie dhe eksperiencë ndërkombëtare; stafit akademik që ka kryer studimet në universitete të njohura jashtë vendit; në infrastrukturën mbështetëse laboratorike dhe në literaturën e përzgjedhur ndërkombëtare, etj.</p> <p>Gjatë vitit 2021 – 2022 për realizimin e programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni janë angazhuar 19 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 0 pedagogë si personel akademik me kontratë (PAK). Titujt dhe gradat shkencoretë personelit akademik janë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 pedagogë me titullin akademik Profesor i Asociuar;</li> <li>- 9 pedagogë me gradën Doktor;</li> <li>- 2 pedagogë në proces doktorature;</li> <li>- 5 pedagogë me kualifikimin MSc.</li> </ul>



	<p>Personeli akademik, ndihmës, mësimitor-shkencor dhe administrativ i institucionit kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për zhvillimin dhe sigurimin e cilësisë në IKT, këshillim për studentët, dhënie e ndihmës për studentët/tutorial, si dhe detyrat administrative në funksion të mësimdhënies. Angazhimi i personelit është në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe me strategjinë për zhvillimin e IAL. Përmirësimet e përvitshme në programet e lëndëve si dhe në literaturën mësimore, ashtu si dhe ato që vijnë si rezultat i ndryshimeve brenda njësisë bazë ose atyre kryesore, nuk çenojnë objektivat e programit dhe as menaxhimin e tij.</p> <p><b>Konstatohet nga GVJ që disa titullarë lëndësh (të paktën 6 të tillë) janë me gradën MSc; sugjerohet në të ardhmen që titullarët e lëndëve të jenë të paktën me gradën shkencore Dr.</b></p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi. Tabela 7 dhe 10 tek shtojca Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale Aneksi D2. Organigrama e institucionit, 2016</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit si njësi bazë përgjegjëse nën drejtimin e Fakultetit të Ekonomisë, si njësi kryesore, por duke vijuar bashkëpunimin me departamentete tjera të fakultetit. Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e këtij programi studimi është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore (dmth Fakulteti i Ekonomisë), e cila është përgjegjëse për programin e studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni. Duke u mbështetur tek dokumentat e vëna në dispozicion nga IAL IKT për strategjinë e kërkimit shkencor, GVJ konstatoi se direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane plotësohen.</p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MASR Aneksi. Plani mësimor BSc Administrim Biznesi dhe IT shqip 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022 Aneksi. Tabela 7 dhe 10 tek shtojca Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale RVB e IAL IKT Takimi me drejtuesit e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas</p>	<p>Programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni organizohet sipas sistemit të Kartës së Bolonjës me kohëzgjatje 3 vite (180 ECTS në total), dhe ofrohet në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe të departamentit përkatës. Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e këtij programi studimi është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


<p>direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>(dmth Fakulteti i Ekonomisë), e cila është përgjegjëse për programin e studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni. KU "IKT" i ka të gjitha kapacitetet, përvojën dhe burimet e duhura për të ofruar programin e studimit në fushën e përmendur më sipër. IKT është IAL që operon prej pothuajse një dekade, duke treguar që nuk i mungojnë kapacitetet dhe burimet për të ofruar me një cilësi të konsiderueshme programet mësimore të ciklit të parë, por dhe të dytë.</p> <p>Programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni është program që lidhet drejtpërdrejt me njësinë kryesore, Fakultetin e Ekonomisë dhe atë bazë, Departamentin e Administrim Biznesit. Duke u mbështetur tek dokumentat e vëna në dispozicion nga IAL IKT për strategjinë e kërkimit shkencor, GVJ konstatoi se direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane plotësohen.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MASR</p> <p>Aneksi. Plani mësimor BSc Administrim Biznesi dhe IT shqip 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022</p> <p>Aneksi. Tabela 7 dhe 10 tek shtojca</p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale RVB e IAL IKT</p> <p>Takimi me drejtuesit e IAL IKT</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Në përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, është përgjegjëse Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë. Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ është i mendimit se Kolegji Universitar "IKT" ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Marrëdhëniet brenda institucionit janë të rregulluara përmes Statutit, Rregullores Institucionale, Librit të Rregulloreve Institucionale, Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, Rregullores së Departamentit të Administrim Biznesit, Rregullores së programit të Studimit si dhe Manualit të Stafit Akademik, etj, ku përmes këtyre dokumentave harmonizohet dhe strukturohet marrëdhënia institucionale e cila saktëson qartë: organet dhe strukturat drejtuese e menaxhuese</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p>institucionale; strukturën drejtuese dhe ato mbështetëse në njësinë kryesore; strukturën bashkëpunuese dhe që ndjek detyrat si dhe menaxhon njësinë bazë; organet kolegjiale dhe ato vendimmarrëse në rang institucioni; këshillat dhe komisionet, etj.</p> <p>Në Statut përcaktohen organet drejtuese të tilla si: Senati Akademik; Rektorati; Dekanatet; Asambletë e personelit akademik të njërive kryesore; dhe autoritetet drejtuese të tilla si: Rektori; Dekanët; Përgjegjësit e Departamenteve; Drejtorët e Qendrave të kërkimit; Zv/Rektori dhe Zv/Dekanët; Administratori i Kolegjit; Administratorët e njërive kryesore. Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë përcakton dhe ndan detyrat ndërmjet hallkave menaxhuese në njësinë kryesore. Gjithashtu, në mbështetje të mbarëvajtjes së punëve brenda IAL (ashtu si dhe brenda njërive kryesore dhe atyre bazë) është hartuar dhe zbatohet edhe Manuali i Stafit Akademik (që shpjegon dhe përcakton qartë detyrat dhe të drejtat e stafit duke u bërë kështu një udhëzues i rëndësishëm për stafin e ri por edhe për stafin që ka vite që punon në institucion).</p> <p><i>Evidenca:</i>  Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016  Aneksi 1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar  Aneksi 6. Rregullore Institucionale e KU IKT  Aneksi 7. Libri i Rregulloreye Institucionale  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA&amp;IT  Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT  Aneksi 14. Manuali i Stafit Akademik Tetor 2021</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>GVJ konstaton se Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” ka krijuar lidhje dheka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, kompani, sipërmarrje, banka, organizata vendase dhe ndërkombëtare me qëllimin e vetëm që tu ofrojë studentëve dhe stafit mundësitë më të mira për zhvillimin e tyre, kjo bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion. Këto marrëveshje fokusohen në memorandume apo bashkëpunime në realizimin e praktikave mësimore; bashkëpunime afatgjata me synim mbështetjen e stafit të angazhuar në programe; sigurimin e literaturës më të mirë në gjuhën angleze; shkëmbimin e eksperiencave akademike dhe pedagogjike; njohjen e ndërsjelltë të programeve mësimore, krediteve etj.; realizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare në mbështetje të studentëve; bashkëpunime në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare; etj.</p> <p>IAL IKT synon që të garantojë mbarëvajtjen e procesit mësimor duke e mbështetur këtë gjë përmes: marrëveshjeve për shkëmbim stafi dhe studentësh në kuadër të programeve Erasmus+ (psh. me Universitetin e Kassel, Gjermani, Universitetin e Nysas, Poloni, me Universitetin Teknik të Portalegres, Portugali, me Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Sakarya, Turqi, me Universitetin e Worms, Gjermani, me Universitetin e</p>

	<p>Graz, Austri, me Universitetin Troyes, Francë, me Kolegjin Kwidzyn, Poloni, etj)&amp;CEEPUS; sigurimin e praktikave mësimore në kompani &amp; institucione publike dhe private (të tilla si: ME Communication Progress shpk; me ECSDEV; me Gea Alpine Center Ltd; me Lufthansa Industry Solutions; me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit; me Ditak shpk; me Bursën Shqiptare të Titujve ALSE; me Balfin Group; me Easy Pay shpk; me Gjeo-Vjosa; me Iaeste Albania; me Exinn Technology Center shpk; me IN2; me Postën Shqiptare; me Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare; me Procodel Security shpk; etj); bashkëpunimin me institucione homologe për realizimin e konferencave të përbashkëta shkencore si për stafin akademik ashtu dhe për studentët; etj. Disa nga marrëveshjet me IAL të tjera publike dhe jo publike brenda dhe jashtë vendit, janë: me Universitetin Politeknik, Tiranë; me Universitetin Bujqësor të Tiranës; me Universitetin Aleksandër Xhuvani, Elbasan; me Kolegjin Universitar të Biznesit, Tiranë; me Albanian University, Tiranë; me Universitetin Evropian të Tiranës; me Universitetin e Evropës Jug-Lindore, Maqedoni e Veriut; me Universitetin Aleksandër Moisiu, Durës; me Universitetin Ndërkombëtar të Vizionit, Gostivar, Maqedoni e Veriut; me Universitetin Teknik të Rigës, Letoni; me Shkollën e Lartë Private të Arsimit të lartë, Pavarësia; me Swiss Institute; me Kolegjin Profesional të Tiranës; me Universitetin Luigj Gurakuqi, Shkodër; me Universitetin Haxhi Zeka, Pejë, Kosovë; me Universitetin Ëestern Caspian, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i>  Aneksi 24. Marrëveshjet në kuader të Erasmus+ 2016-2022  Aneksi 25. Marrëveshjet me universitetet 2016 – 2022  Aneksi 26. Marrëveshje me biznesin, sipërmarrjet dhe institucione të tjera 2016 – 2022  Aneksi 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MASR</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Duke u bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion, GVJ mendon se njësia përgjegjëse për këtë program ka hartuar në mënyrë periodike raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të këtij programi studimit. Të gjitha të dhënat e mbledhura përpunohen prej zyrave përkatëse dhe publikohen në raportet vjetore të Fakulteteve si dhe në Raportin Vjetor që IAL IKT përgatit për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të dhëna të cilat përfshijnë informacione në lidhje me konferencat e organizuara, seminarët, leksionet e hapura, marrëveshjet e bashkëpunimit, mobilitetet akademike dhe ato studentore.</p> <p>Në KU “IKT”, përpunimi i të dhënave mbledhet dhe organizohet prej strukturave si Fakulteti, NjsBC apo Zyrat përkatëse si Kryesekretaria, Koordinatorët specifikë, etj. Informacioni i mbledhur përpunohet dhe prej tij nxirren të dhëna të tjera të rëndësishme të cilat përdoren prej njësisë kryesore për të hartuar raportin vjetor. Një kontribut në përpunimin e të dhënave për Fakultetet japin edhe Njësitë e Kërkimit Shkencor CIRD (Inxhinieri dhe Ekonomi), të cilat në fund të çdo viti akademik përgatisin raporte me përmbledhje të dhënash lidhur me arritjet akademike brenda fakultetit, njësisë dhe programeve.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p><i>Evidenca:</i>  Aneksi 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MASR  Aneksi65. CIRD-CIT COORP Report 2016-2018  Aneksi 24. Marrëveshjet në kuader të Erasmus+ 2016-2022  Aneksi 25. Marrëveshjet me universitetet 2016 – 2022  Aneksi 26. Marrëveshje me biznesin, sipërmarrjet dhe institucione të tjera 2016 – 2022</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së Programit të Studimit të Ciklit të Parë, BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikqyret nga Përgjegjësi i Departamentit të Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit. Kolegji Universitar “IKT” ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me disa institucione për kryerjen e praktikave profesionale.KU “IKT” dhe Fakulteti i Ekonomisë, nisur prej planit mësimor i cili saktëson kohën e zhvillimit të praktikës mësimore, ngarkesën si dhe kreditet që duhet të fitojë studenti, ndjek zbatimin e tij prej Departamentit përgjegjës për programin e studimit. Zyra e Shërbimit të Studentëve dhe Karrierës ka si detyrë parapërgatitjen e studentëve për procesin e praktikave profesionale dhe dhënien e informacionit dhe asistencës së nevojshme studentëve për gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikave profesionale/internshipeve të ofruara nga institucione partnere e më gjerë. Krahas rolit të kësaj zyre, studentëve u caktohet një pedagog mbikëqyrës, i cili ndjek zhvillimin korrekt të praktikës mësimore në institucionin pritës. Në Librin e Rregulloreve Institucionale parashikohet procedura që duhet të ndiqet prej Departamentit për organizimin e praktikave mësimore, takimet e informimit me studentët si dhe prezantimit të mundësive që ata ta kryejnë praktikën në institucionet me të cilat IKT e Fakulteti i Ekonomisëkanë marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Gjithashtu Fakulteti përveç pjesëmarrjeve në panairë punësimi, shpesh fton edhe kompani të ndryshme me ekspertë të fushës për të shpjeguar procese të praktikave profesionale që ofrohen nga institucione të caktuara që të ndajnë përvojat e tyre në auditor me studentët. Orët e praktikës të realizuara prej tyre në auditor administrohen nga pedagogët përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të praktikës.</p> <p>Kompani të tilla si Deloitte Albania, Digital Academy Albania, GIZ, Credins Bank, Luftansa Industry Solution, Balfin, IETT, UBA Bank, etj kanë zhvilluar takime me studentët gjatë viteve të fundit për t'u prezantuar atyre jo vetëm mundësitë e zhvillimit të praktikave institucionale në këto sipërmarrje, por edhe mundësitë e punësimit që ato ofrojnë.Përveç kompanive të mësipërme, për sigurimin e praktikave mësimore ka marrëveshje me kompani &amp; institucione publike dhe private të tilla si: ME Communication Progress shpk; me ECSDEV; me Gea Alpine Center ltd; me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit; me Ditak shpk; me Bursën Shqiptare të Titujve ALSE; me Easy Pay shpk; me Gjeo-Vjosa; me Iaste Albania; me Exinn Technology Center shpk; me IN2; me Postën Shqiptare; me Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare; me Procodev Security shpk; etj.</p>

	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi 26. Marrëveshje me biznesin, sipërmarrjet dhe institucione të tjera 2016 – 2022</p> <p>Aneksi. Manuali i Praktikës Mësimore Bachelor FE shqip</p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/cit-participated-in-the-eu4education-fair-at-europe-house/">https://cit.edu.al/cit-participated-in-the-eu4education-fair-at-europe-house/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/work-study-fair-at-pedonalja-murat-toptani/">https://cit.edu.al/work-study-fair-at-pedonalja-murat-toptani/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/ëork-study-fair/">https://cit.edu.al/ëork-study-fair/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/ëork-study-fair-at-pedonalja-murat-toptani/">https://cit.edu.al/ëork-study-fair-at-pedonalja-murat-toptani/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-and-business-cooperations/">https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-and-business-cooperations/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/partnership-agreement-ëith-digital-academy-albania/">https://cit.edu.al/partnership-agreement-ëith-digital-academy-albania/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/round-table-discussion-with-credins-bank/">https://cit.edu.al/round-table-discussion-with-credins-bank/</a> Shiko edhe: <a href="https://cit.edu.al/cit-welcomed-in-a-meeting-at-its-premises-the-representatives-of-credins-bank/">https://cit.edu.al/cit-welcomed-in-a-meeting-at-its-premises-the-representatives-of-credins-bank/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/internship-opportunities-at-lufthansa-industry-solutions/">https://cit.edu.al/internship-opportunities-at-lufthansa-industry-solutions/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/one-month-internship-in-web-programming/">https://cit.edu.al/one-month-internship-in-web-programming/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/cit-visit-at-uba-bank-albania/">https://cit.edu.al/cit-visit-at-uba-bank-albania/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-and-business-cooperations/">https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-and-business-cooperations/</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>GVJ konstaton se IAL IKT ofron trajnime profesionale për studentët. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion (Marrëveshjetë Bashkëpunimit, etj), evidentojmë që ofrohen prej tyre trajnime ose intershipe për studentët në mënyrë që ata të performojnë sa më mirë kur aplikojnë për një praktikë mësimore apo një vend pune. IAL IKT ka organizuar në mënyrë periodike seminare, leksione të hapura, tryeza të rumbullakta, trajnime, kompeticione, si dhe aktivitete të ndryshme për studentët. Fakulteti i Ekonomisë, ashtu si dhe Departamenti i Administrim Biznesit&amp; Teknologjisë së Informacionit janë angazhuar që tu krijojnë mundësinë studentëve që të ndërveprojnë edhe me faktorë të jashtëm përgjatë këtyre aktiviteteve. Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka IKT me kompani, sipërmarrje, banka dhe industri janë zhvilluar një sërë aktiviteteve që kanë pasur për qëllim sjelljen sa më pranë studentëve &amp; të diplomuarve/alumni të eksperiencave më të mira në treg, dhe informimin e tyre për procese të ndryshme që lidhen me fushën e tyre të studimit, dhe aftësimin e tyre me praktikën dhe metodat më të fundit. Fakulteti i Ekonomisë në IKT ka organizuar dhe ka marrë pjesë në tryeza, konferenca studentore dhe kompeticione të ndryshme; trajnime të studentëve aktualë dhe alumni; dhe mjaft leksione të hapura të organizuara në fusha të ndryshme të</p>



ekonomisë, biznesit, informatikës, financës, etj.

*Evidenca:*

Aneksi 10. Rregullore e programit BA&IT

Aneksi 26. Marrëveshje me biznesin, sipërmarrjet dhe institucione të tjera 2016 – 2022

Aneksi. Manuali i Praktikës Mësimore Bachelor FE shqip

Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale

Linku: <https://cit.edu.al/save-the-date-virtual-ëorkshop-today-27th-of-may-2021-from-1330-to-1430/>

Linku: <https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-and-business-cooperations/>

Linku: <https://cit.edu.al/nurturing-entrepreneurial-mindset-as-a-key-competence-for-innovation/>

Linku: <https://cit.edu.al/highlights-of-the-virtual-ëebinar-ëith-special-guest-mr-joseph-oconnor/>

Linku: <https://cit.edu.al/blockchain-technology-bitcoin-and-beyond/>

Linku: <https://cit.edu.al/eu-exchange-coffee-talks/>

Linku: <https://cit.edu.al/save-the-date-virtual-open-lecture-with-dr-emir-dzanic/>

Linku: <https://cit.edu.al/highlights-of-the-virtual-open-lecture-ëith-prof-dr-arbnor-pajaziti/>

Linku: <https://cit.edu.al/highlights-of-the-open-lecture-with-phd-klodian-muco/>

Linku: <https://cit.edu.al/highlights-of-the-virtual-meeting-on-erasmus-and-cits-inter-institutional-agreements-ëith-european-partner-institutions/>

Linku: <https://cit.edu.al/open-lecture-ëith-erdogan-imeri-on-the-topic-of-hoë-digital-transformation-is-revolutionizing-the-healthcare-industry/>

Linku: <https://cit.edu.al/management-of-information-systems-and-mcgraë-hill-literature/>

Linku: <https://cit.edu.al/online-open-lecture/>

Linku: <https://cit.edu.al/european-digital-week/>

Linku: <https://cit.edu.al/round-table-discussion-with-credins-bank/>

Linku: <https://cit.edu.al/cit-debate-fiscal-package-for-2022s-budget/>

Linku: <https://cit.edu.al/cit-participated-in-the-global-entrepreneurship-ëeek/>

Linku: <https://cit.edu.al/cit-experience-from-finland-to-cit-in-tirana/>

Linku: <https://cit.edu.al/monthly-students-forum-challenges-and-opportunities-of-the-entrepreneurship-in-albania/>

Linku: <https://cit.edu.al/cit-participated-in-a-ëorkshop-held-by-rcdc-albania/>

Linku: <https://cit.edu.al/u-report-albania/>

Linku: <https://cit.edu.al/highlights-of-financa-5-training-for-cit-alumni/>

Linku: <https://cit.edu.al/one-month-internship-in-ëeb-programming/>

Linku: <https://cit.edu.al/cit-team-connectit-programme/>

Linku: <https://cit.edu.al/connectit-graduation-ceremony/>

Linku: <https://cit.edu.al/first-international-hacktech-2021/>

Linku: <https://cit.edu.al/the-award-ceremony-of-hacktech-2021/>

Linku: <https://cit.edu.al/the-highlights-of-the-payroll-ceremony/>

Linku: <https://cit.edu.al/cit-supports-viaegnatia-2-0/>

Linku: <https://cit.edu.al/closing-ceremony-of-ëomen-in-tech/>

Linku: <https://cit.edu.al/visit-at-the-summer-school-of-rzeszoë->

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	university-poland/ Linku:https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-in-tirana-albania-paid-an-academic-visit-to-digitalb-headquarters/ Linku:https://cit.edu.al/ëe-paid-a-visit-to-the-tuba-bank/ Linku: https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-cit-in-tirana-albania-paid-an-academic-visit-to-credins-invest/  Linku:https://cit.edu.al/highlights-of-financa-5-training-for-cit-alumni/ Linku:https://cit.edu.al/gala-event-celebrating-class-of-2021/  Linku:https://cit.edu.al/monthly-students-forum-challenges-and-opportunities-of-the-entrepreneurship-in-albania/			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënljore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ konstatoi në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga IAL IKT: RVB, Rregullorja institucionale e Kolegjit Universitar "IKT", Forma e studimit; Rregullore e Programit; Plani Mësimor, etj, se programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, i ofruar me kohë të plotëme mësimdhënie në gjuhëangleze, është i organizuar në lëndë ose module dhe të shprehura në kredite, përkatësisht 60 kredite në vit (në total 180 kredite për tre vite studimi dhe 6 semestra), sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), dhe në përfundim të studimeve lëshohetdiploma universitare Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni.Ky program studimi është organizuar dheofrohet në përputhje me ligjin nr.80/2015, 'Për Arsimin e Lartëdhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH' si dhe me aktet nënljore.Struktura e programit i është përmbajtur kategorive A, B, C, D, dhe E për lëndët sipas kategorive formuese dhe objektivave formues të lidhur ngushtësisht me pritshmëritë e të nxënit.  <i>Por sugjerohet nga GVJ që veprimtaritë formuese: kategoria C (përqindjet e krediteve të lëndëve) të përshtaten sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018 - PËR ELEMENTËT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT</i>



	<p><b>TË OFRUARA NGA IAL, e ndryshuar.</b></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1.3. Urdhër për fillim veprimtarie nr.68, 27.02.2012</p> <p>Aneksi 6. Rregullore Institucionale e KU IKT</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA&amp;IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit i ciklit të parë BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacionii përmbush kriteret e vendosura, pasi iu ofron studentëve mundësinë e përfitimit të njohurive teorike dhe aftësive praktike &amp; formimin e shprehive të veçanta të cilat ata mund t'i përdorin në një varietet të gjerë profesionale e specialitetesh. Ky program studim synon të formojë studentët me njohuri themelore në fushën e menaxhimit dhe teknologjisë së informacionit, duke përgatitur specialistë në një sërë profesionale si: menaxherë dhe administratorët e niveleve të ndryshme, specialistë teknologjie informacioni, konsulentë biznesi dhe IT, etj, ku mund të zbatojnë njohuritë e marra gjatë studimeve.</p> <p>Në bazë të takimit me drejtues të IAL IKT, në ndërtimin e planit mësimor për këtë program studimi, parimi themelor ka qenë shpërndarja në lidhje me lëndët që ofrojnë njohuritë bazë; lëndët karakterizuese; lëndët interdisciplinore/integruese; lëndët plotësuese; &amp; detyrimet përmblyëse - punimi i diplomës. Literatura e lëndëve ka kryesisht karakter gjithëpërfshirës.</p> <p>Lidhur me objektivat e këtij programi studimi, ai synon ta pajisë studentin me: njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit; aftësi drejt një profesioni apo license profesionale; formim qytetar të përgjithshëm; aftësi bazë për punë kërkimore; aftësi të përgjithshme praktike, aplikative; aftësim për promovim personal; etj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA&amp;IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi 6. Rregullore Institucionale e KU IKT</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>GVJ duke u bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion konstaton se ky program studimi synon të formojë studentët me njohuri të përparuara në fushën e administrimit të biznesit dhe teknologjisë së informacionit, dhe duke përgatitur specialistë të aftë në fushat e sipërcituara, dhe të punësohen në kompani private apo publike ku mund të zbatojnë njohuritë e marra gjatë studimeve. Thelbi i programit të studimit është në formimin e të menduarit kritik të studentëve, aftësinë për të menduar dhe vepruar në të njëjtën kohë, si dhe për të gjykuar situata specifike. Rastet studimore reale dhe mundësitë për t'i analizuar ato,</p>

	<p>shërbejnë si një metodologji efikase për zhvillimin e programit të studimit, ku studentëve u jepet ndihmë për të materializuar njohuritë teorikenë përvojën praktike.</p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA&amp;IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi 6. Rregullore Institucionale e KU IKT RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentave konstaton se objektivi kryesor i këtij programi studimi është tu ofrojë studentëvmundësinë e përfitimit të njohurive teorike dhe aftësive praktiketë cilat ata mund t'i përdorin në profesionet e specialitetet në fushën e menaxhimit të biznesit dhe teknologjisë së informacionit. Qëllimi i këtij programi studimi është të garantojë një përgatitje të përgjithshmenë fushat themelore dhe thelbësore të programit të zgjedhur, si dhe profilizimin dhe specializimin e orientuar me qëllim të formimit profesional për të mbështeturpunësimin në të ardhmen. Shumëllojshmëria e disiplinave në këtë program pasqyronkërkesën në rritje për profesione dhe specialitete si dhe ka ofruar avantazhe kryesorenë adresimin më të mirë të nevojave të studentëve, mundësimin e rritjes së edukimitnë nivele më të larta, përmirësimin e lëvizshmërisë sociale, shërbimin më të mirë tënevojave të tregut të punës dhe efektshmëri më të lartë të sistemit.</p> <p>Programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacionisynon që studenti të jetë në gjendje që në mënyrë të pavarur dhe kritiketë analizojë, sintetizojë dhe vlerësojë ide të reja dhe komplekse në lidhje me fushënprofesionale; të jetë në gjendje të konceptojë, dizenjojë, zbatojë dhe vlerësojë nëmënyrë kritike projekte zhvillimi, që çojnë në njohuri të përditësuaradhe zgjidhje procedurale.</p> <p>Parimi themelor i ndërtimit të programeve të lëndëve është që pjesën më të madhe ta zënë njohuritë bazë dhe ato të thelluara. Në këtë aspekt GVJ është i mendimit se programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacionikryesisht zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca bazë në fushën e tij të studimit.</p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA&amp;IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT</p> <p>Aneksi 6. Rregullore Institucionale e KU IKT RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përbajnë të gjitha elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Duke u mbështetur tek dokumentacioni i vënë në dispozicion nga IAL IKT, GVJ konstaton se në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në përputhje me to, për funksionimin sa më mirë të programit të studimit,Kolegji Universitar IKT ka hartuar dhe miratuar dokumenta të tillë si: Rregulloren Institucionale të KU IKT, Rregulloren e Fakultetit të</p>

	<p>Ekonomisë, dhe Rregulloren e Programit të Studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, të cilat përcaktojnë strukturën e programit të studimit me të gjithë elementët e tij.</p> <p>Konkretisht, rregullorja e programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni përmban informacionin e domosdoshëm përbarëvajtjen e tij si dhe jep sqarime të detajuara për: të dhëna të përgjithshme për programin, formën dhe objektivat kryesore, planin mësimor, shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve; kushtet e pranimeve në programin e studimeve dhe kriteret e përzgjedhjes në rastet e pranimeve me numër të kufizuar; metodat e vlerësimit të studentëve dhe kushtet për përparim në program; dhe kushtet për transferime ndërmjet programeve dhe kushtet për përfundimin epjeshtëm të programit, nëse ai e parashikon këtë gjë; frekuentimin; vlerësimin e studentit; praktikën mësimore; diplomimin, etj.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni miratohet me propozim të Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit të Administrim Biznesit &amp; Teknologjisë së Informacionit, në Senat Akademik për secilin vit dhe i shpërndahet njësisë kryesore, asaj bazë, stafit akademik, atij administrativ dhe u bëhet i ditur studentëve. Një kopje e planit mësimor gjendet edhe në faqen web të IAL IKT.</p> <p>Programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore, duke filluar nga kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve; kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; objektivat formuese dhe kompetencat profesionale; veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit; kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi; planin mësimor; kuotat e pranimit dhe grupet mësimore; syllabuset; profilin e programit; diplomën dhe suplementin.</p> <p><i>Evidenca:</i>  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi 6. Rregullore Institucionale e KU IKT  Aneksi D4.2. VSA nr. 17, 11.10.2019  Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA&amp;IT, 2021-2022, 2020-2021-2019-2020</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/bachelor-in-business-administration-and-information-technology-2/">https://cit.edu.al/bachelor-in-business-administration-and-information-technology-2/</a></p> <p>RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të</p>	<p>Duke u mbështetur në dokumentat e vëna në dispozicion, GVJ konstatoi se programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni i ka të përcaktuara veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>

<p>përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A: Lëndë të formimit të përgjithshëm (bazë), 5 lëndë (30 ECTS).</li> <li>- Kategoria B: Lëndë të formimit karakterizues - përgatitje për disiplinën shkencore, 16 lëndë (96 ECTS).</li> <li>- Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese - grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje, 5 lëndë (30 ECTS).</li> <li>- Kategoria D: Lëndë plotësuese - gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 3 lëndë (18 ECTS).</li> <li>- Kategoria E: Detyrime përmbyllëse - punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues, (6 ECTS).</li> </ul> <p><i>Por sugjerohet nga GVJ që veprimtaritë formuese: kategoria C (përqindjet e krediteve të lëndëve) të përshtaten sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018 - PËR ELEMENTËT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA IAL, e ndryshuar.</i></p> <p><i>Evidenca:</i>  Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA&amp;IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020  Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 6. Rregullore Institucionale e KU IKT  Aneksi D4.2. VSA nr. 17, 11.10. 2019  Linku: <a href="https://cit.edu.al/bachelor-in-business-administration-and-information-technology-2/">https://cit.edu.al/bachelor-in-business-administration-and-information-technology-2/</a>  RVB e IAL IKT</p>			
<p><b>Shkalla e përmbylljes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbyllet</p>	<p>Përmbyllet pjesërisht</p>	<p>Përmbyllet kryesisht</p>	<p>Përmbyllet plotësisht</p>
			<b>X</b>	

<p><b>Standardi II.2</b>  <b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbyllet kërkesat ligjore për këto njësi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbyllet detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Programi i Studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit si njësi bazë, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë si njësi kryesore, në Kolegjin Universitar IKT. Ky program studimi është akredituar me Urdhër të Ministrit dhe Sportit nr.138, datë 25.03.2016 (me shkresë nr.2,935 prot, datë 25.03.2016), në bazë të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p>Vendimit të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartënr.86, datë 02.11.2015</p> <p>Duke u mbështetur tek dokumentat: Statuti i IAL IKT, Rregullore Institucionale e Kolegjit Universitar IKT, Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, Rregullore e Departamentit BA &amp; IT, Rregullore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, &amp; dokumenta të tjera, si dhe në bazë të vizitës në vend në IAL IKT, GVJ është i mendimit se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p><i>Evidenca:</i>  Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA&amp;IT  Aneksi 6. Rregullore Institucionale e KU IKT  Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016  Aneksi 1.5 Akreditimi i parë i programit BA&amp;IT, Urdhër i MAS nr.138</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Bazuar në Vendimin e Senatit Akademik nr.11, datë 15.10.2021 për secilin prej programeve të studimit janë përcaktuar koordinorët e tyre. Për programin BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni koordinatore është caktuar Dr. Ditila Ekmeçiu. Në bazë të dokumentacionit të paraqitur GVJ konstatoi se detyrat e koordinatoressë së programit janë të përcaktuara në aktet rregullatore të Kolegjit Universitar IKT ku evidentohet që ajo raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit. Koordinatorët janë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e vendosura për programin e studimit. Ajo dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit ashtu siç dhe kontribuon në detyra të tjera që kanë të bëjnë me këshillimin e studentëve, ndjekjen e procesit të përzgjedhjes së temave të diplomave, supervizon procese si ai i praktikave mësimore, regjistrimet në programin e studimit etj.</p> <p><i>Evidenca:</i>  Aneksi 28. VSA nr.11, datë 15.10.2021  Aneksi 6. Rregullore Institucionale e KU IKT</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ është i mendimit se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike bazuar kjo tek dokumentat e shqyrtuara të vëna në dispozicion: Rregullorja Institucionale e Kolegjit Universitar IKT, Statuti i IKT, Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, Rregullorja e Departamentit BA &amp; IT, Rregullorja e programit të studimit, etj. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Administrim Biznesit &amp; Teknologjisë së Informacionit përmbushin detyrimet ligjore, referuar nenit 20 dhe 23 të Ligjit për Arsimin e Lartënr.</p>

	<p>80/2015.Fakulteti i Ekonomisë është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhëniendhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura dhe ofronprograme të studimeve në ciklin e parë dhe të dytë në përputhje me statusine tij.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë (referuar nenit 4 të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë) është i organizuar në dy departamente dhe një njësi ekërkimit shkencor, si vijon:Departamenti i Administrim Biznesit; Departamenti i Administrim Biznesit dhe IT; dhe Njësia e Kërkimit Shkencor CIRD Ekonomi.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 6. Rregullore Institucionale e KU IKT Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016 Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT</p> <p>Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA&amp;IT</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë në IKT dhe Departamenti i Administrim Biznesit &amp; Teknologjisë së Informacionit përmbushin detyrimet ligjore, referuar nenit 25 të Ligjit për Arsimin e Lartë nr.80/2015. Fakulteti i Ekonomisë (referuar nenit 4 të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë) është i organizuar në dy departamente dhe një njësi e kërkimit shkencor, si vijon: Departamenti i Administrim Biznesit; Departamenti i Administrim Biznesit dhe IT; dhe Njësia e Kërkimit Shkencor CIRD Ekonomi. Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive, si dhe është përgjegjës për programin Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni. Referuar nenit 3 të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, roli kryesor i departamenteve të Fakultetit të Ekonomisë është të promovojnë, koordinojnë dhe menaxhojnë aktivitetet mësimore dhe kërkimore duke shfrytëzuar burimet e tyre njerëzore, materiale dhe financiare, dhe duke u mbështetur në lirinë akademike &amp; potencialin intelektual &amp; shkencor të stafit të Fakultetit të Ekonomisë. Departamentet organizohen dhe drejtohen nga përgjegjësat përkatës të departamenteve, kurse Njësia e Kërkimit Shkencor CIRD drejtohet nga Përgjegjësi i saj.</p> <p>Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionitsi njësi përgjegjëse për këtë program studimi (bazuar në VKM nr. 418, datë 10.5.2017) ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë të punësuar me kohë të plotë si personel akademik, nga të cilët të paktën tre janë me grada shkencore ose tituj akademikë, dhe në këtë mënyrë përmbush kërkesat e ligjit për numrin e PAE &amp; raportin me PAK, dhe atë të gradave shkencore.Gjatë vitit 2021 – 2022 Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit ka të angazhuar 8 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 0 pedagogë si personel akademik me kontratë (PAK). Titujt dhe gradat shkencore të personelit akademik janë si vijon:</p>

	<p>2 pedagogë me titullin akademik Profesor i Asociuar;</p> <p>5 pedagogë me gradën Doktor/PhD;</p> <p>1 pedagog në proces doktorature;</p> <p>Organizimi i punës, përgjegjësitë institucionale dhe akademike, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik burojnë nga legjislati arsimor, dhe nga Statuti &amp; aktet nënligjore, të cilat përfshihen në rregulloret e çdo departamenti. Angazhimi i personelit akademik është në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe me strategjinë për zhvillimin e IAL.</p> <p>Konstatohet nga GVJ që disa titullarë lëndësh (të paktën 6 të tillë) janë me gradën MSc ... sugjerohet në të ardhmen që titullarët e lëndëve të jenë të paktën me gradën shkencore Dr?!</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi. Tabela 7 dhe 10 tek shtojca</p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Aneksi D2. Organigrama e institucionit, 2016</p> <p>Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT</p> <p>Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA&amp;IT</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ është i mendimit se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike, kjo bazuar tek dokumentat e shqyrtuara të vëna në dispozicion: Statuti i IKT, Rregullorja Institucionale e Kolegjit Universitar IKT, Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, Rregullorja e Departamentit BA &amp; IT, Rregullorja e programit të studimit. GVJ konstaton se statuti dhe rregulloret janë hartuar në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 'Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë', dhe në përputhje me vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Administrimit Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit përmbushin detyrimet ligjore referuar Kreut V të Ligjit për Arsimin e Lartë nr. 80/2015 për Organizimin akademik dhe administrativ të IAL. Në bazë të Kreut III të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë të IKT, Autoritetet e Fakultetit të Ekonomisë, të drejtat dhe detyrat, (nenet 5-20), neni 5 specifikon organet drejtuese të Fakultetit të Ekonomisë: Asambleja e Fakultetit të Ekonomisë, Këshilli i Fakultetit të Ekonomisë, &amp; Dekanati, kurse neni 6 specifikon autoritetet menaxhuese të Fakultetit të Ekonomisë: Dekani; Zëvendësdekani; Përgjegjësi i Departamentit të Administrimit Biznesit; Përgjegjësi i Departamentit të Administrimit Biznesit dhe IT; Përgjegjësi i Njesisë së Kërkimit Shkencor CIRD</p>


	<p>Ekonomi.Organizimi i strukturës akademike të Fakultetit të Ekonomisë së IKT është nëpërputhje të plotë dhe me statutin e institucionit, Pjesën e Dytë: Organet dheAutoritetet Drejtuese.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016</p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Aneksi D2. Organigrama e institucionit, 2016</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT</p> <p>Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA&amp;IT</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ evidentoi se Fakulteti i Ekonomisë në IAL IKT dhe Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit që janë përgjegjës për programin e studimit* BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni disponojnë të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Këto informacione gjenden në dokumentat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Statuti i IAL IKT;</li> <li>- Rregullore institucionale e Kolegjit Universitar IKT;</li> <li>- Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë;</li> <li>- Rregullore e Departamentit BA &amp; IT;</li> <li>- Rregullore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni;</li> <li>- Kurrikula e Programit Studimit të Ciklit të Parë BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni;</li> <li>- Plani Mësimor i Programit Studimit të Ciklit të Parë BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni; etj.</li> </ul> <p>Gjatë vizitës në IAL IKT studentët na informuan që të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, dhe lëndët i marrin nëpërmjet syllabuseve të lëndëve/moduleve dhe materialeve që hidhen në webin e IAL IKT. Të gjitha të dhënat (plani mësimor i programit; rregullorja e programit të studimit; programet e lëndëve për programin; stafi i njësisë kryesore dhe departamentit; manuali i praktikës mësimore;</p>



	<p>manuali i diplomës; broshura informuese për programin e studimit; rregullorja e fakultetit, si dhe ato të departamentit; CV e stafit akademik; plani kalendarik vjetor; guida e studentit; propozimet e temave të diplomave; vendime të Këshillit të Fakultetit lidhur me ecurinë e detyrave nënjësi; etj) lidhur me organizimin e programit të studimit të ciklit të parë BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni ruhen sipas rëndësisë në Fakultetin e Ekonomisë dhe Departamentin e Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit përgjegjës për programin e studimit. Një pjesë e këtyre të dhënave janë publike dhe të aksesueshme në faqen e internetit të IAL IKT.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA&amp;IT  Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi D2. Organigrama e institucionit, 2016  Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA&amp;IT, 2021-2022, 2020-2021-2019-2020  Aneksi. Tabela 10 tek shtojca  Linku: <a href="https://cit.edu.al/official-documents-2">https://cit.edu.al/official-documents-2</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Duke u mbështetur në dokumentat e vëna në dispozicion, GVJ konstatoi se programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni është i organizuar në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. IAL IKT ka hartuar dhe miratuar rregulloret e veta të funksionimit dhe organizimit (të cituara dhe në kriteret e mëparshme të RVJ) në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, dhe në përputhje me këto rregullore, kurrikula e programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni ka të përcaktuara qartë lëndët, modulet, praktikën dhe aktivitetet formuese të këtij programi studimi. Ky program studimi i ka të përcaktuara veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A: Lëndë të formimit të përgjithshëm (bazë), 5 lëndë (30 ECTS).</li> <li>- Kategoria B: Lëndë të formimit karakterizues - përgatitje për disiplinën shkencore, 16 lëndë (96 ECTS).</li> <li>- Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese - grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje, 5 lëndë (30 ECTS).</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria D: Lëndë plotësuese - gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 3 lëndë (18 ECTS).</li> <li>- Kategoria E: Detyrime përmbyllëse - punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues, (6 ECTS).</li> </ul> <p>Ndarja specifike është e pasqyruar tek Plani Mësimor i Programit të Studimit të Ciklit të Parë BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni. Numri i lëndëve-moduleve më vete të ndara është 28, duke shtuar edhe praktikën mësimore dhe mbrojtjen e diplomës, janë 30. Sipas planit mësimor, në vitin e tretë përgjatë një muaji të semestrit të dytë, studenti frekuenton Praktikën Mësimore e cila është 6 ECTS, ose 120 orë, ndërkohë që po në fund të semestrit të dytë të vitit të tretë ai mbron edhe temën e diplomës e cila është 6 ECTS.</p> <p><b>Sugjerohet nga GVJ që veprimtaritë formuese: kategoria C (përqindjet e krediteve të lëndëve) të përshtaten sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018</b>  <b>- PËR ELEMENTËT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA IAL, e ndryshuar.</b></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA&amp;IT  Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA &amp; IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020  Aneksi. Tabela 10 tek shtojca</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>GVJ konstatoi se Programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendas dhe evropian, të ndara në vite e semestra. Kreditet e një disipline fitohen vetëm pas vlerësimit të studentit me notë kaluese, kjo e përcaktuar në Rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni. Në bazë të dokumentit Plani Mësimor i Programit të Studimit të Ciklit të Parë BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, GVJ konstatoi se në të gjenden informacionet e nevojshme për lëndët dhe modulet me kreditet përkatëse, ngarkesën mësimore, dhe orët në auditor.</p> <p>Programi i studimit ka 28 lëndë-module më vete të ndara (disa lëndë janë të ndara në module), pa përfshirë praktikën mësimore dhe diplomën, bashkë me këto të dyja bëhen 30. Lëndët janë të ndara sipas semestrave dhe krediteve për të balancuar peshën e orëve në auditor. Programi zgjat tre vite me gjashtë semestra, dy në çdo vit. Çdo semestër ka 30 ECTS, ndërsa viti akademik 60 ECTS. Në vitin e tretë, semestrin e fundit është edhe praktika mësimore e cila zgjat një muaj. Rregullorja e programit të Studimit Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni saktëson qartë në nenin 4 sekreditet e çdo lënde marrin</p>



	<p>parasysh ngarkesën në klasë si dhe punënindividuale që studenti duhet të kryejë për të përmbushur të gjitha detyrimet epërcaktuara në programin e lëndës. Studenti që ndjek këtë program studimiduhet të marrë së paku 180 ECTS.Në rastin e disiplinave të përbëra nga dy module, studenti vlerësohetme notën përfundimtare dhe fiton kreditet përkatëse pasi të ketë marrë jo mëpak se 50% në secilin prej moduleve.Koha normale për përfundimin e studimeve është tre vite akademike dhe ajomaksimale gjashtë vite akademike.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT</p> <p>Aneksi 16. Plan i mësimor i programit të studimit Bachelor në BA &amp; IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020</p> <p>Aneksi. Tabela 10 tek shtojca</p> <p>Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016</p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA&amp;IT RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni përmban planinmësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orëtnë auditor dhe jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën evlerësimit të dijeve etj.Programi shtrihet në 6 semestra, në të cilin praktika mësimore dhe mbrojtja e temës së diplomës bëhen në përfundim të semestrit të 6<sup>te</sup>. Në total janë parashikuar 1,820 orë për zhvillim në auditor dhe 2,680 orë punë e pavarur për të treja vitet e studimit. Në vitin e parë dhe të dytë të programit të studimit janë parashikuar në çdo vit nga 608 orë studimi në auditor dhe po kështu në vitin e parë&amp; në vitin e dytë, në çdo vit nga 892 orë studimi individual,kurse në vitin e tretë 604 orë në klasë dhe 896 orë studim individual. Orët në auditor përfshijnë leksione, seminare, ushtrime, laborator dhe projekte të cilat bashkë me praktikën mësimore bëjnë 1,820 orë. Sipas drejtuesve të IAL IKT dhe departamentit, përveç leksioneve, i kushtohet rëndësi seminareve, ushtrimeve dhe projekteve, në përputhje të plotë me qëllimin e institucionit me orientim drejt praktikës dhe nxitjes së studentëve për të zhvilluar aftësitë e tyre. I gjithë informacioni për kreditet, orët mësimore në auditor dhe jashtë auditorit, por edhe shpërndarja e tyresipas leksioneve/seminareve/ushtimeve/laboratoreve, apo dhe projekteve, janëtëpërfshira në programet/syllabuset e lëndëve/moduleve.</p> <p>Rregullorja e Programit të Studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, pika 6: Frekuentimi, thotë:Pjesëmarrja në procesin edukativo-arsimor (leksione, seminare, ushtrime,laboratorë, projekte) është e detyrueshme në masën 75% (kjo gjë përmendet edhe në programet/syllabuset e lëndëve/moduleve).Kurse në pikën 5 të Rregullores së Programit të Studimit BSc në Administrim Biznesi dhe</p>


	<p>Teknologji Informacioni: Vlerësimi i njohurive të marra ngastudenti, thuhet se vlerësimi akademik i studentëve bazohet në parimin e vlerësimit të vazhdueshëm. Planprogrami përcakton vlerësimin që ndjek çdo pedagog. Notapërfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: provime + detyra / projekteindividuale + pjesëmarrje aktive në procesinmësimor etj.Provimet e ndërmjetme dhe provimet përfundimtare zhvillohen në kohën eparashikuar në kalendarin akademik të vitit akademik (provimi indërmjetëm, si rregull, bëhet në javën e 7<sup>te</sup> ose të 8<sup>te</sup> të semestrit mekohëzgjatje normale, ndërsa provimet përfundimtare zhvillohen në fund tësemestrit).Provimet zhvillohen me sekretim duke mbajtur të fshehtë emrin estudentit në fletën e provimit deri në momentin e hapjes së tyre në sekretari pasiprofessori i lëndës të ketë korrigjuar provimet. Në Librin e Rregulloreve Institucionale të IAL IKT, gjendet edhe rregullorja: Vlerësimi i studentit, ku përcaktohen qartësishtelementët kryesorë të vlerësimit të studentit si: vlerësimi i vazhdueshëm; provimet dhe mbrotjja e diplomës; orientime për hartimin e provimeve; orientime për mënyrën e shpërndarjes së pyetjeve prej pedagogëve; provimet e ndërmjetme të lëndës; hyrja në provim; kalueshmëria, ngelja; organizimi i kërkimit shkencor kur kërkohet; projektet; detyrat në grup; pjesëmarrja në kërkim shkencor; format e vlerësimit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT</p> <p>Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA &amp; IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020</p> <p>Aneksi. Tabela 10 tek shtojca</p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA&amp;IT RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ bazuar tek shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion evidentoit se programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni përmban të gjithëinformacionin e domosdoshëm për të cilin janë të interesuar studentët. Kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi duke i orientuar studentët specifikisht sipas rregullores së programit të studimit përkatës.Kyinformacion përshkruhet në Rregulloren e Programit të Studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, ashtu siç tëdhëna të detajuara për tu ardhur në ndihmë studentëve jepen edhe nëdokumente të tjera si:kriteret e pranimit të publikuara në faqen web;Guida e Studentit; Librin e Rregulloreve Institucionale, Kapitulli VI, Transferimidhe Kriteret e Pranimit; Vendimin e Bordit të Administrimit për tarifat dhe bursat estudimit, etj.Sa i përket informacionit bazë për kriteret e pranimit, dokumentet e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>regjistrimit,transferimet etj, në faqen e internetit është një seksion më vete 'Admissions'... Pranimet, në të cilin jepen të gjitha informacionet e kërkuara prej studentëve të interesuar si për regjistrim ashtu dhe për transferim studimesh.Informacioni i dhënë në faqen e internetit të IAL IKT përfshin: kriteret e pranimit për studentët vendas dhe për ata atandërkombëtarë; procedurat e regjistrimit për studentët vendas si dhe për atandërkombëtarë; tarifat dhe bursat; FAQ ... përgjigje pyetjeve më të shpeshta. Ndërkohë që të dhëna të tjera të detajuara jepen edhe në Guidën e Studentit,Kapitulli e Dytë 'Viti Akademik', në të cilën janë përfshirë informacione mbi: kriteret e pranimit Bachelor dhe Master; tarifat; pezullimi i studimeve ose transferimi; tërheqja nga regjistrimi; frekuentimi dhe lajmërimi i tejkalimit të mungesave; provimet; vlerësimi; diplomimi, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT</p> <p>Aneksi D14. Guida e Studentit</p> <p>Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA&amp;IT</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/admissions-3">https://cit.edu.al/admissions-3</a></p> <p>RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ evidentoi se plani mësimor i programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni jep të dhëna mbikategoritë e grupimit të lëndëve (përqindjen sipas kategorive), lëndë-modulet,shpërndarjen e lëndëve në vite dhe semestra, kreditet, orët mësimore në auditor dhe jashtë auditorit, detyrimet akademike, ngarkesën lëndore, llojin e orëve mësimore (leksione, ushtrime, seminare, laboratorë, projekt etj), kohën ezhvillimit të praktikës mësimore, detyrimet përfundimtare që ka studenti,temën e diplomës, etj. Gjithashtu ky program studimi përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë të hartuara prejstafit akademik në përputhje me aktet nënligjore dhe në bashkërendim me vetëplanin mësimor për numrin e orëve, kreditet, orët në auditor dhe jashtë auditorit,literaturën, përshkrimin e lëndës, objektivat, shpërndarjen e njohurive në javë,literaturën kryesore&amp; atë ndihmëse, frekuentimin, vlerësimin&amp;komponentët evlerësimi, etj[syllabusi i lëndës kryesisht ka këto të dhëna kryesore:titullari /pedagogu i lëndës: (emri, titulli akademik, gradashkencore dhe nënshkrimi); ngarkesa: (numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë,leksion dhe seminar, praktika etj.); tipologjia e lëndës: viti akademik/semestri kur zhvillohet; lloji i lëndës; programi i studimit (programi për të cilin ofrohet kjo lëndë); kodi i lëndës; adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës; përshkrimi i lëndës me konceptet themelore; temat e lëndës; literatura kryesore dhe ajo ndihmëse; format e kontrollit; rregullore për</p>



	<p>frekuentimin e kursit, etj].</p> <p>Në ndihmë të stafit akademik janë dhe disa rregulloreqë gjenden në Librin eRregulloreve Institucionale të IAL IKT (të cituara në kriteret e meparshme të RVJ) të cilat u mundësojnë kryerjen e detyrave në mënyrën më të mirë të mundshme dhe sipas procedurave dhe kërkesave të caktuara. Për praktikën mësimore,programi parashikon që ajo të kryhet në përputhje meperiudhën e caktuar si dhe me manualin e praktikës mësimore, kurse për temën e diplomës,programi parashikon që të kryhet në semestrin e fundi të vitit të tretë dhe në përputhje me manualin dhe rregulloren e punimit të temës së diplomës.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT</p> <p>Aneksi D14. Guida e Studentit</p> <p>Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi 20. Programet e lëndëve tëBSc Administrim Biznesi &amp; IT 2021 - 2022</p> <p>Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA &amp; IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020</p> <p>Aneksi. Tabela 10 tek shtojca</p> <p>Aneksi.Manuali i Punimit të Tezës së Diplomës (shqip)</p> <p>Aneksi.Manuali i Praktikës Mësimore Bachelor FE (shqip)</p> <p>RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Sipas drejtuesve të IAL IKT, qëllimi themelor i IKT në fushën e mësimdhënies është transmetimi tekstudentët i një informacioni sa më cilësor e bashkëkohor në të gjitha disiplinatmësimore e lëndët me karakter teorik dhe praktik, duke realizuar ciklin ‘informacion-njohuri-dije-aftësi’. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm,dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. Përgjithësisht si model/benchmark për planin mësimor &amp; lëndët/modulet &amp; organizimin ndjekin modelin e universiteteve amerikano-veriore. Sipas rregullores së IAL IKT, ndryshimet propozohen nga departamenti, por edhe nga anëtarë të personelit akademik të tij, në konsultim me ekspertë të fushës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme. Ndryshimet apo përmirësimet potenciale shqyrtohen në Departament dhe dërgohen për miratim në mbledhjen e Dekanatit. Sipas drejtuesit të DepartamentitAdministrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit,ata punojnëngushtësisht përpara fillimit të vitit akademik përpërmirësimin emodeleve dhe formateve të përdorura; përditësimin e literaturës bazë në programin e lëndëve; përditësimin e literaturës ndihmëse në programin e lëndëve; ndryshime eventuale në përmirësimin</p>



	<p>e formave të vlerësimitpërshtatur me kërkesat; hartimin e testeve apo formave të kontrollit të njohurive, etj.Pra, sipas drejtuesit të departamentit dhe stafit akademik, synohet përgatitja e studentëve të aftëqë të analizojnë në mënyrë të pavarur, të debatojnë e marrinvendime të sakta, si dhe të orientohen menjëherë përballë tërësisë sëinformacioneve dhe specifikave të sektorëve e degëve ku ata specializohen, objektiv që synojnë ta realizojnë duke përpunuar e zgjedhur literaturë sa më cilësorepër çdo lëndë që zhvillohet në programin e studimit; duke përdorur teknikapedagogjike që vlerësojnë disa komponentë dhe jo vetëm aftësitë me shkrimose gojë të studentit; nëpërmjet zhvillimit të leksioneve dhe seminareve memetoda e forma didaktiko-pedagogjike moderne e interaktive, duke përdorurgjerësisht analizatkrahasuese e kontekstuale, pjesëmarrjen aktive të studentëve në leksione eseminare, debatin e improvizuar, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 20. Programet e lëndëve të BSc Administrim Biznesi &amp; IT 2021 - 2022</p> <p>Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA &amp; IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020</p> <p>Aneksi. Tabela 10 tek shtojca</p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT</p> <p>Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA&amp;IT</p> <p>Takimi me drejtuesit e IAL IKT, drejtuesin e departamentit dhe stafin akademik</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ evidentoi se ngarkesa dhe struktura e programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, dhe në Rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të ParëBSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni.Përcaktimet specifike për strukturën dhe kreditet e këtij programi studimi jepen në Planin Mësimor të Programit të Studimit të Ciklit të ParëBSc në Administrim Biznesi dhe



	<p>Teknologji Informacioni, përkatësisht ngarkesa në orë mësimore në auditor, si dhe puna individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Programi ka 180 ECTS, të shpërndara në tre vite akademike nga 60 ECTS. Numri total i orëve (brenda e jashtë auditorit) në të tre vitet është 4,500 orë, nga të cilat 1,820 zhvillohen në auditor dhe 2,680 orë jashtë auditorit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA &amp; IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020</p> <p>Aneksi. Tabela 10 tek shtojca</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi20. Programet e lëndëve të Bach. Administrim Biznesi &amp; IT 2021 - 2022</p> <p>RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>GVJ është i mendimit që kurrikula e programit të studimit në përgjithësi është një kurrikul që i përgjigjet qëllimit dhe objektivave të programit të studimitBSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni. Referuar planit mësimor, përmbajtja e veprimtarive formuese, shpërndarja e lëndëve dhe praktikës u mundësojnë studentëve rritjen e aftësive profesionale,thellim të njohurive dhe aftësive për të vijuar studime të mëtejshme ose punësim në tregun e punës vendas dhe atë ndërkombëtar. Mësimdhënia në gjuhën angleze dhe përdorimi i literaturës së fundit në mësimdhënie, bashkë me stafin e kualifikuar &amp; me eksperiencë, janë garanci për studime të thelluara dhe që në fund përgatisin studentë të përshtatshëm dhe të aftë për tregun e punës. Objektivat e programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacionijanë në përputhje me zhvillimin dhe thellimin e njohurive që studentët do të marrin përgjatë programit, për tu përgatitur që në fund të tij të kenë mundësi të ndjekin studimet e ciklit të dytë, të tretë ose të futen në tregun e punës. Studentët e programitBSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacionibashkëpunojnë me instruktorët e tyre si dhe me studentë të tjerë, për të përmbushur detyrat dhe projektet që janë të nevojshme për t'i përgatitur ata me njohuritë dhe aftësitë që do të përdoren kur të hyjnë në tregun e punës. Ndërkohë që në pikën 3.1.11 të Rregullores së Programit thuhet që përfundimi me sukses i programit të studimit e çon studentin në tregun e punës ose i mundëson vazhdimin e studimeve në programet e ciklit të dytë të studimit. Shpërndarja e orëve bëhet sipas peshës specifike në leksione, seminare, ushtrime, laboratorë e projekte, dhepraktikë profesionale. Programi i studimit zhvillohet gradualisht me nga 5 lëndë/module (secila me nga 6 ECTS) në secilin semestër, në total 10 në secilin vit akademik (në vitin e tretë në semestrin e dytë përfshihet praktika dhe diploma). Emërtimi i lëndëve lidhet me aftësitë që studenti duhet të fitojë në përfundim të këtij programi studimi dhe të cilat përshtaten me mundësitë e punësimit të tij.</p>





	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA &amp; IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020</p> <p>Aneksi. Tabela 10 tek shtojca</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi20. Programet e lëndëve të Bach. Administrim Biznesi &amp; IT 2021 - 2022</p> <p>RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimitBSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioniofrohet në 3 vite mësimore, gjithsej 6 semestra me kohëzgjatje normale 15 javë në një semestër, dhe në përfundim të tre viteve studentët marrin 180 kredite (ECTS). Shpërndarja e lëndëve/moduleve në semestra dhe shpërndarja e krediteve sipas lëndëve/moduleve bën të mundur arritjen e objektivave formues të këtij programi studimi dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.Sipas detyrimeve ligjore të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit, programi i studimit BScsynon të pajisë studentët me:njohuri dhe koncepte bazë në fushat përkatëse të studimit dhe njohuri të thelluara të fushës kryesore të studimit; aftësi për një profesion apo licensë profesionale; formim teorik dhe praktik në fushën e zgjedhur; aftësi të zhvilluara për kërkim shkencor në fushën e studimit; aftësi praktike, të zbatueshme dhe kërkimore; aftësi për promovim personal dhe profesional; tezë e punuar origjinale që tregon se si kuptohet puna e studiuesve të tjerë në fushën përkatëse. Të diplomuarit nga ky program studimi përgatiten për karrierë dhe mundësi punësimi në çdo sektor të ekonomisë, biznesit privat dhe administratës publike. Programi i studimit i plotëson të gjitha normat e përcaktuara sipas akteve ligjore dhe atyre nënligjore për organizimin e tij, shpërndarjen e krediteve, orëve brenda dhe jashtë auditorit për praktikën mësimore si dhe mbrojtjen e temës së diplomës.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA &amp; IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020</p> <p>Aneksi. Tabela 10 tek shtojca</p> <p>Aneksi20. Programet e lëndëve të Bach. Administrim Biznesi &amp; IT 2021 - 2022</p> <p>RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ konstatoi në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion por edhe gjatë bisedave me drejtuesit, pedagogët &amp; studentët që struktura e programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit. KU IKT ka aplikuar prej kohësh Kodet e Lëndëve duke kodifikuar kështu lëndët sipas normativave të përdorura ndërkombëtarisht, dhe kryesisht në kodifikimin e lëndëve të programeve të studimit janë përdorur metodologji dhe</p>



	<p>praktika të universiteteve amerikano-veriore.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA &amp; IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020</p> <p>Aneksi. Tabela 10 dhe 13 tek shtojca</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi20. Programet e lëndëve të Bach. Administrim Biznesi &amp; IT 2021 - 2022</p> <p>RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Veprimtaritë formuese që ofrohen në programin e studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacionigrupohen në 5 kategori, në përputhje me përcaktimet ligjore. IAL IKT synon që zhvillimi i kurrikulave të programit t'i referohet praktikave më të suksesshme ndërkombëtare me qëllim rritjen e përputhshmërisë së tyre me kurrikulat në universitetet perëndimore për të lehtësuar transferimin e studimeve dhe njohjen e krediteve, mobilitetin e studentëve, dhe për të rritur mundësitë e bashkëpunimit me universitetet partnere për programe të përbashkëta studimi ose dhënien e diplomave të dyfishta. Studentë të Fakultetit të Ekonomisë kanë pasur mundësinë që të përfitojnë prej mobiliteteve të ndryshme, si psh. CEEPUS apo Erasmus+. Bazuar tek sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përfitojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyrevazhdimin e studimeve të ciklit të dytë duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale.</p> <p>KU IKT ndjek politikë fleksibël transferimesh dhe kjo konstatohet në rregulloren e Programit të Studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, në pikën 9 ku thuhet se: IKT, në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës pranon transferime studentësh në vitet e ndërmjetme nga universitete të tjera, të cilat mund të jenë nga Shqipëria ose jo dhe gjithashtu i lejon studentët e saj të transferohen në universitete të tjera. Studentëve të regjistruar në këtë program studimi mund tu njihen kredite të fituara në programe të tjera studimi në fusha të njëjta ose të ngjashme, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren përkatëse të transferimit. Studentët që kanë mbaruar studimet në një program tjetër, kanë të drejtë të kërkojnë njohjen e krediteve për lëndë të ngjashme ose të njëjta. Studentët kanë të drejtë të transferojnë vetëm lëndët në të cilat ai/ajo ka kaluar. Në rast njohjeje studenti mban notën me të cilën është vlerësuar në programin e mëparshëm të studimit. Nga kjo procedurë përjashtohen studentët e IKT që duan të transferojnë studimet brenda institucionit, të cilët kanë të drejtë të rifuten në provim në një lëndë ku kanë dështuar ose në të cilën nuk kanë frekuentuar. Studentët mund të transferohen në vitin e dytë vetëm nëse kanë jo më pak se 30 kredite, dhe në vitin e tretëvetëm nëse kanë jo më pak se 90 kredite.</p> <p><b><i>Sugjerohet nga GVJ që veprimtaritë formuese: kategoria C (përqindjet e krediteve të lëndëve) të përshtaten sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018 - PËR ELEMENTËT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA IAL, e ndryshuar.</i></b></p> <p><i>Evidenca:</i></p>

	<p>Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA &amp; IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020</p> <p>Aneksi. Tabela 10 dhe 13 tek shtojca</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi20. Programet e lëndëve të Bach. Administrim Biznesi &amp; IT 2021 - 2022</p> <p>RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Rregullorja e Departamentit të Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit përcakton që syllabuset e lëndëve/moduleve përditësohen çdo vit akademik. Ky është një proces i përvitshëm i cili nis që përpara se të fillojë viti akademik, me synimin që programet e lëndëve të jenë të përditësuara në ato elementë që ndikojnë në cilësinë e edukimit, si psh. literaturën bazë, mënyrën e vlerësimit dhe testimit, literaturën ndihmëse, etj. Të gjitha programet e lëndëve përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme, nga ku propozimet për ndryshime bëhet nga pedagogët e lëndës, njësia përgjegjëse për zhvillimin e programit, dhe diskutimeve në mbledhjet e departamentit, etj. Gjithashtu sipas Rregullores së Kolegjit Universitar IKT dhe takimit me NjBSC, GVJ konstatoi se literatura e detyruar dhe ndihmëse i përket viteve të fundit. Çdo student që ndjek studimet në një nga programet e IAL IKT, përfiton dhe aksesin në bibliotekën virtuale të McGrawHill Education (aksesohet duke u loguar nga kudo) dhe platformën O'Reilly (aksesohet vetëm nga log-imi në bibliotekën e IAL IKT).</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi9. Rregullore e departamentit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 78. Marrëveshja CIT – FEXO</p> <p>AneksiD5.2. CIT McGrawHill Marrëveshje 2021-2024</p> <p>Takimi me NjSBC</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ kostaton në bazë të dokumentave se programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për një program të ciklit të parë, dhe sesistemi i njohurive që ofrohet nga ky program studimi dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij u mundësojnë atyre vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale, por edhe punësimin e tyre direkt në përputhje me kërkesat e tregut. Aftësitë e synuara të programit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji informacioni janë: Zhvillimi i kompetencave kritike të menaxhimit në disiplinat kryesore të biznesit; Zhvillimi i një baze të fortë teorike dhe të aplikuar në teknologjinë e informacionit dhe shkencë kompjuterike; Zhvillimi i aftësive matematikore dhe statistikore të nevojshme për analizën financiare; Zhvillimi i një kuptimi të detajuar të teorive ekonomike që mbështesin vendimmarrjen e biznesit; Zhvillimi i një kuptimi të detajuar të ndikimit të globalizimit në praktikat dhe mundësitë e menaxhimit; Zhvillimi i aftësive efektive të punës në ekip dhe lidhshipit; Zhvillimi i aftësive të komunikimit dhe prezantimeve; Zhvillimi i aftësive të komunikimit me shkrim; Zhvillimi i aftësive kërkimore kritike dhe analitike, etj.</p>

	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA &amp; IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020</p> <p>Aneksi. Tabela 10 dhe 13 tek shtojca</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi20. Programet e lëndëve të Bach. Administrim Biznesi &amp; IT 2021 - 2022</p> <p>RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ kostaton në bazë të dokumentave se sistemi i njohurive që ofrohet nga programi i studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji informacioni, dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale, por edhe punësimin e tyre direkt në përputhje me kërkesat e tregut.</p> <p>Duke marrë parasysh aftësitë dhe kompetencat që studenti fiton gjatë programit të studimit (të përmendura në kriterin e mësipërm ... 7), studenti mund të ndjekë vijimin e mëtejshëm të studimeve për në programet e ciklit të dytë, i dhe mund të ndjekë përfshirjen e tij në tregun e punës për karrierë &amp; mundësi punësimi në çdo sektor të ekonomisë, biznesit privat dhe administratës publike.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA &amp; IT, 2021-2022,2020-2021-2019-2020</p> <p>Aneksi. Tabela 10 dhe 13 tek shtojca</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi20. Programet e lëndëve të Bach. Administrim Biznesi &amp; IT 2021 - 2022</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ konstatoi në bazë të vizitës së bërë në IAL IKT dhe rregullores së Departamentit të Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit, se programi i studimit, plani mësimor, lëndët dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Ndryshimet propozohen nga departamenti dhe nga anëtarë të personelit akademik në bashkëpunim me ekspertë të fushës me të cilët Kolegji Universitar IKTbashkëpunon. Sipas drejtuesve të IAL IKT, fakulteti dhe departamenti përkatës kanë zhvilluar gjatë këtyre viteve një sërë aktivitetesh konsultative, duke filluar që nga tryezat e rumbullakta me bizneset, sipërmarrjet, me të ftuarit e ndryshëm dhe specialistë vendas e të huaj etj, kurse në të njëjtën kohë departamenti bazë ka kryer edhe vlerësime periodike të programeve të studimit për të parë ecurinë e tyre si dhe përputhjen me nevojat e tregut.</p> <p>Fokusi i tyre ka qenë përmirësimin e programeve të edukimit, afrimin e tyre me konceptet dhe aftësitë që kërkon tregu i punës si dhe sjelljen e këtyre eksperiencave sa më afër studentëve, qoftë duke i ftuar këta specialistë për të vizituar IAL IKT e duke mbajtur leksione të hapura, ashtu si dhe duke vizituar sipërmarrjet prej stafit dhe studentëve.</p> <p>Gjithashtu, procesi i përmirësimit të programit ka ardhur edhe prej vlerësimit që bëjnë studentët përmes pyetësorëve të zhvilluar në fund të</p>

	<p>çdo semestri prej NjSBC, vlerësim që më së shumti është substancial dhe i referohet ecurisë së programit brenda institucionit, kështu që dhe përmirësimi fokusohet e shihet më shumë në përmirësimin e literaturës, cilësisë së mësimdhënies, ndërveprimit pedagog-student, metodat dhe teknikat e vlerësimit, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi9. Rregullore e departamentit BA&amp;IT  Aneksi7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 75. Studim Periodik i Punës në BA &amp; IT  Takimi me drejtues të IAL IKT, si dhe me NjSBC</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë (për vitin akademik 2021-2021 nuk ka të angazhuar personel akademik me kohët e pjesshme) i angazhuar në këtë program studimi i përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përcaktuara në Statutin e Kolegjit Universitar IKT, si dhe në Librin e Rregulloreve të Kolegjit Universitar IKT, dhe janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë. Për realizimin e programit mësimor, specifikisht për vitin akademik 2021 – 2022, departamenti përgjegjës angazhoi personel akademik jo vetëm të vetë departamentit, por bashkëpunoi edhe me departamente të tjera. Gjatë vitit 2021 – 2022 për realizimin e programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni janë angazhuar 19 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 0 pedagogë si personel akademik me kontratë (PAK). Titujt dhe gradat shkencore të personelit akademik janë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 pedagogë me titullin akademik Profesor i Asociuar;</li> <li>- 9 pedagogë me gradën Doktor;</li> <li>- 2 pedagogë në proces doktoreture;</li> <li>- 5 pedagogë me kualifikimin MSc.</li> </ul> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi1. Statuti i KU IKT 2016  Aneksi. Tabela 7 dhe 10 tek shtojca  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi 21. CV e Stafit Akademik të programit të studimit BA&amp;IT  Aneksi D17. Rregullorja për politikat dhe procedurat e rekrutimit të stafit</p>

	<p>akademik Aneksi D2. Organigrama e institucionit, 2016</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL IKT, GVJ u njoh me disa kontrata pune të pedagogëve efektivë (PAK nuk kishte për vitin akademik 2021-2022). Në pjesën më të madhe të tij personeli akademik efektiv (PAE) ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik që kërkon ligji si në drejtimin e programit të studimit edhe në zhvillimin e lëndëve përkatëse. Gjatë vitit 2021 – 2022 për realizimin e programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni janë angazhuar 19 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 0 pedagogë si personel akademik me kontratë (PAK). Titujt dhe gradat shkencore të personelit akademik janë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 pedagogë me titullin akademik Profesor i Asociuar;</li> <li>- 9 pedagogë me gradën Doktor;</li> <li>- 2 pedagogë në proces doktorature;</li> <li>- 5 pedagogë me kualifikimin MSc.</li> </ul> <p><b>Konstatohet nga GVJ që disa titullarë lëndësh (të paktën 6 të tillë) janë me gradën MSc. Sugjerohet në të ardhmen që titullarët e lëndëve të jenë të paktën me gradën shkencore Dr.</b></p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi. Tabela 7 dhe 10 tek shtojca Aneksi 21. CV e Stafit Akademik të programit të studimit BA&amp;IT Aneksi D17. Rregullorja për politikën dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale Aneksi D2. Organigrama e institucionit, 2016</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë. Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi ka një nivel kualifikimi dhe fushën akademike-kërkimore që është në përputhje me natyrën e këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidenca:</i> Aneksi. Tabela 7 dhe 10 tek shtojca Aneksi 21. CV e Stafit Akademik të programit të studimit BA&amp;IT Aneksi D17. Rregullorja për politikën dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në</p>	<p>IAL IKTsynon që të garantojë mbarëvajtjen e procesit mësimor duke e mbështetur këtë gjë përmes: marrëveshjeve me IAL të tjera publike dhe jo publike brenda dhe jashtë vendit, të tilla si me Universitetin Politeknik, Tiranë; me Universitetin Bujqësor të Tiranës; me Universitetin Aleksandër Xhuvani, Elbasan; me Kolegjin Universitar të Biznesit, Tiranë; me Albanian University, Tiranë; me Universitetin Evropian të Tiranës; me Universitetin e Evropës Jug-Lindore, Maqedoni e Veriut; me Universitetin Aleksandër Moisiu, Durës; me Universitetin Ndërkombëtar të Vizionit, Gostivar, Maqedoni e Veriut; me Universitetin Teknik të Rigës, Letoni; me Shkollën e Lartë Private të Arsimit të lartë, Pavarësia; me Swiss</p>

<p>praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institute; me Kolegjin Profesional të Tiranës; me Universitetin Luigj Gurakuqi, Shkodër; me Universitetin Haxhi Zeka, Pejë, Kosovë; me Universitetin Western Caspian, etj, bashkëpunimin ky me këto institucione homologe për realizimin e konferencave të përbashkëta shkencore si për stafin akademik ashtu dhe për studentët,etj.</p> <p>Gjithashtu, IAL IKT ka marrëveshje për sigurimin e praktikave mësimore në kompani &amp; institucione publike dhe private të tilla si me: Communication Progress shpk; me ECSDEV; me Gea Alpine Center ltd; me Lufthansa Industry Solutions; me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit; me Ditak shpk; me Bursën Shqiptare të Titujve ALSE; me Balfin Group; me Easy Pay shpk; me Gjeo-Vjosa; me Iaste Albania; me Exinn Technology Center shpk; me IN2; me Postën Shqiptare; me Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare; me Procodev Security shpk; etj.</p> <p>Përsa i përket udhëheqjes së punimit të diplomës kjo bëhet kryesisht nga pedagogët efektivë, të cilët gjithashtu kanë kualifikimin e duhur në përshtatje me programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca:</i>  Aneksi 25. Marrëveshjet me universitetet 2016 – 2022  Aneksi 26. Marrëveshje me biznesin, sipërmarrjet dhe institucione të tjera 2016 – 2022  Aneksi 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MASRAneksi. Manuali i Praktikës Mësimore Bachelor FE shqip  Aneksi 13. Manual i Punimit të Tezës së Diplomës</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në bisedat me drejtuesit dhe pedagogët e këtij programi studimi,GVJ u informua qëinstitucioni garanton realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve. Konkretisht, departamenti i IT-së të IAL mirëmban dhe përditëson kompjuterat me versionet më të fundit të paketave operuese, të nevojshme për realizimin e orëve laboratorike, në lëndët në të cilat janë parashikuar laboratorë.Personeli ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ i institucionit kryejnë shërbime për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, këshillim për studentët, dhënien e ndihmës për studentët/tutoriale, etj, si dhe detyrat administrative në funksion të mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca:</i>  Aneksi. Takimi me stafin e IAL IKT</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT



**Standardi III.1****Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se IAL Kolegji Universitar IKT i ka kushtuar një rëndësi të veçantë përdorimit të metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies. KU IKT për të lehtësuar punën e stafit akademik, si dhe për të ndihmuar stafin e ri &amp; për të rritur cilësinë në edukim, në procesin e mësimdhënies ka standardizuar politikat dhe metodat e mësimdhënies. Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit në Fakultetin e Ekonomisë në IKT e ka formalizuar me vendim përdorimin e mjeteve didaktike dhe metodave &amp; teknikave bashkëkohore, si dhe të veprimtarive &amp;workshopeve në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies interaktive. Gjithashtu, është krijuar dhe NjsBC (të formalizuara tek Statuti, Libri i Rregulloreve Institucionale të IKT &amp; Rregullorja e NJSBC) e cila vlerëson periodikisht veprimtaritë mësimore &amp; kërkimore-shkencore, dhe mbi bazën anketimeve jepen sugjerime lidhur me përmirësime potenciale lidhur me metodat e mësimdhënies, literaturën e përdorur, etj. Në Librin e Rregulloreve Institucionale në Kreun III:Programi i lëndës, vlerësimi dhe Këshillimi i Studentit, gjenden katër rregullore të cilat standardizojnë në formë udhezimesh: Strategjitë e mësimdhënies në institucion; Hartimin e programit të lëndës; Vlerësimin e studentit dhe Procesin e Këshillimit. Specifikisht lidhur me programin e studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni metodat e mësimdhënies janë në ndryshim të vazhdueshëm. Një ndër dokumentet më të rëndësishme lidhur me udhëzimet në nivel institucional për metodat dhe teknikat e mësimdhënies është rregullorja: Strategjitë e mësimdhënies në institucion, strategji të zhvilluara pas konsultimit me stafin dhe studentët, dhe të cilat synojnë të jenë fleksibël për t'u përshtatur me ndryshimet dhe për të siguruar përmirësimin e cilësisë në edukim. Strategjitë e mësimdhënies parashikojnë që IKT të angazhohet për: Të mbajtur një profil të kufizuar të disiplinave dhe fushave akademike duke u fokusuar kryesisht në ekonomi dhe inxhinieri; Rritjen e marrëdhënies së ngushtë ndërmjet mësimdhënies, studimit, zhvillimit dhe kërkimit; Të zhvillojë tek studentët frymën etike edukative dhe profesionale, të menduarit kritik, aftësitë analitike dhe zgjidhjen e problemeve, kreativitetin, inovacionin dhe lidhshmërinë; dhe Të sigurojë të diplomuarve konceptet bazë të të mësuarit gjatë gjithë jetës. IKT ka organizuar workshope me pedagogët për trajnimin e tyre në varësi të fushës së studimit, lidhur me mësimdhënien dhe zhvillimin e kompetencave pedagogjike. Mekanizmat më të rëndësishme mbi të cilat duhet të fokusohet procesi i mësimdhënies prej stafit akademik, janë: Atributet e përgjithshme të diplomimit (rezultatet e programit); Atributet specifike për fushën e ekonomisë në përputhje me ato të Amerikës së Veriut dhe Kanadasë; Strategjitë e mësimdhënies dhe të nxënies; dhe Treguesit e synuar të performancës.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016</p> <p>Aneksi D4.3. VSA nr.16 për krijimin e NjsBC 2013</p>





	<p>Aneksi 11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook</p> <p>Aneksi 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017</p> <p>Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (Statuti i IKT, Libri i Rregulloreve Institucionale të IKT, Rregullore e NJSBC, etj), GVJ konstaton se IAL ka ngritur struktura që janë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Monitorimi dhe vlerësimi përfshijnë disa aktorë në rang fakulteti dhe në rang institucional. Në rang fakulteti procesi i monitorimit dhe vlerësimit bëhet në përputhje të përbushjes së objektivave të fakultetit të vendosur në fillim të çdo viti akademik dhe të miratuara prej Senatit Akademik. Të gjitha mekanizmat e monitorimit dhe të vlerësimit përmenden në Manualin e Sigurimit të Cilësisë. Në rang institucional në funksion të sigurimit të cilësisë në KU "IKT" është ngritur një strukturë e cila vepron në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH, e cila njihet si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila është struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, e cila në bashkëpunim me Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit të Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit e realizojnë këtë detyrë duke vlerësuar periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore nëpërmjet kontrolleve, relacioneve të lëndëve, pyetësorëve të studentëve, dhe duke hartuar relacione që propozojnë ndryshime për përmirësime potenciale. NJSBC harton kalendarin e kontrollit të cilësisë për personelin akademik të IKT për të gjithë programet e studimit të ofruara, si dhe harton çdo vit raportin vjetor të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në IKT. Përmirësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative janë të formalizuara gjithashtu dhe tek Plani strategjik i IKT(2024). Gjithashtu, duke nisur nga dekani, zv.dekani si dhe përgjegjësit e departamenteve, të gjithë janë të përfshirë në monitorim dhe më pas në vlerësimin periodik të stafit akademik. Vlerësimi i stafit akademik kryhet nëpërmjet: Raportimeve për përbushjen e detyrave dhe objektivave; Vetëvlerësimit të aktivitetit të tyre; Vlerësimit prej strukturave menaxhuese të njësisë kryesore.</p> <p>KU "IKT" i ka kushtuar rëndësi monitorimit dhe vlerësimit të edukimit, rritjes së cilësisë në zbatimin e standardeve institucionale si dhe proceseve akademike. Sigurimi i cilësisë ka pasur karakter gjithëpërfshirës në të cilin janë angazhuar personel akademik nga të dy fakultetet si dhe studentë. Monitorimi ashtu si dhe vlerësimi është shoqëruar me kërkesa gjithnjë në rritje për realizimin e të cilave nga secili punonjës i kërkohet maksimumi i performancës dhe kualifikimi i vazhdueshëm.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016</p> <p>Aneksi D4.3. VSA nr.16 për krijimin e NJSBC 2013</p> <p>Aneksi 11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook</p> <p>Aneksi 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017</p> <p>Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</p>

	<p>Aneksi 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS</p> <p>Aneksi 31. Model Vetvlerësimi i stafit akademik 2020 - 2021</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Në bazë të Statutit të KU "IKT", NjsBC është struktura e brendshme e përhershme e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. NjsBC përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 2 janë përfaqësues të personelit akademik të njëjësive kryesore (një për secilën njësi); 1 personel i administratës; 1 përfaqësues i Këshillit Studentor; dhe 1 ekspert që drejton njësinë (anëtarët e saj me mandat 4 vjeçar miratohen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit; kryetari i njësisë propozohet nga rektori dhe miratohet në Senatin Akademik). NjsBC organizon plotësimin e pyetësorëve në mënyrë anonime nga studentët (pyetësori zhvillohet online dhe organizohet 2 herë në vit) për vlerësimin periodik të formave të metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, duke përfshirë dhe mundësinë e trajtimit të ankimimeve. NjsBC miraton për çdo vit formatin template të pyetësorit që do të organizohet për studentët e çdo cikli studimi. Studentëve iu mundësohen nga IAL dhe takime me stafin akademik dhe administrativ në prani të NjsBC, ku mund të shprehin opinionet e tyre lidhur me procesin mësimor, si dhe ankesa potenciale që mund të kenë. Të dhënat janë përpunuar nga NjsBC dhe i janë dorëzuar instancave përgjegjëse me synim përmirësimin e cilësisë, rritjen e zbatimit të standardeve të kërkuara si dhe arritjes së objektivave të institucionit. Studentët mund të paraqesin gjithashtu dhe ankesa lidhur me rezultatet e provimit, gjë e cila si procedurë është sanksionuar në rregullore me të gjitha hapat për tu ndjekur.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016</p> <p>Aneksi 29. Model Pyetësori Bachelor Administrim Biznesi &amp; IT</p> <p>Aneksi D4.3. VSA nr.16 për krijimin e NjsBC 2013</p> <p>Aneksi 11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook</p> <p>Aneksi 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017</p> <p>Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NjsBC është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe duke i bërë publike rezultatet e vlerësimit. NjsBC harton kalendarin e kontrollit të cilësisë për personelin akademik të IKT për të gjithë programet e studimit të ofruara, si dhe harton çdo vit raportin vjetor të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në IKT, raport i cili i vihet në dispozicion Rektorit dhe çdo pale të përfshirë në procesin e vlerësimit (Dekanët e fakulteteve, etj; si dhe njofton personalisht pedagogët për vlerësimin e tyre nga studentët), si dhe publikohen dhe në faqen web të IKT (tek NjsBC përfshihen dhe studentët, si palë kryesore e gjithë procesit për cilësi më të mirë). Pyetësorët kanë shërbyer si një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi mbarëvajtjen dhe zhvillimet institucionale, sesi janë perceptuar këto ndryshime prej studentëve, për cilësinë e punës së secilit pedagog, dhe janë burim veprimesh e masash rast pas rasti. Të dhënat mund të gjenden dhe në seksionin e NjsBC (CIT)</p>

	<p>QUA) (<a href="https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/">https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/</a>)</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016</p> <p>Aneksi 29. Model Pyetësori Bachelor Administrim Biznesi &amp; IT</p> <p>Aneksi D4.3. VSA nr.16 për krijimin e NJSBC 2013</p> <p>Aneksi 11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook</p> <p>Aneksi 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017</p> <p>Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2">https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>NJSBC harton çdo vit planin e veprimtarive kryesore. IAL IKT në bashkëpunim me NJSBC, bazuar në raportin vjetor të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në IKT&amp; në rezultatet dhe statistikën e tij, nxjerr konkluzione dhe rekomandime, si dhe planin e masave lidhur me përmirësimin e cilësisë në procesin e mësimdhënies, për inkurajimin e personelit akademik për performancë më të mirë, etj. Njësitë kryesore mund të promovojnë jo vetëm stafin e tyre, por edhe praktikën e mira dhe shembujt që nxisin tek studentët dhe stafi përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Në takimin me drejtuesit e IKT, GVJ u informua që në mbledhjet ku analizohen rezultatet e anketimeve, diskutohen problematikat, por edhe praktikën më të mira të evidentuara, duke i promovuar ato me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm. Përveç NJSBC, një rol të rëndësishëm në monitorimin e procesit mësimor ka edhe Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit, ku Përgjegjësi i këtij departamenti na informoi se në fillim të vitit akademik hartohet plani i punës për personelin akademik për vlerësimin e performancës së pedagogëve, në të cilin përfshihet përveç të tjerave edhe vlerësimi për mësimdhënien. Gjithashtu, Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me NJSBC organizojnë kontrole periodike për mënyrën e zhvillimit të leksioneve dhe seminareve në auditor për të siguruar një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit mësimor. Bazuar mbi vlerësimet, kontributin si dhe ecurinë e proceseve akademike dhe administrative, IAL IKT ka vlerësuar për kontribute personalitete të ndryshme të stafit akademik, si dhe studentë Alumni për arritjet e tyre në karrierë dhe profesion. Gjithashtu IAL IKT në mënyrë promovuese dhe të vazhdueshme ka vlerësuar stafin dhe studentët për arritjet e tyre si në procesin mësimor, ashtu dhe për arritje në aktivitete kurrikulare dhe ekstrakurrikulare të lidhura me kompeticione, projekte etj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi D4.3. VSA nr.16 për krijimin e NJSBC 2013</p> <p>Aneksi 11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook</p> <p>Aneksi 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017</p>

	<p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016</p> <p>Aneksi 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2">https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/a-thank-you-to-prof-llukan-puka/">https://cit.edu.al/a-thank-you-to-prof-llukan-puka/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/cit-10th-anniversary-graduation-ceremony/">https://cit.edu.al/cit-10th-anniversary-graduation-ceremony/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/the-award-ceremony-of-hacktech-2021/">https://cit.edu.al/the-award-ceremony-of-hacktech-2021/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/winning-teams-of-the-cit-summer-school/">https://cit.edu.al/winning-teams-of-the-cit-summer-school/</a> Linku: <a href="https://cit.edu.al/winners-of-the-math-competition/">https://cit.edu.al/winners-of-the-math-competition/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/the-highlights-of-the-payroll-ceremony/">https://cit.edu.al/the-highlights-of-the-payroll-ceremony/</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Lidhur me programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, GVJ konstaton se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve dhe njohurive të miratuara dhe të përdorura janë: leksionet/ seminarët/detyrat e kursit/ rastet studimore, përdorimi i ushtrimeve, projekteve të kërkimit në grup, praktikat profesionale etj, të miratuara/formalizuara nga IAL IKT edhe nëpërmjet Rregullores së programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni.</p> <p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive janë të përcaktuara në syllabuset përkatëse të lëndëve, si dhe sanksionohen në Rregulloren për Programin e Lëndës, e cila ndodhet në Librin e Rregulloreve Institucionale, Kreu III, ku thuhet se format e procesit mësimor janë: Leksioni ... shpjegimi i materialit mësimor nga profesori, në përputhje me programin e miratuar; Seminari, që shërben për të aftësuar studentët të mësojnë në mënyrë aktive dhe efektive (gjatë seminarit, lektori pyet, stimulon, aktivizon dhe ndërvepron me studentët duke përdorur forma të ndryshme dhe teknikat e mësimdhënies); Ushtrimet ... zgjidhin probleme në fusha të tilla si ekonomia, teknologjia e informacionit dhe inxhinieria; Kolokiumi ... një formë e vlerësimit të njohurive të studentëve, e cila jepet me shkrim ose me gojë; Puna laboratorike ... vlerësimi i aftësive të studentëve përmes aktiviteteve praktike në laborator; Detyrat praktike, që synojnë të vlerësojnë aftësinë e studentëve për të materializuar në praktikë njohuritë e fituara teorike; Detyrat e shtëpisë (klasë/shtëpi) synojnë tu mundësojnë studentëve të punojnë dhe të mendojnë në mënyrë analitike, në mënyrë të pavarur dhe kritike (ato mund të jenë analiza, një rishikim libri, etyra krahasuese, detyrë në grup ose pjesëmarrje në kërkime, e cila vlen vetëm për studentët e shkëlqyer dhe vetëm për lëndë të veçanta të programit); Provimet afatmesme dhe ato përfundimtare, që janë format kryesore të vlerësimit të studentëve (si rregull ato zhvillohen</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>me shkrim, ku studentët iu përgjigjen me shkrim pyetjeve të përgatitura të tezës nga pedagogu); Praktika ... detyrim akademik që synon të lidhë dijen teorike me atë praktike, njohuritë e marra gjatë studimeve dhe njohjen e studentëve me tregun e punës); Teza/Diplomimi ... detyrimi përfundimtar i studentit për të marrë një diplomë në fund të studimit, programit (teza është një punë kërkimore individuale, të cilën studenti e kryen gjatë vitit të fundit të studimeve).</p> <p>Personeli akademik gjatë zhvillimit të leksioneve apo seminareve përdor mjetet audivizive, poërpoin, diskutime etj. Për shkak të pandemisë Covid, nga ana e IKT u zhvillua procesi mësimor nëpërmjet platformaveonline, kurse aktualisht po e zhvillojnë në auditor mësimin në bazë të urdhrat të MASR.Praktikat profesionale zhvillohen në institucione/kompani publike dhe private sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka nënshkruar IKT me ta, të cilat i ndihmojnë studentët e programit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni që të fitojnë aftësi praktike dhe eksperiencë për të lidhur teorinë më praktikën, dhe përputhjen me kërkesat e tregut të punës.Studentët dhe personeli akademik mund të aksesojnë faqen web të IAL IKT (www.cit.edu.al), si dhe të aksesojnë sistemin UMS (të drejtën për të aksesuar në këtë sistem e kanë të gjithë ata përdorues që janë të pajisur me një adresë zyrtare nga institucioni) me username-n dhe fjalëkalimin përkatës, ku nëpërmjet këtij sistemi, psh. personeli akademik iu jep akses studentëve në dokumenta të tilla si: syllabuset e lëndëve, materialet mësimore të uploaduara, informacion mbi frekuentimin, vlerësimet e vazhduara, notat, kreditet, etj, dhe shërben si mënyrë komunikimi interaktive pedagog-student dhe për të shkëmbyer informacion ndërmjet personelit dhe studentëve. Staf i akademik mund të ngarkojë leksionet dhe materialet mësimore, si dhe ka forum për të zhvilluar diskutime pedagog-student lidhur me çështje të caktuara të lëndës/modulit.Sistemi ka të integruar platforma si Google Classroom dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Aneksi ... Syllabuset e lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Personeli akademik i IKT u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies (siç u specifikuan te kriteri më lart). Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni përdor metoda bashkëkohore të mësimdhënies e mësimnxënies, ku nga ana e personelit akademik nxitet pjesëmarrja aktive e studentëve në procesin mësimor nëpërmjet përdorimit të metodave interaktive dhe përdorimit të mjeteve mbështetëse të teknologjisë së informacionit (kompjuterat me programet e duhura, projektorë, etj),</p>

	<p>sidomos në bërjen e prezantimeve në grup të rasteve të studimit apo të projekteve të kursit të kompanive të ndryshme të biznesit ... ku pedagogët ftojnë studentët të demonstrojnë në vlerësimin e situatës së bizneseve, problematikave të hasura dhe zgjidhjen e situatës/problematikave duke e vënë veten në rolin e menaxherit të biznesit.</p> <p>KU IKT në Strategjitë e Mësimdhënies tek Libri i Rregulloreve Institucionale, udhëzon stafin akademik që të përqafojnë dhe mbështesin konceptet e reja që lidhen me teknikat pedagogjike dhe metodikën alternative të mësimdhënies. Lektorët prezantojnë dhe përdorin një shumëllojshmëri metodash dhe burimesh të mësimdhënies dhe të nxënit, si brenda dhe jashtë klasës, për të motivuar, sfiduar dhe përfshirë studentët, si: Të nxënit eksperimental; Teknika inteligjente të pyetjeve; Veprimtari praktike; Sesione interaktive në seminare të kombinuara me supervizim; Përdorimi i metodave të ndryshme ndërvepruese; Leksione të udhëhequra nga vet pedagogu; Përdorimi teknikave Virtuale Mësimore; Udhëtime dhe vizita në terren; Ekspertë të ftuar; Punë në grup e bazuar në raste studimore; Detyra të bazuara në kërkim dhe hulumtim.</p> <p>Studentët ndërgjegjësohen për objektivat e të nxënit për çdo orë mësimi dhe mësohen të vlerësojnë, kuptojnë dhe përparojnë herë me pedagogun e herë në ndërveprim me njëri tjetrin, ashtu si edhe duke punuar vetëm.</p> <p>Kriteret e vlerësimit janë të përcaktuara qartë për studentët, në mënyrë që ata të dinë se çfarë duhet të bëjnë për të përmbushur objektivat e mësimi dhe për të marrë maksimumin e vlerësimit.</p> <p>Strategjitë e mësimdhënies parashikojnë në vija të përgjithshme që IKT të angazhohet për: Të mbajtur një profil të kufizuar të disiplinave dhe fushave akademike duke u fokusuar kryesisht në ekonomi dhe inxhinieri; Rritjen e marrëdhënies së ngushtë ndërmjet mësimdhënies, studimit, zhvillimit dhe kërkimit; Të zhvillojë tek studentët frymën etike edukative dhe profesionale, të menduarit kritik, aftësitë analitike dhe zgjidhjen e problemeve, kreativitetin, inovacionin dhe lidhshërinë; T'i sigurojë të diplomuarve konceptet bazë të të mësuarit gjatë gjithë jetës.</p> <p>Në punën e përditshme gjatë procesit mësimor, synohet të kalohet nga metoda tradicionale e të mësuarit në metodën e interaktivitetit në procesin mësimor duke synuar rritjen e rolit të punëve praktike, projekteve, integritit në punën shkencore të pedagogëve, punës në grup etj. Rëndësi e veçantë i jepet zhvillimit të aftësive praktike dhe krijuese tek studentët, duke e orientuar mësimdhënien drejt zbatimit praktik, nëpërmjet ofrimit e zhvillimit të elementëve të tillë, si: projekte, raste studimi, shembuj praktikë dhe simulime kompjuterike të ndryshme; të cilat nga njëra anë respektojnë dhe nxisin autonominë kërkuese të studentëve, e nga ana tjetër u krijojnë atyre një ambient të përshtatshëm, duke u ofruar mundësinë për të testuar njohuritë e tyre në skenarë të jetës reale.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Aneksi ... Syllabuset e lëndëve</p>
<b>Kriteri 3. Institucioni mbështet</b>	GVJ konstaton se IALIKT mbështet personelin e tij akademik në funksion

<p>personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënit, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>të përmirësimit të kompetencave didaktike nëpërmjet seminareve, workshop-eve, trajnimeve të organizuara për këtë qëllim me specialistë të fushave përkatëse. IAL IKT bën monitorimin e vazhdueshëm lidhur me aspektet akademike dhe vë në funksion të personelit akademik logjistikën e nevojshme për realizimin sa më mirë të procesit mësimor. Në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënit, objektivat formuese dhe kërkesat e IAL, IKT mundëson pajisje didaktike për realizimin e orëve të leksioneve dhe të seminareve me mjete &amp; metoda të ndryshme.</p> <p>Metodat përdorura konsistojnë kryesisht në: Organizimine mësimdhënies kryesisht mbi bazën e leksioneve/ushtrimeve/laboratorëve; Zgjerimin substancial të të mësuarit jashtë auditorit në mënyrë të pavarur përmes literaturës shtesë/ndihmëse, ose të dhënave për të studiuar e punuar në mënyrë të pavarur; Detyrat laboratorike të cilat zhvillohen individualisht ose jashtë institucionit; Punën në grup ku zhvillohet komunikimi dhe aftësitë kreative; tematikat mbi të cilat të ndërtohen debate mes studentëve.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>Aneksi 48. Certifikata trajnimesh dhe workshopesh dhënë stafit të IKT</p> <p>Aneksi ... Syllabuset e lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga GVJ konstatohet se Përgjegjësi Departamentit në mbledhjet përkatëse të departamentit, në çdo fillim viti akademik diskuton dhe shqyrton me stafin akademik probleme lidhur me përditësimin e syllabuseve të lëndëve në elementë të caktuar të tyre, si dhe departamenti nxit rritjen e performancës akademike për përdorimin e metodave didaktike të mësimdhënies.</p> <p>Në pjesën më të madhe të tij personeli akademik efektiv (PAE) ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik që kërkon ligji si në drejtimin e programit të studimit edhe në zhvillimin e lëndëve përkatëse. Personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, kjo e bazuar dhe në eksperiencën e tyre ... theksojmë që 2 pedagogë kanë fituar bursa Fulbright nga ku kanë marrë eksperiencë perëndimore në mënyrën e të zhvilluarit mësim, si dhe janë aktivë dhe në jetën publike në fushën specifike si profesionistë të fushës ... si dhe pedagogë të tjerë që vijnë nga eksperiencia të ndryshme në administratën publike në organe drejtuese, etj ... gjë që i ka pajisur ata me aftësi e kompetenca praktike, krahas atyre teorike, për mënyrat e reja të zhvillimit të mësimit në auditore në kohët moderne ku dhe informacioni që kanë studentët është shumë më i madh.</p> <p>Gjatë vitit 2021 – 2022 për realizimin e programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni janë angazhuar 19 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 0 pedagogë si personel akademik me kontratë (PAK). Titujt dhe gradat shkencore të personelit akademik janë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 pedagogë me titullin akademik Profesor i Asociuar;</li> <li>- 9 pedagogë me gradën Doktor;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 pedagogë në proces doktorature;</li> <li>- 5 pedagogë me kualifikimin MSc.</li> </ul> <p>Konstatohet nga GVJ që disa titullarë lëndësh (të paktën 6 të tillë) janë me gradën MSc ... sugjerohet në të ardhmen që titullarët e lëndëve të jenë të paktën me gradën shkencore Dr?!</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi ... Syllabuset e lëndëve</p> <p>Aneksi 22. CV e Stafit Akademik të Fakultetit Ekonomik</p> <p>Aneksi 21. CV e Stafit Akademik të programit të studimit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL IKT, në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ u informua se personeli akademik është gjithmonë i fokusuar tek përmirësimi i metodave të mësimdhënies. Në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, personeli përballet me kërkesat apo sugjerimet e studentëve për procesin mësimor nëpërmjet raporteve periodike që harton NJSBC (çdo vit) bazuar te përdorimi periodikisht i pyetësorëve online (çdo vit miratohet pyetësori template) me studentët (duke ruajtur anonimatit e tyre), por dhe në takime apo biseda të drejtuesve të IAL me studentët me qëllim për të marrë opinionin e studentëve lidhur me programet e studimit, të personelit akademik dhe çdo lëndë të këtij programi. Informacioni që merret nga këta pyetësorë lidhur me vlerësimin e pedagogëve dhe lëndëve, iu kalon pedagogëve përkatës, të cilët bazuar në mendimet dhe sugjerimet e studentëve, bëjnë vlerësimin përkatës dhe përmirësojnë format dhe metodat përkatëse të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 29. Model Pyetësori Bachelor Administrim Biznesi &amp; IT</p> <p>Aneksi D4.3. VSA nr.16 për krijimin e NJSBC 2013</p> <p>Aneksi 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Në takimin me drejtuesit, por edhe pedagogët e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, GVJ u informua që synimi i IAL IKT është që të promovojë metodat e reja të mësimdhënies me në qendër studentin, duke përdorur metoda interaktive dhe diskutimi për kontrollin e dijeve të fituara nga studentit, apo edhe duke i dhënë rëndësi punës së pavarur/individuale të tyre, por dhe punës në grup nëpërmjet rasteve të studimit, detyrave të kursit, eseve, etj, apo duke simuluar situata/problematika të ndryshme në kompani të caktuara duke aplikuar metodën role-playing, dhe duke arsyetuar mbi zgjidhjet që do aplikonin studentët duke e vënë veten e tyre në pozicione të ndryshme në këto organizata dhe marrjen e vendimeve përkatëse për zgjidhjen e problematikave të hasura, etj, mënyra të cilat i bëjnë më tërheqëse orët e mësimi.</p> <p>Nga GVJ konstatohet një përmbushje e mirë e standardeve të brendshme në lidhje me cilësinë e organizimit të lëndëve, përzgjedhjes së literaturës</p>



	<p>(përmes marrëveshjes me McGrawHill Education), si dhe mjeteve e metodave të larmishme didaktike të përdorura gjatë leksioneve dhe seminareve. Cilësia e mësimdhënies lidhet ngushtë me fushën e ekspertizës apo interesave kërkimore shkencore të pedagogëve, të cilat janë pasqyruar në artikuj e botime të tjera shkencore, workshope dhe konferenca. Një aspekt i rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies është trainimi i stafit akademik të IKT në fushën e cilësisë së edukimit (trajtime të ndryshme mbi këtë fushë janë kryer prej NjsBC dhe Rektoratit).</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 22. CV e Stafit Akademik të Fakultetit Ekonomik</p> <p>Aneksi 21. CV e Stafit Akademik të programit të studimit BA&amp;IT</p> <p>Aneksi ... Syllabuset e lëndëve</p> <p>Aneksi 64. Katalogu i Veprimtarive 2020-2022</p> <p>Takimi me stafin akademik</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>IAL IKT në bashkëpunim me NjsBC synon të zbatojë politikën e duhur të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë &amp; standardeve të programeve të saj të studimit dhe të stimulojë nxitjen e vazhdueshme për një pjesëmarrje sa më aktive në të gjitha aktivitetet akademiko-kulturore në funksion të aftësisë të studentëve në drejtime të ndryshme jetësore. Duke pasur si synim studentin në qendër, përdorimi i formave të reja të mësimdhënies inkurajon të menduarin e pavarur dhe kritik nga ana e studentëve duke i bërë ata më autonomë në të menduar e vepruar. GVJ u informua nga studentët se një ndër format e mësimdhënies të zbatuara nga pedagogët ishte nxitja e tyre që të merrnin pjesë aktive gjatë procesit mësimor dhe të zhvillonin detyra në grup dhe projekte kursi të pavaruara &amp; ku kërkohej mendimi kritik i tyre, dhe se marrëdhëniet pedagogë-studentë karakterizoheshin nga një frymë bashkëpunimi e mirëkuptimi për një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit mësimdhënës dhe mësimnxënës. Çdo njësi kryesore e IKT organizon periodikisht seminare të hapura, diskutime me studentët dhe fton personalitete intelektuale të fushave të ndryshme, për ta ndihmuar studentin në formimin e tij profesional. Një pjesë e madhe e këtyre aktiviteteve organizohen me institucione partnere ashtu si dhe me faktorë interesi, biznese, organizata jo qeveritare etj. Një hapësirë e konsiderueshme i është dhënë edhe tryezave më të ftuar nga fusha e biznesit dhe sipërmarrjes për t'i sjellë studentëve fakte konkrete dhe modele të prekshme, që do t'i shërbejnë në të ardhmen si ndihmë dhe eksperiencë praktike.</p> <p>Në frymën dhe vizionin e vet, IKT ka si synim primar që programet e ofruara të jenë të bazuara mbi kurrikulat e huaja, gjë e cila i mundëson studentëve hapësira mobiliteti dhe transferimi në të ardhmen. Meqë gjuha e mësimdhënies është angleze, kjo është në të njëjtën kohë një faktor që ndihmon studentët për të lëvizur dhe kërkuar eksperiencë të reja përtej kufirit shqiptar, sidomos në Evropë dhe në Amerikën Veriore.</p> <p>Institucioni ka organizuar në mënyrë periodike seminare, leksione të hapura, tryeza të rrumbullakëta, trajtime, kompeticione, si dhe aktivitete të</p>

ndryshme për studentët. Fakulteti i Ekonomisë ashtu si dhe Departamenti i Administrimit Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit janë angazhuar që tu krijojnë mundësinë studentëve që të ndërveprojnë edhe me faktorë të jashtëm përgjatë këtyre aktiviteteve (marrëveshjet bashkëpunimit që ka institucioni me kompani, sipërmarrje, banka dhe industri për të zhvilluar një sërë aktiviteteve me përfitime të ndërsjellta).

*Evidenca:*

Aneksi 64. Katalogu i Veprimtarive 2020-2022

Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA&IT

Linku: <https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-and-business-cooperations/>

Linku: <https://cit.edu.al/nurturing-entrepreneurial-mindset-as-a-key-competence-for-innovation/>

Linku: <https://cit.edu.al/highlights-of-the-virtual-ëebinar-ëith-special-guest-mr-joseph-oconnor/>

Linku: <https://cit.edu.al/blockchain-technology-bitcoin-and-beyond/>

Linku: <https://cit.edu.al/eu-exchange-coffee-talks/>

Linku: <https://cit.edu.al/save-the-date-virtual-open-lecture-ëith-dr-emir-dzanic/>

Linku: <https://cit.edu.al/highlights-of-the-virtual-meeting-on-erasmus-and-cits-inter-institutional-agreements-ëith-european-partner-institutions/>

Linku: <https://cit.edu.al/open-lecture-ëith-erdogan-imeri-on-the-topic-of-how-digital-transformation-is-revolutionizing-the-healthcare-industry/>

Linku: <https://cit.edu.al/management-of-information-systems-and-mcgraë-hill-literature/>

Linku: <https://cit.edu.al/online-open-lecture/>

Linku: <https://cit.edu.al/european-digital-week/>

Linku: <https://cit.edu.al/round-table-discussion-with-credins-bank/>

Linku: <https://cit.edu.al/cit-debate-fiscal-package-for-2022s-budget/>

Linku: <https://cit.edu.al/cit-participated-in-the-global-entrepreneurship-week/>

Linku: <https://cit.edu.al/cit-experience-from-finland-to-cit-in-tirana/>

Linku: <https://cit.edu.al/monthly-students-forum-challenges-and-opportunities-of-the-entrepreneurship-in-albania/>

Linku: <https://cit.edu.al/cit-participated-in-a-workshop-held-by-rcdc-albania/>

Linku: <https://cit.edu.al/u-report-albania/>

Linku: <https://cit.edu.al/one-month-internship-in-web-programming/>

Linku: <https://cit.edu.al/cit-team-connectit-programme/>

Linku: <https://cit.edu.al/connectit-graduation-ceremony/>

Linku: <https://cit.edu.al/first-international-hacktech-2021/>

Linku: <https://cit.edu.al/the-award-ceremony-of-hacktech-2021/>

Linku: <https://cit.edu.al/cit-supports-viaecognatia-2-0/>

Linku: <https://cit.edu.al/closing-ceremony-of-women-in-tech/>

Linku: <https://cit.edu.al/visit-at-the-summer-school-of-rzeszow-university-poland/>

Linku: <https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-in-tirana-albania-paid-an-academic-visit-to-digitalb-headquarters/>

Linku: <https://cit.edu.al/ëe-paid-a-visit-to-the-uba-bank/>

**Shkalla e përmbushjes së**

Nuk

Përmbushet

Përmbushet

Përmbushet

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe tek vizita e GVJ në mjediset e IAL IKT, GVJ konstaton se veprimtaria akademike e IKT realizohet në hapësira të bollshme dhe cilësore. Viti 2020 e gjeti KU IKT të zhvendosur në Kampusin e ri, në ambiente të reja infrastrukturore dhe mësimore, duke sjellë një zgjerim më të madh dhe duke qendruar po brenda qytetit të Tiranës, pranë qendrës së saj. Bazuar tek dokumentacioni mbështetës, institucioni e zhvillon veprimtarinë mësimore në një ambient (i marrë me qera deri në mesin e vitit 2025) të pozicionuar në Kompleksin Xhura, Rruga Xhanfize Keko, nr.12, Tiranë, që ofron një infrastrukturë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të programit dhe modulet e tij, si dhe në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara në VKM nr.418, datë 10.05.2017.</p> <p>Ambientet janë komode dhe plotësojnë kushtet higjieno sanitare të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit të studentëve, pedagogëve dhe stafit ndihmës akademik &amp; administrativ. Pra, në tërësi, për studentët krijohet një mjedis i mirë për ndjekjen e leksioneve dhe seminareve.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 33. Kontrata e Qirasë</p> <p>Aneksi 32. Planimetria</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Ambientet e dedikuara për procesin mësimor në IAL IKT janë funksionale (të pastra, me ndriçim dhe ajrosje, me sistem ngrohje &amp; ftohje)&amp; të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor për të arritur objektivat e programit të studimit të ciklit të parë BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni. Në mjediset e IKT gjenden sallat/auditoret e leksioneve, të seminareve, të paktën dy laboratorë informatike (të dedikuara për këtë program studimi), një sallë konferencash dhe biblioteka. Në shërbim të Fakultetit të Ekonomisë janë 2,100 m<sup>2</sup>, prej të cilave në shërbim të procesit mësimor janë 994 m<sup>2</sup>. Sallat e kompjuterave, si dhe auditorët janë të pajisura me bazën materiale të nevojshme për ecuri sa më të mirë të procesit mësimor. Disponohen gjithashtu printera, fotokopje, videoprojektorë, njësi video konference, sistem fonie, etj. Normalisht, zyrat e personelit akademik janë të pajisura me kompjutera dhe gjithë bazën e nevojshme materiale.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 33. Kontrata e Qirasë</p> <p>Aneksi 32. Planimetria</p>


<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>RVB e IAL IKT</p> <p>IAL IKT ka një infrastrukturë të konsoliduar IT dhe laboratorë të teknologjisë së informacionit të pajisur me software për t'i shërbyer sa më mirë procesit mësimor dhe për sistemin e komunikimit të brendshëm, sistem i cili për akses në dokumentacionin elektronik është i konsoliduar për personelin akademik dhe për studentët.</p> <p>KU IKT në funksion të shërbimeve ndaj studentëve, stafit por edhe palëve të treta ka në dispozicion sisteme të ndryshme informatike ku ndër këto sisteme mund të përmenden: E-learning; Google Meet/Classes; UMS (University Management System); McGrawHill Education; Check in/out system; CIT Go Digital; Koha; Platforma O'Reilly (me përjashtim të McGrawHill Education, O'Reilly dhe Koha, të gjitha sistemet e tjera janë platforma të zhvilluara prej stafit dhe studentëve ose të ofruara prej Google duke qenë se IKT është përdorues i kësaj platforme dhe domeini).</p> <p>Studentët dhe personeli akademik mund të aksesojnë faqen web të IAL IKT (<a href="http://www.cit.edu.al">www.cit.edu.al</a>), si dhe të aksesojnë sistemin UMS (të drejtën për të aksesuar në këtë sistem e kanë të gjithë ata përdorues që janë të pajisur me një adresë zyrtare nga institucioni) me username-n dhe fjalëkalimin përkatës, ku nëpërmjet këtij sistemi, psh. personeli akademik iu jep akses studentëve në dokumenta të tilla si: syllabuset e lëndëve, materialet mësimore të uploaduara, informacion mbi frekuentimin, vlerësimet e vazhduara, notat, kreditet, etj, dhe shërben si mënyrë komunikimi interaktive pedagog-student dhe për të shkëmbyer informacion ndërmjet personelit dhe studentëve. Stafit akademik mund të ngarkojë leksionet dhe materialet mësimore, si dhe ka forum për të zhvilluar diskutime pedagog-student lidhur me çështje të caktuara të lëndës/modulit. Sistemi ka të integruar platforma si Google Classroom dhe Google Meet dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi D5.1. Marrëveshja CIT - TEXO (përfaqësues i O'Reilly)</p> <p>Aneksi D5.2. CIT McGrawHill Marrëveshje 2021-2024</p> <p>Aneksi 32. Planimetria</p> <p>RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Vlen të theksohet që IKT në mënyrë të vazhdueshme pasuron literaturën në përputhje me kurrikulat mësimore për të garantuar marrjen e dijeve të duhura të parashikuara në programin e studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni. Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit harton plane të detajuara për shtimin e librave në bibliotekë dhe i bën në mënyrë të vazhdueshme propozime Dekanit dhe Administratorit të IKT për blerjen e librave të rinj mësimorë. Në mënyrë të vazhdueshme bëhen blerje të librave, të artikujve shkencore, si dhe biblioteka pasurohet dhe me revista shkencore në fushën e ekonomisë. Që prej vitit 2016 e deri më sot, IKT vazhdon të mbajë aktive marrëveshjen me një ndër kompanitë më të njohura dhe më serioze në tregun global të ofrimit të literaturës akademike siç është McGraw-Hill Education (duke qenë se marrëveshja përfundoi me vitin akademik 2020-2021, institucioni vendosi që ta rinovojë sërish këtë marrëveshje për një term të ri 3-vjeçar, duke siguruar garancinë e një literature moderne). Literatura me të cilën kjo kompani furnizon IKT është jo vetëm ndër më të pasurat por dhe ndër më të</p>

	<p>përditësuarat dhe i mundëson stafit akademik të programit të studimit si dhe institucionit e studentëve një larmi të madhe përzgjedhje dhe shërbimesh të cilat lehtësojnë marrëdhënien pedagog-student si dhe ndihmojnë procesin e mësimdhënies e mësimnxënies. Gjithashtu mund të thuhet se shërbimi për stafin akademik jepet pa pagesë, duke përfituar pa limit prej platformës, gjë e cila i mundëson stafit që të ketë dhe përdori një literaturë të pasur në kërkimin shkencor dhe të përditësohet me publikimet më të fundit të monografive dhe literaturës në fushën që mbulon (e gjithë literatura e programit të studimit ofrohet në gjuhën angleze).</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 68. CIT - Agjencia e Abonimit të Shtypit 15.09.2021  Aneksi D5.1. Marrëveshja CIT - TEXO (përfaqësues i O'Reilly)  Aneksi D5.2. CIT McGrawHill Marrëveshje 2021-2024</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se biblioteka disponon në fondin e saj rreth rreth 3,000 tituj, me rreth 20 tituj në gjuhën shqipe dhe rreth 2,780 tituj në anglisht (dhe me një sektor të veçantë të gjuhës së huaj, si frëngjisht, spanjisht, gjermanisht, italisht), ku një pjesë e librave fizikë janë të dedikuara për fushën e ekonomisë, si dhe një numër të konsiderueshëm revistash, cikël leksionesh dhe materiale të tjera në ndihmë të studentëve. Përveç bibliotekës fizike, ekziston dhe biblioteka virtuale në bazë të marrëveshjes së IAL IKT me McGrawHill Education (aksesohet duke u loguar nga kudo) dhe Platformës O'Reilly (aksesohet vetëm nga log-imi në bibliotekën e IAL IKT).</p> <p>Në takimin me përgjegjësin e Departamentit të Administrimit Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit, dhe punonjësen e bibliotekës, konstatohet që në fund të vitit akademik, biblioteka dërgon një Formular për kërkesë librash për të gjithë personelin e departamentit, duke i lejuar stafit akademik deri në dy muaj kohë që të japin informacione në lidhje me titujt që ata mendojnë se duhen patur e të jenë në gjendje në bibliotekë për vitin e ardhshëm akademik. Pas krijimit të listës së materialeve akademike të kërkuar nga pedagogët, biblioteka fillon blerjet duke u siguruar që titujt e duhur të jenë në kohën e duhur për stafin akademik dhe studentët e IAL IKT.</p> <p>KU IKT ka marrëveshje dhe me Agjencinë e Abonimit të Shtypit për sigurimin e periodikëve më të njohur ndërkombëtarë në fushën e ekonomisë dhe të inxhinierisë, ku merr rregullisht numrat më të fundit të revistave dhe periodikëve të këtyre fushave dhe pasuron bibliotekën me to.</p> <p><b><i>Megjithatë GVJ mendon se pavarësisht se IAL IKT ka bërë përpjekje të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, përsëri ka vend për shtimin e titujve të librave në literaturën fizike në gjuhën shqipe për të mbështetur nevojat e programit Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni.</i></b></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 43. Të dhëna mbështetëse për blerjen e literaturës në bibliotekën e IKT  Aneksi 44. Të dhëna mbi bibliotekën OREILLY-TEXO për CIT  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale, Kapitulli VII, Pika 6 Rregullore e</p>

	bibliotekës. Aneksi 68. CIT - Agjencia e Abonimit të Shtypit 15.09.2021 Aneksi D4.2. CIT McGrawHill Marrëveshje 2021-2024 Aneksi D4.1. Marrëveshja CIT - TEXO (përfaqësues i O'Reilly) Linku: <a href="https://cit.edu.al/mcgraw-hill-literature/">https://cit.edu.al/mcgraw-hill-literature/</a> Linku: <a href="https://cit.edu.al/library-2/">https://cit.edu.al/library-2/</a> RVB e IAL IKT
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	<p>Gjatë vizitës në mjediset e bibliotekës së IAL IKT, si dhe mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar &amp; takimi me studentët, GVJ u informua nga punonjësja e bibliotekës që IAL IKT ka zgjedhur të bëjë abonimin në bibliotekat online/virtuale, konkretisht në bazë të marrëveshjes së IAL IKT me McGrawHill Education (aksesohet duke u loguar nga kudo) dhe Platformës O'Reilly (aksesohet vetëm nga log-imi në bibliotekën e IAL IKT), në mënyrë që dhe shërbimi të jetë në përputhje me nevojat që kërkon stafi dhe studentët, si dhe u konstatua që kushtet për akses janë të barabarta e pa pagesë për studentët në aksesimin e bibliotekës on-line.</p> <p>Siç u tha më lart, biblioteka virtuale mund të aksesohet nga kudo, duke përfshirë dhe aksesimin në ambientet fizike të saj. Shërbimi bibliotekar kryhet prej punonjësve të caktuar posaçërisht nga IAL IKT dhe ofrohet për studentët &amp; stafin akademik të fakultetit. Biblioteka ka një sipërfaqe prej 90 m<sup>2</sup>, me një kapacitet prej 20 vendesh, ku 6 vende janë për përdorim kompjuteri dhe interneti. Oraret që biblioteka qëndron e hapur për studentët dhe stafin është në ditët: E Hënë –E Premte, ora 09<sup>00</sup> – 13<sup>00</sup>&amp; 14<sup>00</sup> – 18<sup>00</sup>, dhe të Shtunën 08<sup>00</sup>-15<sup>00</sup>. Përveç aksesimit të bibliotekës online në ambientet e bibliotekës së IAL IKT (por dhe jashtë saj), studentët dhe stafi mund të shfletojnë materialet e bibliotekës në një sallë leximi komode, të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme. Fondi i librave është 'Fond i hapur', që do të thotë se studenti ka mundësi të përzgjedhë librat vetë në rafte, të sistemuar sipas Sistemit Decimal, sistem i cili e bën akoma më të lehtë shfrytëzimin e librave dhe revistave.</p> <p>Mbahen takime/seminare të rregullta me studentët dhe stafin akademik, duke i njohur me përdorimin e Bibliotekës Virtuale, konkretisht seminarët me përfaqësuesit e McGraw-Hill Education, etj. Gjithashtu, janë krijuar dhe u janë shpërndanë studentëve &amp; stafit udhëzues PDF për përdorimin e bibliotekës online.</p> <p><b><i>Megjithatë GVJ konstaton se numri i kompjuterave/laptopëve është i vogël dhe sugjeron shtimin e tyre në bibliotekë për t'i shërbyer sa më mirë navigimit të studentëve në burimet online të literaturës.</i></b></p> <p><i>Evidenca:</i>          Aneksi 44. Të dhëna mbi bibliotekën OREILLY-TEXO për CIT          Aneksi D4.2. CIT McGrawHill Marrëveshje 2021-2024          Aneksi D4.1. Marrëveshja CIT - TEXO (përfaqësues i O'Reilly)          Aneksi 68. CIT - Agjencia e Abonimit të Shtypit 15.09.2021          Linku: <a href="https://cit.edu.al/mcgraw-hill-literature/">https://cit.edu.al/mcgraw-hill-literature/</a>          Linku: <a href="https://cit.edu.al/library-2/">https://cit.edu.al/library-2/</a>          Linku: <a href="https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-in-partnership-ëith-mcgraw-hill-has-delivered-training-on-the-latest-updates-of-mcgraw-hill/">https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-in-partnership-ëith-mcgraw-hill-has-delivered-training-on-the-latest-updates-of-mcgraw-hill/</a></p>



	<p>Aneksi 43. Të dhëna mbështetëse për blerjen e literaturës në bibliotekën e IKT Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale, Kapitulli VII, Pika 6 Rregullore e bibliotekës.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacionianë në dispozicion së paku dy laboratorë informatikë cilët mund të shfrytëzohen nga studentët e këtij programi për të përgatitur detyrat në grup, projektet e kursit, diplomat, etj. Të gjithë laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet (softuerët) e duhur për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Sistemet e operimit janë Windows (10) dhe Linux (Ubuntu 14.04). Çdo kompjuter i laboratorit ka të instaluar paketën Office Professional 2010 ose 2013 (Word, Excel, Access, Poëer Point, Outlook etj.). Gjithashtu janë të instaluar programet profesionale si: Financa 5, SPSS, Gretl, MS SQL Server 2014; Microsoft Visual Studio 2015; NetBeans 8.2, etj. Laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin sa më modern të procesit mësimor. Instalimi, mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i departamentit të IT. Instalimet e programeve të reja bëhen në kohë reale në bazë të kërkesave të pedagogëve (kompjuterat kanë të instaluar një antivirus, Microsoft Security Essentials, i cili mundëson sigurimin e dokumenteve dhe të dhënave të tjera prej infektimit nga viruse të ndryshme).</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 32. Planimetria</p> <p>Aneksi. RVB e IAL</p> <p>Takmi me drejtues të IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Personeli akademik i IKT është i angazhuar në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit, dhe mbështetin &amp; nxit kolegët e tyre dhe studentët për përdorimin e këtyre teknologjive. Studentët dhe personeli akademik mund të aksesojnë faqen web të IAL IKT (www.cit.edu.al), si dhe të aksesojnë sistemin UMS (të drejtën për të aksesuar në këtë sistem e kanë të gjithë ata përdorues që janë të pajisur me një adresë zyrtare nga institucioni) me username-n dhe fjalëkalimin përkatës, ku nëpërmjet këtij sistemi, psh. personeli akademik iu jep akses studentëve në dokumenta të tilla si: syllabuset e lëndëve, materialet mësimore të uploduara, informacion mbi frekuentimin, vlerësimet e vazhduara, notat, kreditet, etj, dhe shërben si mënyrë komunikimi interaktive pedagog-student dhe për të shkëmbyer informacion ndërmjet personelit dhe studentëve. Stafi akademik mund të ngarkojë leksionet dhe materialet mësimore, si dhe ka forum për të zhvilluar diskutime pedagog-student lidhur me çështje të caktuara të lëndës/modulit. Sistemi ka të integruar platforma si Google Classroom dhe Google Meet dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Duhet thënë që pedagogët që japin mësim në programin BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni i përdorin të gjitha burimet elektronike që ofron IAL të tilla si internetin, bibliotekën online, platformën UMS, dhe mjetet audiovizive për zhvillimin normal të procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>RVB e IAL IKT</p> <p>Aneksi D4.2. CIT McGrawHill Marrëveshje 2021-2024</p> <p>Aneksi D4.1. Marrëveshja CIT - TEXO (përfaqësues i O'Reilly)</p>



<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>IAL ka kompjutera me akses në internet dhe komunikimi ndërmjet personelit akademik dhe atij administrativ zhvillohet nëpërmjet domainit të kolegjit zyrtar. Studentët dhe personeli akademik mund të aksesojnë faqen web të IAL IKT, si dhe të aksesojnë sistemin UMS (të drejtën për të aksesuar në këtë sistem e kanë të gjithë ata përdorues që janë të pajisur me një adresë zyrtare nga institucioni) me username-n dhe fjalëkalimin përkatës, ku nëpërmjet këtij sistemi, psh. personeli akademik iu jep akses studentëve në dokumenta të tilla si: syllabuset e lëndëve, materialet mësimore të uploaduara, informacion mbi frekuentimin, vlerësimet e vazhduara, notat, kreditet, etj, dhe shërben si mënyrë komunikimi interaktive pedagog-student dhe për të shkëmbyer informacion ndërmjet personelit dhe studentëve. Stafi akademik mund të ngarkojë leksionet dhe materialet mësimore, si dhe ka forum për të zhvilluar diskutime pedagog-student lidhur me çështje të caktuara të lëndës/modulit. Studentët mund të logohen në UMS përmes faqes web të institucionit në menunë My CIT. Sistemi ka të integruar platforma si Google Classroom dhe Google Meet dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. IAL IKT ka zgjedhur të bëjë abonimin në bibliotekat online/virtuale, konkretisht në bazë të marrëveshjes së IAL IKT me McGrawHill Education (aksesohet duke u loguar nga kudo) dhe Platformës O'Reilly (aksesohet vetëm nga log-imi në bibliotekën e IAL IKT), në mënyrë që dhe shërbimi të jetë në përputhje me nevojat që kërkon stafi dhe studentët, si dhe u konstatua që kushtet për akses janë të barabarta e pa pagesë për studentët në aksesimin e bibliotekës on-line</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi D4.2. CIT McGraw Hill Marrëveshje 2021-2024  Aneksi D4.1. Marrëveshja CIT - TEXO (përfaqësues i O'Reilly)  Linku: <a href="https://cit.edu.al/my-cit-2/">https://cit.edu.al/my-cit-2/</a>  RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Plani i diplomimit është në përshtatje me planin mësimor. Lidhur me programin e studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, GVJ kostanton se kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në IAL IKT përcaktohen në Rregulloren e programit dhe Rregulloren e punimit të tezës së diplomës (të cilat u dërgohen studentëve edhe me email nga sekretaria e fakultetit ose përgjegjësi i departamentit). Studentët njihen gjithashtu edhe me formularin që duhet të plotësojnë për të aplikuar për zgjedhjen e temës së diplomës si dhe caktimin e pedagogut udhëheqës (atyre u shpërndahen tematikat e sugjeruara për tu zgjedhur prej tyre për diplomim, si dhe u shpjegohen procedurat e punimit të temës së diplomës dhe rregullorja përkatëse).</p> <p>IKT informon dhe orienton studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në takimet që njësitë bazë bashkë me koordinatorët zhvillojnë gjatë vitit. Informimi bëhet para se të fillojë semestri i dytë i vitit të tretë dhe zgjedhja e temës së punimit bëhet para se të fillojë periudha e praktikës profesionale. Një informacion paraprak për diplomimin studentët e marrin që në vitin e parë kur regjistrohen dhe institucioni u dërgon Guidën e Studentit (e cila gjendet edhe online .... në pikën 2.10 të saj</p>



	<p>Diplomimi, studentëve u jepet informacion për përmbushjen e kriterëve për diplomim si dhe informacione të tjera të vlefshme). Gjithashtu në Javën e Orientimit (në fillim të çdo semestri) studentëve të vitit të tretë BSc, u jepen prej drejtuesve të institucionit informacione të detajuara lidhur me diplomimin. Personeli akademik krahas orientimit të studentëve në përzgjedhjen e temave të diplomave, i asiston dhe mbështet ata në zhvillimin e diplomave. Ndërkohë që datat e mbrojtjes së diplomës përcaktohen prej Departamentit dhe Fakultetit sipas Planit Kalendarik Vjetor të KU IKT të miratuar për vitin përkatës. Në takimin me studentët gjatë vizitës në IAL IKT, GVJ konstatoi se studentët kishin marrë informacionin dhe orientimin e nevojshëm për procesin e diplomimit të tyre.</p> <p><i>Evidenca:</i>  Aneksi 13. Manual i Punimit të Tezës së Diplomës  Aneksi 69. Model i përcaktimit të temës së diplomës  Aneksi 10. Rregullore e programit të studimit BA&amp; IT  Aneksi D1. Guida e Studentit  Linku: <a href="https://cit.edu.al/orientation-and-integration-week-at-cit/">https://cit.edu.al/orientation-and-integration-week-at-cit/</a>  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi 12. Rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022  Aneksi 6. Rregullore institucionale e KU IKT  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e Departamentit të BA &amp; IT  Aneksi 17. Miratimi i formës sëdiplomës + suplementi BA&amp;IT</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (Libri i Rregulloreve Institucionale, Manuali i Stafit Akademik, Statuti i IKT), GVJ konstaton se IAL ka ngritur struktura që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe koordinojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, konkretisht në rang institucional për promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, IKT ka ngritur këto njësi: Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), dhe Komitetin Permanent për Programet &amp; Kurrikulat.</p> <p>NJSBC e IAL IKT e krijuar në vitin 2013 është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe procedurave në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe garanton cilësinë e aktiviteteve akademike, aktiviteteve kulturore dhe sociale të stafit akademik dhe studentëve, si dhe aktivitetet administrative të IKT. Kompetencat e NJSBC janë: Të hartojë politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik; Të hartojë standardet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë; Të vlerësojë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive</p>

	<p>mësimore dhe kërkimore - shkencore në njësitë kryesore të Kolegjit në përputhje me standardet; Të kryejë studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji; Në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësit studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi; Pas çdo vlerësimi të raportoje para Senatit Akademik rezultatet dhe propozimet përkatëse.</p> <p>Komiteti Permanent për Programet dhe Kurrikulat (KPPK) i përbërë së paku nga 4-6 anëtarë (anëtarët e tij zgjidhen në Senatit Akademik), është organi më i lartë që kontribuon në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Në zgjedhjen e anëtarëve të komisionit merret parasysh përvoja në mësimdhënie dhe kryesuesi i komisionit duhet të jetë profesor me eksperiencë të konsiderueshme.</p> <p>KPPK vlerëson nevojat institucionale për hapjen e programeve të reja; vlerëson situatën në programet ekzistuese; propozon ndryshime për programet që nuk plotësojnë nevojat institucionale; etj, si dhe vlerëson e propozon veprime ose ndryshime me kërkesë të Senatit Akademik ose aktorëve të tjerë përkatës në institucion (si këshillat e fakulteteve, dekanët ose drejtuesit e departamenteve).</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 14. Manuali i Stafit Akademik Tetor 2021  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi 1. Statuti i KU IKT 2016</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personelit akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe veçanërisht Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit janë njësitë përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personelit akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, konkretisht duke synuar ofrimin e programeve bashkëkohore të studimit nëpërmjet angazhimit të stafëve të duhura dhe të përkushtuara akademike, duke ndërtuar dhe marrëdhënie të mira me kompani të ndryshme vendase dhe të huaja që i ndihmojnë studentët në kryerjen e praktikave, etj. Njësia kryesore organizon mbledhje të herëpashershme të Këshillit të Fakultetit në të cilat diskutohen të gjitha problematikat që kanë të bëjnë me cilësinë e mësimdhënies, çështje që kanë të bëjnë me stafin akademik dhe studentët. Këshilli i Fakultetit shprehet me vendime ose propozon pranë Senatit Akademik hapa të mëtejshëm për aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me programin e studimit.</p> <p>Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit bashkëpunon me NjSBC për çështje të caktuara që kanë lidhje me programin e studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, si dhe organizon takime me stafin e angazhuar në programin e studimit në të cilat diskutohen çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit, literaturës, aspekte teknike të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së organizimit të orës së mësimi, kërkimin shkencor dhe angazhimin e studentëve në projekte e detyra kursi për të përthithur sa më mirë aftësitë dhe kompetencat që duhet të marrin nga secila lëndë, si dhe sugjerohet marrja e masave të duhura të përmirësimit kur është e nevojshme. Në mënyrë periodike, Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit bën dhe analizën vjetore sipas fushave përkatëse. Qëllimi është që të ketë përmirësime në ato fusha/sectorë që kanë nevojë për ndërhyrje.</p>

	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS Takimi me stafin akademik dhe NjSBC RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton gjithashtu se njësitë përgjegjëse për programin e studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni i japin një rëndësi të veçantë përdorimit të metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies, të cilat lidhen me përdorimin e kompjuterave dhe mënyrave audiovizive në zhvillimin e lëndëve të ndryshme. Gjithashtu, IAL ka hartuar planin strategjik të zhvillimit 2024 ku ka përcaktuar prioritetet dhe objektivat strategjike në përputhje me sfidat që hasen nga arsimi i lartë, si dhe objektiva konkretë që lidhen me zhvillimin e përmirësimit e programeve, etj. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse kanë organizuar aktivitete kërkimore shkencore apo trajnuese të tilla si leksione të hapura në bashkëpunim me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë apo konferenca studentore ndëruniversitare në bashkëpunim me universitete të ndryshme të vendit, si dhe mobilitete Erasmus+ të stafit akademik me të cilët kanë marrëveshje. Baza për zhvillimin e procesit mësimor në KU IKT janë rregulloret: Strategjitet e Mësimdhënies në IKT; Plani Strategjik për LLL dhe Hartimi i Programit të Lëndës (të tre këto dokumente kanë rezultuar të efektshme në të gjitha proceset ku përfshihet mësimdhënia). IKT ka përdorur platformat: Google Classroom, Google Drive dhe Google Meet në proceset e veta administrative institucionale. Në funksion të mësimdhënies IKT (përpara pandemisë) ka përdorur dy platforma e-learning (që bazohen në sistemin Moodle) si: CIT E-learning (punuar prej stafit dhe studentëve) dhe CIT Go Digital (punuar prej stafit dhe studentëve).</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale Aneksi 4. Miratimi i planit strategjik për LLL Aneksi 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017 Aneksi 3. Plani Strategjik dhe Biznes Plani KU IKT , miratuar me VSA nr.5.1, 24.05.2012 RVB e IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Gjatë takimit në institucion me personelin akademik përgjegjës për programin e studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, GVJ u informua se IKT ofron angazhimin e vet për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit në fushën e kërkimit shkencor. IAL IKT mbështet pjesëmarrjen e personelit akademik dhe atij mbështetës në mobilitetet ERASMUS+ dhe projekte me partnerë të huaj si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe aftësive kërkimore, si dhe pedagogët e programit angazhohen në konferenca të ndryshme shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. I gjithë stafi akademik është në përmirësim të vazhdueshëm, duke ndjekur kualifikime, trajnime, certifikime në fushën e tyre të kërkimit shkencor në mënyrë që</p>

	<p>produkti final të jetë përmirësimi i karrierës së tyre si dhe procesit mësimor. Vendimi i Bordit të Administrimit nr.1, datë 29.05.2020 (në pikën 1 të tij, Struktura e Pagave për Stafin Akademik) ka përcaktuar edhe kriteret dhe kategoritë e stafit akademik që përfitojnë prej reduktimit të ngarkesës mësimore. Gjithashtu në Manualin e Stafit Akademik lidhur me prezencën dhe ngarkesën mësimore thuhet: Anëtarët e fakultetit me kohë të plotë duhet të jenë të disponueshëm në kampus gjatë vitit akademik siç specifikohet në kalendarin akademik; Anëtarët e fakultetit mund të marrin leje për zhvillim profesional ose në raste urgjente me autorizim me shkrim nga drejtuesi i programit dhe dekani; Anëtarët e fakultetit mund të kërkojnë kohë të limituar të mësimdhënies për kërkime shkencore dhe zhvillim; Çdo lëndë shtesë e dhënë konsiderohet si mbingarkesë dhe duhet të kompensohet. Të gjitha arritjet, kualifikimet dhe certifikimet e stafit akademik ndikojnë në përmirësimin e mëtejshëm jo vetëm profesional të tyre por edhe të procesit mësimor duke sjellë njohuri, praktika dhe informacione të reja.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 57. Vendim BA nr.1 - Struktura e Pagave 29.05.2020  Aneksi 14. Manuali i Stafit Akademik Tetor 2021  Aneksi 38. Burimet Njerëzore - Check Lista e dosjes personelit  Aneksi 48. Certifikata trajnimesh dhe workshopesh dhënë stafit të IKT</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se IAL IKT i mundëson stafit akademik trajnime në përputhje me programin vjetor të Departamentit të Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit. Trajnimet konsistojnë kryesisht në lidhje me përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. IAL IKT përmes strukturave përgjegjëse gjatë viteve të fundit ka zhvilluar trajnime të ndryshme për personelin akademik për përmirësimin e aftësive të tij në mësimdhënie, si dhe përdorimin &amp; implementimin e metodave të reja pedagogjike, konkretisht janë zhvilluar këto trajnime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Trajnimi për platformën Google Meet;</li> <li>- Cilësia e edukimit: Qasja e bazuar në rezultate;</li> <li>- Cilësia e edukimit: Përgatitja e provimeve;</li> <li>- Cilësia e edukimit: Si të vlerësojmë studentët;</li> <li>- Trajnimi mbi përdorimin e Google për të gjitha proceset mësimore;</li> <li>- Workshop mbi Sistemin e Edukimit Amerikano-Verior;</li> <li>- Trajnimi: Unë mund të ndryshoj botën;</li> <li>- Trajnimi Profesional në 'Cloud Computing dhe DevOps – Përparësitë konkurruese dhe koha më e shpejtë për në treg';</li> <li>- Trajnimi virtual mbi Ekonometrinë;</li> <li>- Trajnimi mbi përditësimet më të fundit të literaturës akademike të McGrawHill Education;</li> <li>- Workshopi: Aplikimi i elementeve të lojës në edukim;</li> <li>- Workshopi: Përmirësimi i novacionit me gamifikim;</li> <li>- Seminari: Rritja e vizibilitetit të Kërkimit Shkencor dhe Rankimit të Universitetit;</li> <li>- Trajnimi: Hyrje në Photoshop;</li> <li>- Trajnimi mbi teknikat e mësimdhënies dhe cilësinë e edukimit;</li> <li>- Trajnimi mbi Programin e studimit dhe punimin e programit të lëndës.</li> </ul>

	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi.Certifikatat e trajnimeve dhe workshopeve të ndryshme” (certifikatat janë për ato trajnime që IKT ka shpërndarë certifikata, për të tjerat janë lajmet e dhëna në faqen zyrtare të institucionit).</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/google-meet-training/">https://cit.edu.al/google-meet-training/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/professional-training-cloud-computing-and-devops-training-competitive-advantage-and-faster-time-to-market/">https://cit.edu.al/professional-training-cloud-computing-and-devops-training-competitive-advantage-and-faster-time-to-market/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/devops-culture-open-lecture/">https://cit.edu.al/devops-culture-open-lecture/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-in-partnership-ëith-mcgraw-hill-has-delivered-training-on-the-latest-updates-of-mcgraw-hill/">https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-in-partnership-ëith-mcgraw-hill-has-delivered-training-on-the-latest-updates-of-mcgraw-hill/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/improve-innovation-with-gamification-ëorkshop-highlights/">https://cit.edu.al/improve-innovation-with-gamification-ëorkshop-highlights/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/improve-innovation-with-gamification-workshop-highlights/">https://cit.edu.al/improve-innovation-with-gamification-workshop-highlights/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/save-the-date-seminar-on-friday-7th-of-may-2021-at-1400/">https://cit.edu.al/save-the-date-seminar-on-friday-7th-of-may-2021-at-1400/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/quality-assurance-meeting/">https://cit.edu.al/quality-assurance-meeting/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/welcoming-and-training-the-new-academic-staff-at-cit/">https://cit.edu.al/welcoming-and-training-the-new-academic-staff-at-cit/</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Në bazë të informacioneve të marra në takimin me Përgjegjës të Departamentit të Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe pedagogët e këtij programi studimi, GVJ konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik në Fakultetin e Ekonomisë, si dhe ai në Departamentin e Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, madje Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit sheh si prioritet zgjedhjen e nje stafi të kualifikuar akademik dhe ndihmës akademik me qëllim angazhimit seriozisht në përmirësimin e procesit të mësimdhënies duke patur në qendër studentin. Trajnimet e zhvilluara prej IAL IKT dhe të përmendura në Kriterin 5, shërbejnë për të mbështetur stafin akademik në përmirësimin e mësimdhënies si dhe implementimin e metodave ekzistuese dhe atyre inovative. Angazhimi i stafit është konkret, edhe pse stafi i ri në institucion kërkon kohën e tij që të përshtatet me metodat e mësimdhënies si dhe praktikat institucionale.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi. Takimi me stafin e IAL IKT</p> <p>Aneksi.Certifikatat e trajnimeve dhe workshopeve të ndryshme” (certifikatat janë për ato trajnime që IKT ka shpërndarë certifikata, për të tjerat janë lajmet e dhëna në faqen zyrtare të institucionit).</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/google-meet-training/">https://cit.edu.al/google-meet-training/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/professional-training-cloud-computing-and-devops-training-competitive-advantage-and-faster-time-to-market/">https://cit.edu.al/professional-training-cloud-computing-and-devops-training-competitive-advantage-and-faster-time-to-market/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/devops-culture-open-lecture/">https://cit.edu.al/devops-culture-open-lecture/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-in-partnership-ëith-mcgraw-hill-has-delivered-training-on-the-latest-updates-of-mcgraw-hill/">https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-in-partnership-ëith-mcgraw-hill-has-delivered-training-on-the-latest-updates-of-mcgraw-hill/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/improve-innovation-ëith-gamification-ëorkshop-highlights/">https://cit.edu.al/improve-innovation-ëith-gamification-ëorkshop-highlights/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/improve-innovation-ëith-gamification-workshop-">https://cit.edu.al/improve-innovation-ëith-gamification-workshop-</a></p>




	<p>highlights/          Linku: <a href="https://cit.edu.al/save-the-date-seminar-on-friday-7th-of-may-2021-at-1400/">https://cit.edu.al/save-the-date-seminar-on-friday-7th-of-may-2021-at-1400/</a>          Linku: <a href="https://cit.edu.al/quality-assurance-meeting/">https://cit.edu.al/quality-assurance-meeting/</a>          Linku: <a href="https://cit.edu.al/welcoming-and-training-the-new-academic-staff-at-cit/">https://cit.edu.al/welcoming-and-training-the-new-academic-staff-at-cit/</a></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik dhe ai ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmërive dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në Departamentin e Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit. Ekziston një formular vlerësimi performance, ku performanca e personelit akademik si dhe rezultatet e punës së tyre analizohen në mbledhjet periodike të departamentit si dhe në raportin periodik të NjSBC. Prej trajnimeve të zhvilluara për aftësimin e stafit dhe përdorimin e metodave inovative janë: trajnimi për platformën e Google Meet/Google Class, trajnimi për metodat e përgatitjes së provimeve dhe vlerësimeve sipas sistemit të Amerikës së Veriut, ai mbi rritjen e vizibilitetit të Kërkimit Shkencor dhe Rankimit të Universitetit, ai për literaturën më të fundit akademike të Kompanisë McGrawHill, trajnimi në Cloud Computing, trajnimi mbi përdorimin e lojrave për të rritur efikasitetin në procesin mësimor etj, trajnime të mbajtura prej pedagogëve apo specialistëve me shumë eksperiencë. Më pas njohuritë e dhëna në këto trajnime janë aplikuar prej stafit gjatë procesit mësimor të atij viti akademik ose dhe në vazhdim.</p> <p>GVJ konstaton gjithashtu se IKTpërpiket të mbështesë personelin akademik për pjesëmarrje në konferenca si dhe botime të artikujve në revista shkencore jashtë vendit, ku aplikimi i tyre për këto fonde shihet rast pas rasti me komision ad-hoc.</p> <p><i>Nga GVJ sugjerohet që të caktohet me vendim një fond i caktuar për financimin e botimeve të pedagogëve për çdo vitin akademik, pra duhet theksuar që duhet më shumë angazhim praktik, real dhe promovim nga IAL për stafin akademik për botime të ndryshme në revista prestigjioze shkencore të huaja dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017          Aneksi D12. Plani Strategjik për punën e Burimeve Njerëzore          Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp; IT</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi III.5</b>  <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të</p>	<p>GVJ konstatoi se mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve përcaktohet në Librin e Rregulloreve Institucionale ... Vlerësimi i studentit. Vlerësimi i studentëve është stimulues, jo penalizues dhe kryhet në mënyrë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>të vazhdueshme e synon: Të nxisë studentin të mësojë gjatë gjithë vitit; Të skematizojë një vlerësim më objektiv të studentit, duke ndarë pikët në disa komponentë krahasuar me vlerësimin e bazuar vetëm në një testim; Të shërbejë për të vlerësuar ecurinë e lëndës gjatë semestrit, nëse studentët kanë kuptuar ose jo materialin që ofrohet në kurs.</p> <p>Elementët kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, punimet/projektet dhe niveli i aktivizimit në seminare apo punë laboratorike, provime të ndërmjetme, vlerësime në bazë të pyetje-përgjigjeve, etj. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e njohurive janë: Provimi i ndërmjetëm; Provimi përfundimtar; Riprovime; Përmirësimi; Mbrojtja e tezës për diplomim. Si rregull, provimi mund të përbëhet nga 3 kategori pyetjesh të cilat mund të ndryshojnë në varësi të lëndëve dhe moduleve: pyetje që kontrollojnë njohuritë (20-30% e provimit); pyetje për të testuar aftësitë analitike(40-50% e provimit); pyetje që kërkojnë mendim dhe pohim individual të studentit (në formën e analizave kritike, raste studimore ose ushtrime ... 20-30% e provimit). Kriteret dhe mënyra e testimit apo vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive janë publike dhe përmenden në Guidën e Studentit, si dhe përfshihen dhe në syllabuset e çdo lënde.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale Aneksi D14. Guida e Studentit Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT Aneksi 12. Rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët njihen me mënyrat e vlerësimit dhe testimit nëpërmjet prezantimit të lëndës dhe të syllabus-eve në javën e parë të semestrit nga pedagogët e tyre. Shpjegime të shumta mbi ndjekjen e programit, lëndët, detyrimet akademike dhe ato administrative, vlerësimin, praktikën si dhe diplomimin jepen që në fillim në Javën e Orientimit prej stafit akademik si dhe u dërgohet me email të gjithë studentëve të regjistruar. Syllabuset e përgatitura nga pedagogët dhe të miratuara nga Përgjegjësi i Departamentit të Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit, përmbajnë informacion mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive &amp; aftësive profesionale konform VKM përkatëse. Mënyrat e vlerësimit përfshijnë detyrat në grup, pjesëmarrjen aktive të studentëve, projektet e kursit, provimet e ndërmjetme, provimet përfundimtare, etj. Gjithashtu, studentëve iu vihen në dispozicion udhëzuesi i didaktikës, si dhe udhëzuesi i praktikës. Programi i studimit me lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave është i publikuar në faqen e internetit të IKT, si dhe janë lehtësisht të aksesueshme në bibliotekë. Ndërsa përmes Guidës së Studentit jepet informacioni më i domosdoshëm për ecurinë e studentëve në institucion dhe në programin që ata ndjekin.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT Linku: <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020</a> Linku: <a href="https://cit.edu.al/bachelor-in-business-administration-and-information-technology-2/">https://cit.edu.al/bachelor-in-business-administration-and-information-technology-2/</a> Linku: <a href="https://cit.edu.al/cit-broschures/">https://cit.edu.al/cit-broschures/</a> Linku: <a href="https://cit.edu.al/orientation-and-integration-week-at-cit/">https://cit.edu.al/orientation-and-integration-week-at-cit/</a> Aneksi20. Programet e lëndëve të Bach. Administrim Biznesi &amp; IT 2021 - 2022</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi i njohurive dhe aftësive të fituara është vlerësim i vazhduar dhe i shtrirë në kohë, duke u realizuar nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të studentëve, detyrave individuale &amp; në grup, projekteve të kursit, provimeve të ndërmjetme, provimeve përfundimtare (praktikisht janë me shkrim të gjitha), ushtrimeve, etj. Të gjitha këto aktivitete janë të parashikuara në syllabus-et e lëndëve dhe iu komunikohen studentëve që në fillim të semestrit. Format e testimit të njohurive janë të përcaktuara në Librin e Rregulloreve Institucionale, Vlerësimi studentit. Institucioni ka nxjerrë udhëzime të qarta lidhur me peshën që duhet të zënë komponentet e vlerësimit, e cila shpjegohet në Librin e Rregulloreve Institucionale ... Vlerësimi studentit, ku format e testimit kanë këto pësha: Pjesëmarrja 10%; Detyrat, punë laboratorit 40%; Testime (të ndërmjetme, projekte, etj) 20%; Provimi përfundimtar 30%; Totali 100%. Sipas drejtuesve të IAL IKT, në respektim të lirisë akademike, mes këtyre kategorive ka një marzh lëvizjeje prej 10-20%.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT  Aneksi7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi20. Programet e lëndëve të Bach. Administrim Biznesi &amp; IT 2021 - 2022</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.6</b>  <b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Bazuar tek informacionet e marra gjatë takimit me pedagogët dhe studentët, si dhe tek syllabuset e lëndëve, GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale është i vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit apo vitit akademik, dhe ky vlerësim përbëhet nga: Pjesëmarrja 10%; Detyrat, punë laboratorit 40%; Testime (të ndërmjetme, projekte, etj) 20%; Provimi përfundimtar 30%; Totali 100% (sipas drejtuesve të IAL IKT, në respektim të lirisë akademike, mes këtyre kategorive ka një marzh lëvizjeje prej 10-20%); ku 5 është nota minimale kaluese dhe 10 është nota maksimale. Ky vlerësim i vazhduar i bën studentët më të përfshirë në gjithë procesin mësimor, kjo në të mirë të procesit si për IAL IKT, ashtu dhe për studentët e saj. Vlerësimi i studentëve i kryer në mënyrë të vazhdueshme synon: Të nxisë studentin të mësojë gjatë gjithë vitit; Të skematizojë një vlerësim më objektiv të studentit, duke ndarë pikët në disa komponentë krahasuar me vlerësimin e bazuar vetëm në një testim; Të shërbejë për të vlerësuar ecurinë e lëndës gjatë semestrit, nëse studentët kanë kuptuar ose jo materialin që ofrohet në kurs.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT</p>





<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p> <p>IAL IKT ka përdorur platformat Google Classroom, Google Meet dhe sistemin UMS për të zhvilluar leksionet dhe seminarët nga ana e personelit akademik &amp; për të realizuar komunikimin pedagog-student (por dhe për vlerësimin e njohurive online/electronike të studentëve, sidomos në periudhën e pandemisë Covid '19; në fakt e kombinuar ku preferohej përdorimi i auditoreve fizike sipas drejtuesve të IAL IKT). Përdorimi i këtyre platformave ka kontribuar në rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzimeve në procesin mësimor, të testimit dhe vlerësimit të studentëve, dhe uljen e ankesave potenciale nga ana e studentëve lidhur me vlerësimin e provimeve të tyre. Por, në përgjithësi IAL IKT nuk synon të përdorë sistem elektronik të testimit dhe vlerësimit, nga ku institucioni e sheh të arsyeshme të vijojë sipas metodologjisë së përcaktuar në rregulloret aktuale. Në të ardhmen me rritjen e numrit të studentëve, institucioni do gjykojë nëse do të përdorë sisteme vlerësimi elektronike ose jo.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale Aneksi: RVB i IKT</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së Departamentit të Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit të IKT, GVJ konstaton se testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve, komisione të cilat përbëhen nga dy anëtarë (njëri prej tyre është titullari i lëndës, dhe anëtari i dytë është asistenti/ja). Teza e provimit hartohet nga titullari i lëndës bashkëpunim me pedagogun që zhvillon seminarët (kur është një rast i tillë), tezë e cila firmoset nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i Departamentit të Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit. Praktika profesionale dhe diplomimi realizohen nga komisione të ngritura në mënyrë të posaçme, sipas përcaktimeve të rregulloreve përkatëse, siç përcaktohet në pikën 7: Praktika dhe pikën 8: Diplomimi në Rregulloren e Programit të Studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Bazuar tek informacionet e marra gjatë vizitës në IAL IKT si dhe tek dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstaton se testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim. Tezat e provimeve sekretohen nga sekretaria mësimore dhe kontrollohen nga pedagogët e lëndës në mënyrë anonime. Provimet nuk zhvillohen asnjëherë pa sekretim, dhe studentët monitorohen në sallë nga pedagogët monitorues, të cilët përpiqen të shmangin tentativat për kopjim nga ana e studentëve në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më i drejtë dhe i paanshëm për të gjithë studentët. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon</p>

	<p>provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të tyre. Brenda këtyre dy javëve, në orarin e caktuar për tutoriat dhe/ose këshillim akademik, pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Pas këtij afati, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 12. Rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022  Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Për të realizuar parimin e transparencës, IAL IKT udhëzon stafin akademik që gjatë vlerësimit të përdorin komente dhe të japin sqarime të herëpashershme në mënyrë që studenti të mësojë edhe përmes vetëkorrigjimit dhe kuptimit të vlerësimit. Bazuar në takimet e GVJ me studentët, u konstatua që studentët kanë mundësi të marrin komentet dhe vlerësimet e pedagogëve gjatë gjithë kohës, gjë që i ndihmon ata në procesin e të nxënit dhe përmirësimin deri në provimin përfundimtar. Edhe pasi zhvillohet provimi i ndërmjetëm, pedagogët japin këshilla mbi procesin e të nxënit apo mënyrën e të mësuarit apo për paqartësi potenciale të studentëve për t'i ndihmuar ata të përmirësohen në të ardhmen. Në provimin përfundimtar, në korigjimin e tezave të provimit, pedagogët komentojnë pyetjet e realizuara duke dhënë komentet përkatëse që mbështesin vlerësimin total. Në këtë mënyrë sigurohet një përfshirje e plotë e pedagogëve dhe studentëve në proces. Staf i akademik i përmbahet programit të lëndës në vlerësimin e studentit dhe mbi këtë fakt zhvillon takime sqaruese lidhur me njohuritë e dhëna dhe ato të testuara.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA&amp;IT  Takimi me studentët</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Institucioni ndjek politika të rrepta lidhur me kopjimin, plagjiaturën dhe çdo element tjetër që shtrembëron vlerësimin e studentit. Për këtë arsye institucioni ka punuar rregullore të veçanta që udhëzojnë dhe sqarojnë se çfarë do të thotë mashtrim, kopjim, plagjiaturë apo mos referim sipas kritereve shkencore. Gjatë periudhës së zhvillimit të provimeve, studentët monitorohen në sallë nga pedagogët monitorues, të cilët përqipen të shmangin tentativat për kopjim nga ana e studentëve në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më i drejtë dhe i paanshëm për të gjithë studentët. Në bazë të rregullores së programit përkatës, për studentët që kryejnë shkelje të tilla, merren masa disiplinore të tilla si Vërejtje me shkrim, Përrjashtim nga studimet për një vit, apo Përrjashtim nga IKT, por deri më tani, nga takimi i GVJ në IAL IKT u konstatua se nuk ka patur raste të tilla. Gjatë Ditëve të Orientimit stafi akademik i njëjtit kryesore, por dhe titullarë të institucionit japin informacione të plota rreth mënyrës së si studentit duhet t'i qaset</p>

	<p>informacionit, detyrave të kursit, projekteve, tezës së diplomës etj. Po ashtu të dhëna të detajuara jepen edhe për mënyrën e referimit në projekte, tema, ese, detyra kursi dhe tezën e diplomës.</p> <p>Në shërbim të ruajtjes, edukimit, informimit dhe njoftimit të studentëve rreth elementëve si mashtrimi, kopjimi, apo plagjiatura gjenden tek Libri i Rregulloreve Institucionale, përkatësisht: Kodi i Integritetit Akademik dhe Kodi i Etikës. Në të njëjtën kohë materiale, si rregullore dhe sqarime jepen edhe në Guidën e Studentit dhe Programin e Lëndës.</p> <p>Përkufizimi i rasteve të pandershmerisë akademike (rastet e shkeljes së Kodit të Integritetit): Rastet e pandershmerisë akademike, të cilat kanë ndikim negativ në aspekte të ndryshme të procesit arsimor, janë rreptësisht të ndaluara. Pandershmeria akademike (sipas rregullores/kodit) përfshin, por nuk kufizohet në përkufizimet e mëposhtme: Mashtrimin ... përdorimi i asistencës, materialeve ose asistencës së paautorizuar gjatë provimit; Plagjiaturën ... përdorimi i ideve, të dhënave ose gjuhës së një subjekti tjetër pa njohuri dhe referenca specifike; Manipulimin ... dorëzimi i informacionit ose paraqitjes së dyshimtë/të diskutueshme të çdo detyre; Dorëzimi i shumëfishtë ... dorëzimi me ose pa leje të ndonjë punimi në një detyrim tjetër akademik, i cili është planifikuar të përmbushë një dhe vetëm një detyrim akademik; Paraqitja e gabuar e të dhënave akademike ... duke ndryshuar/ndërrhyrë në përmbajtjen, formën e të dhënave akademike të stafit apo studentëve.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 13. Manual i Punimit të Tezës së Diplomës  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi D14. Guida e Studentit  Aneksi 20. Programet e lëndëve të Bach. Administrim Biznesi &amp; IT 2021 - 2022  Aneksi 10. Rregullore e programit BA&amp;IT  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA &amp; IT</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga pedagogët e programit të studimit mbahet në konsideratë që teza e provimit të ndërtohet e tillë duke marrë në konsideratë nivele të ndryshme njohurish nga ato më të thjeshtat deri tek më të vështirat duke i dhënë mundësi studentëve të të gjitha niveleve të arrijnë rezultatin në përputhje me angazhimin e tyre, dhe bazuar në meritokracinë.</p> <p>Nga takimi i GVJ me studentët, u konstatua që ata i merrnin në kohë rezultatet e provimeve bazuar në rregulloren përkatëse dhe e kishin mundësinë e kontestimit të rezultatit apo rishikimit të korrigjimit pas shpalljes së rezultateve të provimeve. Gjithashtu rezultatet hidhen edhe në sistemin UMS, ku studenti mund të ndjekë dhe të ketë të gjitha vlerësimet sipas komponentëve përkatës.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA &amp; IT  Takimi me studentët</p>

**Kriteri 8.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.

IAL IKT garanton të drejtat e studentëve për tu njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloren e Departamentit të Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe atë të Programit të Studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, ku përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrimet e studentëve.

Nga takimi i GVJ me studentët, u konstatua që ata njiheshin me elementët e vlerësimit të lëndës që në orën e parë të mësimit, si dhe njiheshin me rezultatet e provimeve, dhe e kishin mundësinë e kontestimit të rezultatit apo rishikimit të korigjimit brenda pas shpalljes së rezultateve të provimeve. Konkretisht, në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (testim, provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një Komision për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar. E drejta e studentit për të apeluar për vlerësimin sqarohet edhe në Guidën e Studentit (pika 1.2).

*Evidenca:*

Aneksi 12. Rregullore e Sekretarisë sikli i parë 2021-2022

Aneksi D14. Guida e Studentit

Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale

Aneksi 10. Rregullore e programit BA & IT

Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë

Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA & IT

Takimi me studentët

**Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.

Nga takimi i GVJ me studentët, u konstatua që ata e kishin mundësinë e kontestimit të rezultatit apo rishikimit të korigjimit pas shpalljes së rezultateve të provimeve. Ankesat në lidhje me notën merren parasysh vetëm nëse ato paraqiten me shkrim brenda 14 ditëve nga shpallja e vlerësimit. Të gjitha ankesat në lidhje me notën dorëzohen tek Kryesekretaria (Regjistrari), pas kryerjes së pagesës përkatëse. Konkretisht, në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (testim, provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një Komision për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar. E drejta e studentit për të apeluar për vlerësimin sqarohet edhe në Guidën e Studentit (pika 1.2).

Për sa i përket ankesave që nuk kanë të bëjnë me aspektin akademik, studenti duhet që t'i paraqesë ato brenda 10 ditëve nga momenti i shfaqjes së problemit. Brenda pesë ditëve ankimimi i studentit trajtohet nga një komision i cili mund të kërkojë të dhëna të tjera në lidhje me ngjarjen apo problematikën e shfaqur. Brenda dhjetë ditëve nga fillimi i hetimit mbi ngjarjen ose problematikën e shfaqur, komisioni duhet të japë mendimin e tij.

	<p>Nëse studenti nuk është i kënaqur me zgjidhjen e ofruar nga komisioni, studenti brenda 15 ditëve nga dhënia e vendimit mund t'i drejtohet zv. Rektorit me synim Kërkesën për t'u dëgjuar nga ky i fundit në një takim të posaçëm. Zv. Rektori si rregull duhet t'i ktheje përgjigje studentit brenda pesë ditëve në lidhje me apelin për t'u dëgjuar. Pas kësaj zv. Rektori mund të ngrrejë një komision përmes të cilit mund t'i japë studentit mundësinë për t'u dëgjuar. Vendimi për pranimin e apelit dhe caktimin e datës së dëgjimit shpallet nga zv. Rektori dhe njoftohet studentit brenda që brenda 20 ditëve të paraqitet për seancën dëgjimore. Brenda këtij afati studenti duhet të paraqitet dhe të parashtrijë apelin e tij ndaj çështjes përpara komisionit (vendimi i Komisionit është përfundimtar). Çdo procedurë e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 12. Rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022  Aneksi D14. Guida e Studentit  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA &amp; IT  Takimi me studentët</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.7

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Lidhur me programin e studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, mbështetur tek programet e lëndëve (syllabuset) si dhe në diskutimet me pedagogët dhe studentët, GVJ konstaton se gjatë zhvillimit të mësimit në këtë program përdoren metoda të cilat janë në funksion të thellimit të njohurive për studentët, ku në leksione merren njohuritë bazë dhe ato më të thelluara, të cilat aplikohen përgjatë seminareve ku studentët zhvillojnë aftësitë profesionale, dhe nëpërmjet detyrave të kursit thellohen aftësitë analitike për zgjidhjen e problemeve. Programi i studimit është në përputhje me KSHK (Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve), nivelin nr.VI përsa i përket njohurive që ofron nëpërmjet leksioneve, seminareve dhe praktikave profesionale.</p> <p>Programi Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni është zhvilluar për të kontribuar në ndërtimin e kapaciteteve shumë të nevojshme dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional në fushën e administrim biznesit dhe teknologjisë së informacionit. Struktura dhe përmbajtja e programit Bachelor në BA &amp; IT, si program studimi i Ciklit të Parë, është ndërtuar me qëllim që të mundësojë formimin, përditësimin, aplikimin e njohurive praktike, analitike profesionale apo kërkimore, si edhe të zhvillojë aftësitë e nevojshme tek të sapodiplomuarit që ata të integrohen më së miri në tregun e punës. Programi Bachelor në BA &amp; IT përputhet më së miri me strategjinë e zhvillimit të KU IKT dhe synon ta</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>pajisë studentin me: Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit; Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale; Formim qytetar të përgjithshëm; Aftësi bazë për punë kërkimore; Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative; dhe Aftësim për promovim personal.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp;IT  Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA&amp;IT, 2021-2022, 2020-2021, 2019-2020  Aneksi D8. Studim Periodik i Tregut të Punës në BA &amp; IT (akreditimin periodik të prog.)  Aneksi 20. Programet e lëndëve të Bach. Administrim Biznesi &amp; IT 2021 - 2022  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA &amp; IT</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Bazuar tek planet mësimore, programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni ka si qëllim të përgatisë profesionistë me njohuri dhe aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit. Programi i studimit përfshin një larmi të gjerë lëndësh/modulesh, sipas kategorive nga A në E, në përputhje me udhëzimet e ministrisë së linjës. Për programin Bachelor në BA &amp; IT, në përputhje me kategorinë A, C dhe D, studentët njihen dhe mësojnë disa lëndë të tilla si: Computer Applications, Academic Reading and Writing, Research methods, Calculus, por kanë edhe mundësi të lëndëve me zgjedhje si: Macroeconomics, Microeconomics, etj. Idea është që studentët të pajisen me njohuri kryesisht në fushën e ekonomisë, por dhe të teknologjisë. Të diplomuarit në këtë program studimi formohen për profesione/mundësi punësimi në çdo sektor të ekonomisë dhe industrisë, në biznesin privat dhe në administratën publike.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA&amp;IT, 2021-2022, 2020-2021, 2019-2020  Aneksi D8. Studim Periodik i Tregut të Punës në BA &amp; IT (akreditimin periodik të prog.)  Aneksi 20. Programet e lëndëve të Bach. Administrim Biznesi &amp; IT 2021 - 2022  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA &amp; IT</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Bazuar tek informacioni i marrë në takimin me Përgjegjësën e Departamentit të programit dhe pedagogët që japin mësim në këtë program studimi, GVJ u informua që syllabuset e lëndëve diskutohen në mbledhjet e departamentit çdo vit me qëllim përmirësimin e tyre në aspektin e përmbajtjes dhe të metodologjisë, dhe për të sjellë zhvillimet e fundit në fushën përkatëse. Gjithashtu, stafi akademik harton Relacionin e Lëndës në përfundim të çdo lënde/moduli ku vlerëson, analizon dhe shqyrton aftësitë</p>

	<p>e fituara nga studentët, si dhe analizohet në mënyrë të përgjithshme realizimi i lëndës, problematikat e hasura, përmirësimet potenciale, etj.</p> <p>Syllabuset përfshijnë brenda tyre dy elementë shumë të rëndësishëm që janë Rezultatet e të nxënit nga studentët dhe Atributet e të diplomuarit. Ndonjëherë kjo e fundit nuk është pjesë e syllabusit, pasi ajo përshkruhet hollësisht në rregulloren Strategjike e Mësimdhënies në IKT (tek Libri i Rregulloreve Institucionale), ku jepen atributet që duhet të kenë studentët që do të diplomohen. Si “rezultatet e të nxënit” ashtu dhe “atributet e të diplomuarit” ndihmojnë pedagogun dhe mësimdhënësit që të jenë konform programit të studimit, si dhe të kërkojnë prej studentëve rezultate konkrete që do t’i ndihmojnë ata më pas kur të dalin në tregun e punës. Pra, syllabuset e lëndëve duhet të jenë konform attributeve, që kërkohen të kenë studentët në përfundim të programit të studimit dhe kjo reflektohet si indikator i aftësive profesionale që fiton studenti gjatë tre viteve akademike dhe që do t’i mbartë pas diplomimit. KU IKT në miratimin e “Planit Strategjik për të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës” ka dhënë një model sesi mund të ingranohen “rezultatet e të nxënit” me “atributet e të diplomuarit”, në mënyrë që ato të përkojnë dhe të jenë konform aftësive dhe dijeve që duhet të ketë studenti për të qenë pjesë e tregut të punës.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 4. Miratimi i planit strategjik për LLL  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA&amp;IT, 2021-2022, 2020-2021, 2019-2020  Aneksi D8. Studim Periodik i Tregut të Punës në BA &amp; IT (akreditimin periodik të prog.)  Aneksi 20. Programet e lëndëve të Bach. Administrim Biznesi &amp; IT 2021 - 2022  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA &amp; IT</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në bazë të aktiviteteve të përcaktuara në programin e lëndës, kompetencat dhe aftësitë që ka fituar studenti testohen nëpërmjet detyrave të kursit, ose testimave me shkrim. Në përfundim të çdo lënde, pedagogu bën përmbledhjen e të gjithë çështjeve kryesore dhe orienton studentët për tu përgatitur për provimin përfundimtar (si një nga elementët e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të fituara nga ana e studentit gjatë zhvillimit të lëndës/modulit, duke vënë theksin në analizën dhe të kuptuarit e kompetencave të fituara nga lënda/moduli), si dhe gjatë sezonit të provimeve studentët kanë mundësi të konsultohen me pedagogët e tyre për paqartësi potenciale lidhur me tema të ndryshme. Gjithashtu, në përfundim të çdo lënde/moduli, stafi akademik harton relacionin e lëndës ku vlerëson, analizon dhe shqyrton aftësitë e fituara nga studentët.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 20. Programet e lëndëve të Bach. Administrim Biznesi &amp; IT 2021 - 2022  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p>

	<p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT</p> <p>Aneksi D8. Studim Periodik i Tregut të Punës në BA &amp; IT (akreditimin periodik të prog.)</p> <p>Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</p> <p>Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA &amp; IT</p> <p>Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA&amp;IT, 2021-2022, 2020-2021, 2019-2020</p> <p>Takimi me studentët dhe pedagogët</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në takimin me stafin akademik dhe studentët, GVJ u informua që IAL IKT organizon leksione/seminare të hapura me specialistë të mirënjohur të fushës së teknologjisë së informacionit apo ekonomisë, për të sjellë të reja e shkencës apo teknologjisë në shërbim të pasurimit të njohurive që marrin studentët në këtë program studimi, dhe për secilin nga këto seminare/leksione të hapura hartohen dhe relacionet përkatëse. Në bashkëpunim me industrinë, bizneset dhe sipërmarrjet, shumë orë mësimore janë kthyer në leksione të hapura, në të cilat kanë marrë pjesë specialistë, emra të njohur të fushës, si dhe të ftuar të ndryshëm, që kanë ndarë eksperiencën e tyre me studentët.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 26. Marrëveshjet me biznesin, sipërmarrjet dhe institucione të tjera 2016 – 2022</p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/news/guest-speaker/">https://cit.edu.al/news/guest-speaker/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/event/mr-andrea-boccuni-international-guest-speaker/">https://cit.edu.al/event/mr-andrea-boccuni-international-guest-speaker/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/event/open-lecture-prof-christopher-hancock/">https://cit.edu.al/event/open-lecture-prof-christopher-hancock/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/event/guest-speaker-mr-giuseppe-bottini/">https://cit.edu.al/event/guest-speaker-mr-giuseppe-bottini/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/event/open-lecture-partnerships-between-startups-and-corporations/">https://cit.edu.al/event/open-lecture-partnerships-between-startups-and-corporations/</a></p> <p>Linku: <a href="https://cit.edu.al/event/guest-speaker/">https://cit.edu.al/event/guest-speaker/</a></p> <p>Takimi me studentët dhe pedagogët</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Në bazë të llojit të programit të studimit të ofruar nga IAL IKT, si dhe tek syllabuset e lëndëve, planin mësimor, apo edhe eksperiencën e stafit akademik të këtij programi studimi, mund të themi që mësimdhënia realizohet mbi bazën e aplikimit në laborator për ato lëndë/module specifike, të njohurive të marra në leksione dhe seminare. Mënyra e zhvillimit të mësimi i përshtatet natyrës së lëndës/modulit dhe ofron zhvillim kompetencash nëpërmjet detyrave të kursit të studentëve. Gjithashtu, praktikat e studentëve zhvillohen pranë kompanive të ndryshme private në vend në bazë të marrëveshjeve të hartuara nga IAL IKT me këto kompani.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 26. Marrëveshjet me biznesin, sipërmarrjet dhe institucione të tjera 2016 – 2022</p> <p>Aneksi 47. Informim mbi mundësitë e punësimit dhe zhvillimit të praktikave mësimore në kompani të ndryshme</p>



<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Në takimin që zhvilloi GVJ me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, u informua që personeli akademik inkurajon studentët të përfshihen në aktivitete dhe detyra grupi apo projekte kursi që lidhen me punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara duke simuluar raste/problematika reale të hasura nga kompanitë në aktivitetin e tyre.</p> <p>Ndër metodat që përdorin pedagogët, disa prej tyre u referohen punës në grup ose angazhimit të studentëve në veprimtari që kërkojnë ndërveprim me pedagogun ose me studentët e tjerë, si psh: Teknika inteligjente të pyetjeve; Veprimtari praktike; Sesione interaktive në seminare të kombinuara me supervizim; Përdorimi i metodave të ndryshme ndërvepruese në klasë; Udhëtime dhe vizita në terren; Ekspertë të fuar; Punë në grup e bazuar në raste studimore; Detyra të bazuara në kërkim dhe hulumtim. Gjatë punës në grup studentët mësojnë jo vetëm nga pedagogu por edhe prej studentëve të tjerë. Kështu mund të thuhet se realizohet trekëndëshi: student-pedagog-klasë.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Takimi me studentët dhe stafin akademik të IALIKT</p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Në takimin që zhvilloi GVJ me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, u informua që personeli akademik mundohet të ofrojë një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, duke i mbështetur ata në pjesëmarrjen në studime të avancuara kërkimore konferenca, konkurse apo aktivitete të tjera.</p> <p>Sipas pedagogëve të këtij programi studimi, synohet që të përmirësohet mësimdhënia dhe të vihet studenti në qendër, pra mbështetje të tyre në çdo nisëm apo ide që duan të ndër marrin. Studentët kanë mundësinë të përdorin bibliotekën fizike dhe atë online në projekt idetë e tyre. KU IKT tregohet e gatshme t'u ofrojë asistencë teknike dhe logjistike studentëve dhe kërkuesve, të cilët inkurajohen vazhdimisht të eksplorojnë tema të ndryshme kërkimore aktuale, nëpërmjet ofrimit të logjistikës laboratorike, apo mbështetjes për pjesëmarrjen e studiuesve të rinj në aktivitete kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. Në mbështetje të studentëve ka qenë suporti financiar për organizimin e konferencave studentore, akademike verore, start up-eve si dhe iniciativave të prezantuara prej tyre.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Takimi me studentët dhe stafin akademik të IAL IKT</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Në takimin që zhvilloi GVJ me drejtuesit dhe studentët, u konstatua që mbështesin zhvillimin e ideve inovative nga ana e studentëve, si dhe me vendim akordohet dhe një fond i posaçëm për aktivitete të ndryshme studentore. Gjithashtu, studentët nxiten të marrin pjesë në projekte shkëmbimi Erasmus+, etj. Studentët kanë mundësinë të përdorin</p>



	<p>bibliotekën fizike dhe atë online në projekt idetë e tyre.</p> <p>Institucioni ka mbështetur idetë inovative të ardhura prej studentëve ose ka krijuar kushtet financiare në mënyrë që këto ide të zhvillohen dhe studentët të angazhohen në realizimin e tyre. Institucioni ka mbështetur financiarisht studentët të cilët kanë marrë pjesë në punimin e platformave të teknologjisë së informacionit, ashtu siç ka mbështetur me bursë dhe çmime studentët që kanë marrë pjesë në startup-e dhe kanë rezultuar fitues në fund. IKT ka mbështetur studentët për zhvillimin e disa ideve inovative e teknologjike në dobi të institucionit, shoqërisë ose palëve të treta.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Linku: <a href="http://cit.visualminds.be/sq/news/e-learning-platform/">http://cit.visualminds.be/sq/news/e-learning-platform/</a>  Linku: <a href="https://cit.edu.al/the-award-ceremony-of-hacktech-2021/">https://cit.edu.al/the-award-ceremony-of-hacktech-2021/</a>  Linku: <a href="https://cit.edu.al/event/open-lecture-partnerships-between-startups-and-corporations/">https://cit.edu.al/event/open-lecture-partnerships-between-startups-and-corporations/</a></p> <p>Takimi me studentët dhe stafin akademik të IAL IKT</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>KU IKT ka përshtatur metodologjinë, teknikat dhe proceset pedagogjike të përdorura prej institucioneve të njohura ndërkombëtare në mësimdhënie si dhe ka ofruar mundësinë përmes realizimit të marrëveshjeve të përbashkëta për njohjen e programeve studimore të ofruara nga institucioni. IAL IKT në bashkëpunim me Personelin akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucione të ndryshme që ka marrëveshje bashkëpunimi për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. IKT ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh në kuadër të Erasmus+ dhe është anëtarësuar në CEEPUS, duke bërë të mundur që këto institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë të njohin mobilitetin studentor me institucionin dhe programet e ofruara prej tij. Kështu, disa studentë të caktuar kanë marrë përfitur dhe pjesë në workshope apo shkëmbime Erasmus+ në universitete të ndryshme të huaja. Sipas drejtuesve të IAL IKT, janë bërë përpjekje të herë pas hershme që temat e diplomave, në bashkëpunim me pedagogët udhëheqës të kthehen në projekte konkrete prej të cilave të përfitojnë jo vetëm ata, por e gjithë shoqëria.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 26. Marrëveshjet me biznesin, sipërmarrjet dhe institucione të tjera 2016 – 2022  Aneksi 25. Marrëveshjet me universitetet 2016 - 2022  Aneksi 24. Marrëveshjet në kuadër të Erasmus+ 2016-2022  Aneksi 47. Informim mbi mundësitë e punësimit dhe zhvillimit të praktikave mësimore në kompani të ndryshme</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi III.8**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin

IAL IKT harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.

diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. Modalitetet dhe procedurat për zhvillimin e provimeve finale përcaktohen në rregulloret përkatëse, konkretisht në atë të Departamentit të Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit. Kurse diploma mbrohet me provim të përgjithshëm përfundimtar ose me temë diplome, ku modalitetet dhe procedurat për të përcaktohen në rregulloret përkatëse, konkretisht në atë të Departamentit të Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit. Institucioni ka hartuar rregullore dhe procedura të posaçme që lidhen me mbrojtjen e diplomës. Në fillim të secilit vit akademik miratohet Plani Kalendarik Vjetor në të cilin caktohen dhe sezonet e diplomimit sipas periudhave përkatëse. Plani kalendarik miratohet me Vendim Senati dhe shpallet në faqen zyrtare të internetit të institucionit çdo vit për të dy ciklet e studimit. Për mbrojtjen e diplomës institucioni ka hartuar rregullore, manualë dhe procedura të posaçme si më poshtë: Mbi punimin e diplomës – Libri i Rregulloreve Institucionale, Manuali i Punimit të Diplomës, Procedurat – Rregullorja e Programit të Studimit, dhe Rregullorja e Sekretarisë Mësimore, Cikli i Parë.

Kalendari akademik parashikon dy sezone për mbrojtjen e diplomës, të cilat janë: Java e 3<sup>te</sup> e Janarit dhe java e 3<sup>te</sup> e Korrikut. Studenti që merr notë jokaluese në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës ka të drejtë të paraqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm. Studenti ka të drejtë të hyjë dy herë në mbrojtjen e diplomës. Në rast se edhe pas herës së dytë rezulton mbetës, studentit duhet të ndryshojë temën dhe të paraqesë një punim të ri diplome. Të diplomuarit në këto programe studimi duhet të kenë punuar/konspektuar/trajtuar listën e botimeve të paraqitur individualisht në syllabuset e kurseve të ofruara. Po ashtu prej sekretarisë mësimore atyre u shpërndahet Rregullorja dhe Manuali i Diplomës, i cili i ndihmon në kriteret dhe teknikat për hartimin e tezës së diplomimit. Studentët marrin informacion të rëndësishëm për procedurat dhe mbrojtjen e diplomës edhe në Guidën e Studentit (pika 2.10).

*Evidenca:*

Aneksi 10. Rregullore e programit BA & IT

Linku: <https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/11/Akademic-Calendar-Bachelor-2021-2022>

Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale

Aneksi Manuali i Punimit të Tezës së Diplomës shqip

Aneksi 12. Rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022

Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë

Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA & IT

Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA&IT, 2021-2022, 2020-2021, 2019-2020

Aneksi D14. Guida e Studentit

Takimi me studentët dhe pedagogët

RVB e IAL IKT

**Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së

Strukturat përgjegjëse, konkretisht Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe stafi akademik asiston studentët për përgatitjen për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>diplomës.</p>	<p>funkcion të këtij provimi ose diplomës, dhe datat shpallen sipas një grafiku të miratuar nga dekani.</p> <p>Diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome për një temë të caktuar studimi dhe/ose kërkimi. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat e takimit me studentët. Kriteret për paraqitjen e punimit të diplomës përcaktohen me rregullore të veçantë. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike. Në çdo rast, studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa shlyer të gjitha detyrimet e tjera të programit të studimit.</p> <p>Për programin Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, plani i diplomimit është në semestrin e gjashtë, pas përfundimit të praktikës. Në fillim të semestrit të parë të vitit të tretë të Bachelorit, studentëve u jepet informacioni i domosdoshëm që ata duhet të dijnë mbi temën e diplomës si dhe paraprakisht orientohen drejt fushave dhe temave që ata mund të zgjedhin. Atyre u shpërndahet prej sekretarisë dhe njësisë bazë Rregullorja dhe Manuali i Diplomës, i cili i ndihmon në kriteret dhe teknikat për hartimin e tezës së diplomimit. Që kur një student regjistrohet në njërin nga programet e studimit, ai merr me email Guidën e Studentit si material udhëzues për jetën e tij si brenda IKT (në guidën e studentit jepen të dhëna të detajuara mjaftueshëm për tu ditur prej studentit lidhur me diplomën dhe diplomimin).</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi. Manuali i Punimit të Tezës së Diplomës shqip  Aneksi 12. Rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA &amp; IT  Aneksi 16. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në BA&amp;IT, 2021-2022, 2020-2021, 2019-2020  Aneksi D14. Guida e Studentit  Takimi me studentët dhe pedagogët</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Komisioni i posaçëm për mbrojtjen e diplomës bazohet në të dhëna të mbledhura e raportuara prej sekretarisë së fakultetit për dy vitet e fundit për rezultatet e studentëve që do të diplomohen. Komisioni merr parasysh ecurinë e studentit dhe rezultatet e dy viteve të fundit si kriter orientues në vlerësimin përfundimtar të diplomës. Për vlerësimin e tezës, merren parasysh kriteret e mëposhtme: Qasja kritike ndaj temës që diskutohet duke marrë parasysh njohuritë dhe përvojën e studentit; Përdorimi i metodologjisë shkencore dhe instrumenteve të kërkimit; Originaliteti i tezës; Dobia e tezës; Cilësia e të shkruarit (duke respektuar stilin shkencor të të shkruarit, rregullat e drejtshkrimit); Paraqitja e qartë dhe koherente e tezës (përmbushja e formatimit dhe kërkesave teknike); Vlerësimi i tezës bazohet në një sistem pikëzimi, i cili në mënyrë të pashmangshme kthehet në notë.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi. Manuali i Punimit të Tezës së Diplomës shqip</p>

	<p>Aneksi 12. Rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA &amp; IT  Aneksi D14. Guida e Studentit  Takimi me studentët dhe pedagogët</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit harton drejtimet kryesore mbi të cilat formohet edhe grupi i temave që u propozohen studentëve në fillim të vitit të fundit akademik. Përgjegjësi i departamentit bashkë me koordinatorin e programit të studimit, organizojnë takime të ndryshme me studentët ku u shpjegojnë procedurat, udhëzimet si dhe temat që ata mund të zgjedhin për t'u diplomuar. Në të gjitha rastet studenti është i lirë të zgjedhë temën që ai dëshiron për tu diplomuar.</p> <p>Rregullorja mbi Punimin e Diplomës (tek Libri i Rregulloreve Institucionale) saktëson se: Në fillim të vitit akademik, në tetor, çdo departament organizon një takim për të konsultuar tema të ndryshme të cilat mund të shërbejnë si fushë studimi për tezën në nivel diplome si dhe për të identifikuar drejtuesit e mundshëm të tezave; Çdo anëtar i personelit akademik, brenda javës së tretë të semestrit të parë, ofron propozime konkrete për temat e tezës, të cilat ai/ajo është i gatshëm t'i mbikqyrë, duke bërë kështu të mundur krijimin e një grupi me tema; Brenda javës së pestë të semestrit të parë të vitit akademik, studentët pajisen nga departamenti përkatës me formularin e aplikimit për tezën, së bashku me listën e drejtuesve të mundshëm të tezës dhe grupin e këtyre temave; Studenti i interesuar plotëson formularin e aplikimit duke u konsultuar paraprakisht me një drejtues të mundshëm dhe e dorëzon atë brenda javës së tetë të semestrit të parë. Në rast të mospërbushjes së afatit, studenti mbron tezën e tij në sezonin e ardhshëm. Miratimi i temave bëhet si rregull jo më vonë se java e katërbëdhjetë e semestrit të parë.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi. Manuali i Punimit të Tezës së Diplomës shqip  Aneksi 69. Modeli i përcaktimit të temës së diplomës  Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi 12. Rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA &amp; IT  Aneksi D14. Guida e Studentit</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Për studentët e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, nga takimi i GVJ me drejtuesit e IAL u konstatua që IAL IKT asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin sa më mirë të procesit mësimor. Instalimi, mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i departamentit të IT (instalimet e programeve të reja bëhen në kohë reale në bazë të kërkesave të pedagogëve). Të gjitha programet kompjuterike të instaluarat i përshtaten programeve mësimore nëpërmjet instalimit të aplikacioneve, që kërkohen nga departamentet përkatëse. Të gjithë laboratorët janë të hapur dhe studentët mund të kryejnë (përveç orarit kur në laboratorë ka mësim) testime, detyra laboratorike dhe projekte të ndryshme,</p>

	<p>si dhe mund të kërkojnë asistencën e stafit akademik sipas profilit të detyrës.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi. Manuali i Punimit të Tezës së Diplomës shqip  Aneksi 69. Modeli i përcaktimit të temës së diplomës  Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi 12. Rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA &amp; IT  Aneksi D14. Guida e Studentit</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome për një temë të caktuar studimi dhe/ose kërkimi. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat e takimit me studentët. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike. Për të garantuar cilësi në këtë proces, mbikqyrësi i tezës do të miratohet në përputhje me kriteret e mëposhtme: Të jetë punonjës me kohë të plotë [në rast të moscaqimit të një drejtuesi me kohë të plotë si mbikqyrës teze/disertacioni, ose për shkak të temave specifike të tezës, ekspertët kryesorë potencialë me ekspertizë të spikatur në fushën e tyre, që mbajnë titullin më të lartë (për ciklin e dytë të studimeve) do të caktohen si mbikqyrës]; Të ketë kryer punë kërkimore në profil; Të ketë doktoraturë/PhD në rast të programeve të ciklit të dytë, ose të paktën diplomë MSc për ciklin e parë të studimeve.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 12. Rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022  Aneksi. Manuali i Punimit të Tezës së Diplomës shqip  Aneksi 69. Modeli i përcaktimit të temës së diplomës  Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA &amp; IT  Aneksi D14. Guida e Studentit</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studentët vlerësohen sipas një sistemi pikëzimi dhe me notë nga 4-10. Vlerësimi bëhet nga komisioni i posaçëm për administrimin e tezës, i cili është i përbërë nga pedagogë efektivë dhe të jashtëm që mbulojnë programin e studimit. Për çdo kandidat, Kryetari i Komisionit plotëson formularin përkatës dhe llogarit pikët e dhëna nga çdo anëtar i Komisionit të Vlerësimit dhe e ndan atë sipas numrit të vlerësuesve përpara se t'i kthejë rezultatet në notë përfundimtare në përputhje me sistemin e vlerësimit në fuqi (në rastet kur mbikqyrësi është anëtar i Komisionit të Vlerësimit, vlerësimi i tij llogaritet vetëm një herë). Rezultati përfundimtar regjistrohet dhe bëhet publik në fund të çdo seance në prani të kandidatëve.</p>

	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi. Manuali i Punimit të Tezës së Diplomës shqip  Aneksi 69. Modeli i përcaktimit të temës së diplomës  Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA &amp; IT  Aneksi 12. Rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, nëse studenti ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën, atëherë ai pajiset me diplomë të shoqëruar me suplementin përkatës (sipas Rregullores së programit), të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi 17. Miratimi i formës së diplomës +suplementi BA&amp; IT  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi. Manuali i Punimit të Tezës së Diplomës shqip  Aneksi 69. Modeli i përcaktimit të temës së diplomës  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA &amp; IT  Aneksi 12. Rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve studentit i vihet gjithashtu në dispozicion edhe një kopje zyrtare e plotë e programit të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni të ofruar nga IAL IKT. Studenti ka të drejtë të tërheqë një kopje të programit në çdo kohë që ai e shih të arsyeshme.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT  Aneksi 17. Miratimi i formës së diplomës +suplementi BA&amp; IT  Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale  Aneksi. Manuali i Punimit të Tezës së Diplomës shqip  Aneksi 69. Modeli i përcaktimit të temës së diplomës  Aneksi 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë  Aneksi 9. Rregullore e departamentit BA &amp; IT  Aneksi 12. Rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Sekretaria mësimore mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar (për çdo student të regjistruar gjendet dosja personale me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas udhëzimeve të viteve akademike respektive). Nga informacioni i marrë në Sekretarinë Mësimore, GVJ u informua që institucioni ruan kopje të dokumentacionit të studentit sipas legjislacionit në fuqi (përgjithmonë, informacion dhe të dhëna që më pas kalohen nga Sekretaria mësimore për në Arkivë). Informacioni për çdo program studimi, është i ruajtur në hard copy dhe në mënyrë elektronike (Database elektronik është i ruajtur dhe siguruar sipas elementëve të sigurisë nëpërmjet sistemit të backup, po ashtu në sekretarinë mësimore</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>përdoren raftë antizjarr për ruajtjen e dokumentacionit personal të studentëve). Sekretaria mësimore përgatit çdo vit të dhëna statistikore lidhur me regjistrimet e studentëve, transferimet, ç' regjistrimet e tyre, mobilitetin, etj. Sipas Rregullores së institucionit dhe sekretarisë informacionet për studentin mund të vihen në dispozicion të të interesuarve duke proceduar rast pas rasti.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Aneksi 12. Rregullore e Sekretarisë cikli i parë 2021-2022 Aneksi 10. Rregullore e programit BA &amp; IT Aneksi 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtar në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni i KU IKT ka paraqitur të përditesuara çdo vit të dhënat për personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi. Këto të dhëna janë të dokumentuara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamentin e Administrim Biznesi dhe Teknologjisë Informacioni</li> </ul> <p>(Departamenti ka listën e personelit akademik të angazhuar dhe të dhënat e ngarkesës mësimore të tyre.)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në zyrën e burimeve njerëzore</li> </ul> <p>(Dosjet e stafi akademik ruhen në vite në zyrën e burimeve njerëzore. Nga vizita e bërë në zyrën e burimeve njerëzore u panë dosjet e personelit akademik të njësisë dhe gjithashtu dhe përditësimi i tyre.)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sekretarinë e Fakultetit</li> </ul> <p>(Jane rregjistrat e mungesave të përdorur nga pedagogët për secilën nga lëndët, gjithashtu dhe procesverbalet e lendeve që kanë dorëzuar.)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në sistemin ASCAL</li> </ul> <p>(Gjithashtu në sistemin Ascal janë paraqitur dokumentet e hedhura prej Koordinatorit të Institucionit në sistemin AMS.)</p>



	<p>Te dhenat e paraqitura perfshijne te gjithe anetaret e personelit akademik dhe ndihmes-akademik te IKT.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore per programin e studimit BA&amp;IT disponon: të dhëna të plota dhe të hollësishme në lidhje me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie; listën e plotë të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme të angazhuar në mësimdhënie për çdo semestër dhe vit akademik. Lista e stafit me kohë të pjesshme aprovohet në senat, sipas propozimeve të fakulteteve përkatëse çdo vit akademik.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni DT 09.12.2021.xls</li> <li>2. Stafit per programin Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni.xls</li> </ol> <p>Tabelat Permbledhese faqe 94-98 Tabela 1, 2, 2.1, 2.2, 4, (80. RVB ne Programin e studimit te Bachelor Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni (skanuar).pdf)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>KU IKT ka paraqitur të gjitha procedurat e rekrutimit të personelit akademik në dokumentacionin bazë të veprimtarive të IKT. Gjithashtu këto dokumentacione janë të ruajtura dhe në zyrën e burimeve njerëzore dhe në rregulloren e IKT. Parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme janë të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e IKT-së. Dokumentacioni mbi rekrutimin dhe procedurat gjendet në rregulloren “Politikat dhe procedurat për rekrutimin e stafit akademik” në Librin e Rregulloreve Institucionale. I gjithë Kreu VIII në Librin e Rregulloreve Institucionale i dedikohet Burimeve Njerëzore dhe përmban rregullore, procedura dhe udhëzime.</p> <p>Rregullorja “Politikat dhe procedurat për rekrutimin e stafit akademik” qe gjendet ne Librin e rregulloreve Institucionale faqe 140, përshkruan të gjithë procedurën që ndiqet për rekrutimin e personelit të ri.</p> <p>Në rregullore përmenden proceset dhe procedurat që kanë të bëjnë kryesisht me: - Kriteret kryesore - Rastet specifike - Kriteret për lektorët e huaj - Përcaktimi i nevojave për staf të ri - Seleksionimi i kandidaturave - Zhvillimi i intervistës - Komisioni i rekrutimit - Kategoritë e stafit akademik - Stafit akademik i ftuar - Performanca dhe vlerësimi i stafit akademik.</p> <p>Në praktikën e tij Fakulteti i Ekonomisë merr të gjitha masat që në procesin e rekrutimit të punësojë ekspertë që i përshtaten programeve të ofruara të studimit. Në përzgjedhjen e kandidatit në mënyrë specifike vlerësohen edukimi/kualifikimi, kërkimi shkencor dhe eksperiencia profesionale. Fushat e specializimeve të pedagogëve synohet të jenë në përputhje me programin e studimit ose të përafërta me të.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>6. Rregullore Institucionale e KU IKT.pdf(faqe 140-143)</li> </ol>



	<p>38. Burimet Njerezore - Check Lista e dosjes personelit.pdf  39. Burimet Njerezore - Hapja e nje pozicioni pune.pdf  40. Burimet Njerezore - Vleresimi i Kandidateve.pdf  41. Burimet Njerezore - Caktimi i nje anetari te ri.pdf  D12. Plani Strategjik per punen e Burimeve Njerezore.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>KU IKT ka të hartuar kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit të cilat janë paraqitur dhe në rregulloren institucionale të KU IKT dhe gjithashtu janë dhe publike në faqen e web-it të institucionit.</p> <p>Rregullorja “Politikat dhe procedurat për rekrutimin e stafit akademik” qe gjendet ne Librin e rregulloreve Institucionale faqe 140, përshkruan të gjithë procedurën që ndiqet për rekrutimin e personelit të ri.</p> <p>Në rregullore përmenden proceset dhe procedurat që kanë të bëjnë kryesisht me: Kriteret kryesore , Rastet specifike , Kriteret për lektorët e huaj, Përcaktimi i nevojave për staf të ri, Seleksionimi i kandidaturave, Zhvillimi i intervistës, Komisioni i rekrutimit, Kategoritë e stafit akademik, Stafi akademik i ftuar, Performanca dhe vlerësimi i stafit akademik.</p> <p>Kërkesa për staf akademik bëhet në faqen e web-it të IKT ku përcaktohen dhe kriteret e përzgjedhjes së stafit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>6. Rregullore Institucionale e KU IKT.pdf(faqe 140-143)  38. Burimet Njerezore - Check Lista e dosjes personelit.pdf  39. Burimet Njerezore - Hapja e nje pozicioni pune.pdf  40. Burimet Njerezore - Vleresimi i Kandidateve.pdf</p> <p>Në web janë ne faqet me poshtë:  <a href="https://cit.edu.al/category/career/">https://cit.edu.al/category/career/</a>  <a href="https://cit.edu.al/faculty-of-economy-vacancies/">https://cit.edu.al/faculty-of-economy-vacancies/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni i Arsimit të lartë KU IKT i paraqet të gjithë kriteret e vlerësimit të stafit akademik në lidhje me nivelin e kualifikimit dhe në përputhje me strukturën e moduleve dhe përmbajtjen e programeve të studimit. Kjo është parë dhe nga kualifikimet që ka stafi akademik i angazhuar në programin e studimit. Nga zyra e burimeve njerezore janë paraqitur dhe lista e personelit akademik, procedurat për hapjen e një pozicioni pune, vlerësimi i kandidatëve, caktimi i një anëtari të ri.</p> <p>Në një procedurë normale të publikuar punësimi për staf akademik gjenden këto specifitime: Përshkrimi i institucionit dhe fushave të studimit, Njësia që hap pozicionin (Fakulteti i Ekonomisë), Pozicionet vakante, Kurset ku mund të angazhohet stafi i ri, Kualifikimet e kërkuara, Dokumentacioni i aplikimit: Letër interesi dhe CV.</p> <p>Kriteret shpallen publikisht ne faqen e web-it te IKT dhe përzgjedhja bëhet me konkurim të hapur. Ngrihet nje komision rekrutimi qe perbehet nga pergjegjesi I zyres se burimeve njerezore dhe pergjegjes te njesise ose fakultetit. Procesi i rekrutimit është i hapur dhe Komisioni i Rekrutimit analizon kandidaturat, i interviston; u jep dhe mundësinë për një orë të hapur leksioni dhe më pas kandidaturat listohen sipas vlerësimit që japin anëtarët e komisionit. Vlerësimi i performancës së personelit akademik në IKT bazohet në procedura të saktësuara në rregulloret e brendshme institucionale (Libri i Rregulloreve Institucionale). Elementë të rëndësishëm në procesin e</p>

	<p>vlerësimit të kandidatëve janë si më poshtë: 1. Përvoja në mësimdhënie, me prioritet vlerësohet mësimdhënia në universitete e huaja në gjuhën angleze; 2. Grada shkencore PhD ose Doktor, si dhe tituj Profesor, Profesor i Asociuar, Akademik; 3. Cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, ku prioritet u jepet personave me grada shkencore të marrë pranë institucioneve të arsimit të lartë me kredenciale të larta. 4. Përputhja e fushës së studimit me lëndët.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>6. Rregullore Institucionale e KU IKT.pdf(faqe 140-143)  21. CV e Stafit Akademik te programit te studimit BA&amp;IT.pdf  22. CV e Stafit Akademik te Fakultetit Ekonomik.pdf  38. Burimet Njerezore - Check Lista e dosjes personelit.pdf  39. Burimet Njerezore - Hapja e nje pozicioni pune.pdf  40. Burimet Njerezore - Vleresimi i Kandidateve.pdf  41. Burimet Njerezore - Caktimi i nje anetari te ri.pdf  <a href="https://cit.edu.al/faculty-of-economy-vacancies/">https://cit.edu.al/faculty-of-economy-vacancies/</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Instituti i Arsimit të lartë KU IKT ka një mjedis pozitiv pune për të gjithë anëtarët e tij të personelit. Këto u panë dhe nga mënyra e komunikimit të stafit akademik në mbledhjen direkte me stafin akademik por dhe nga vizita në institucion.</p> <p>Shprehen dhe në librin e rregullores institucionale dhe të gjitha këto vlera dhe parime paraqiten në Kodin e Etikës së institucionit. Këto vlera bazohen në parime të tilla si: a. Llogaridhënia për arritjen e rezultateve të larta në veprimtaritë e punës, akademike dhe kërkimore; b. Përkushtim dhe pasion, ndershmëri dhe efikasitet, integritet dhe besueshmëri; c. Punë e përbashkët e bazuar në sinqeritet dhe besim të ndërsjellë; d. Lejimi për të zhvilluar dhe respektuar diversitetin; e. Marrja e përgjegjësive dhe përballja me sfidat; f. Krijimi i një mjedisi tërheqës dhe të përshtatshëm për komunitetin e universitetit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf, Kodi etikës(faqe 9)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Instituti i Arsimit të lartë KU IKT angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik që mbulon programin e studimit. Për këtë janë zhvilluar dhe trajnime të vazhdueshme të stafit akademik dhe këto janë paraqitur dhe në strategjinë e zhvillimit të CIT.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Stafi i përfshirë në këtë program studimi është staf i kategorisë lektor, profesor, asistent lektor dhe master, i cili minimalisht mban gradën master shkencor, IKT mundohet që ta mbështes atë duke u krijuar mundësi për publikime falas në revistën shkencore institucionale, në sponsorizimin e publikimeve të monografive të tyre, si dhe në pjesëmarrjen falas në konferencat e organizuara prej institucionit, ashtu sikurse dhe në sponsorizimin për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare. Institucioni po angazhohet që jo vetëm ta indeksojë revistën CIT Review por edhe ta regjistrojë atë si revistë me faktor impakti. Kjo do t'i sjellë stafit akademik mundësi të shumta për të publikuar në një revistë e cila përfshihet në databazat dhe rankimet më të mira ndërkombëtare të cilat stafi akademik mund t'i përdorë si plotësim për kriteret e caktuara për të aplikuar për titujt akademik.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017.pdf(Prot. 11, faqa 16-18)</p> <p>D13.1. Kriteret ku bazohet komisioni perzgjedhes per dhenien e fondit per kerkim shkencor.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>IKT organizon trajnime të stafit për përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik. Institucioni ka paraqitur disa trajnime që po ben me stafin akademik në përdorimin e metodave të reja të përdorimit të lojrave në mësimdhënie. Kanë zhvilluar disa një trajnim “Trajnim profesional në Cloud Computing dhe DevOps- përparësitë konkurruese dhe koha më e shpejtë për në treg, datë 17-23.12.2020” dhe dy workshop-e në këtë drejtim: Workshop: Aplikimi i elementëve të lojes në edukim, dt 07.10.2021; dhe workshop: përmirësimi i inovacionit me elementet e lojërave, datë 03.11.2021. Gjithashtu ne dokumentet e dorëzuara nga institucioni janë paraqitur disa certifikata trajnimesh që kanë marr stafin akademik nga IKT. Në faqen e univesitetit janë bërë njoftime të organizimit të trajnimeve dhe workshop-eve.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>48. Certifikata trajnimesh dhe uorkshopesh dhene stafit te IKT.pdf  50. Certifikata te dhena nga IKT.pdf  51. Certifikata e vleresime qe IKT ka marre prej institucioneve te tjera.pdf  2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017.pdf(Prot. 11, faqa 16-18)  <a href="https://cit.edu.al/impruve-innovation-with-gamification-workshop-highlights/">https://cit.edu.al/impruve-innovation-with-gamification-workshop-highlights/</a>  <a href="https://cit.edu.al/professional-training-cloud-computing-and-devops-training-competitive-advantag-and-faster-time-to-market">https://cit.edu.al/professional-training-cloud-computing-and-devops-training-competitive-advantag-and-faster-time-to-market</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të</p>	<p>Institucioni ka paraqitur një angazhim maksimal të burimeve njerëzore në gjetjen e stafit akademik me grada dhe tituj që mund të sjell dhe zhvillim të mëtejshëm të progamit të studimit. Nga vizita në institucion zyra e burimeve njerezore ishte e përbërë vetëm nga një person aktualisht. Në</p>



studimeve të ciklit të parë.	<p>programin e studimit “Administim Biznesi dhe Teknologji Informativ” kishte të angazhuar staf akademik me grada dhe me tituj. Gjithashtu stafi kishte dhe studime në fusha direkte programit. Stafi akademik i angazhuar për mësimdhënie në program është plotësisht i brendshëm.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>21. CV e Stafit Akademik të programit të studimit BA&amp;IT.pdf  22. CV e Stafit Akademik të Fakultetit Ekonomik.pdf  22. CV e Stafit Akademik të Fakultetit Ekonomik.pdf  38. Burimet Njerezore - Check Lista e dosjes personelit.pdf  D12. Plani Strategjik për punën e Burimeve Njerezore.pdf</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Institucioni i Arsimit të lartë KU IKT aktualisht është pozicionuar me adresë në Rrugën Xhanfize Keko, Kompleksi Xhura, nr 12. Ka një sipërfaqe totale 2715m<sup>2</sup> në të cilat futen ambientet e parkimit 330 m<sup>2</sup> dhe 2385 m<sup>2</sup> janë ambiente në shërbim të procesit mësimor. Në shërbim të fakultetit të ekonomisë ku përfshihet dhe programi i studimit janë 994 m<sup>2</sup>. Në dispozicion të programi të studimit janë 3 klasa me sipërfaqe 163m<sup>2</sup> për zhvillimi e orëve teorike për leksione, seminare dhe ushtrime. Institucioni ambientet e veta i ka paraqitur dhe të dokumentuara dhe me planimetri dhe gjithashtu u panë dhe gjatë vizitës në institucion. Në dokumentacion institucioni ka paraqitur dhe një raport të grupit të punës për verifikimin e standardeve dhe normativave të infrastrukturës nga MARS datë 28.07.2020.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>32. Planimetria.pdf  33. Kontrata e Qirase.pdf  34. Raporti i Grupit të Punës për Verifikimin e Standardeve dhe Normativave të Infrastruktura nga MASR 28.07.2020.pdf  35. Akti kundër Zjarrit Nr. Prot. C-10325.1, 24.05.2021.pdf  36. Akti Higjieno Sanitar 171, date 24.05.2021.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e</p>	<p>Mjediset mësimore si klasat, laboratorët dhe mjediset e tjera janë të një standarti të lartë dhe janë të pajisura me të gjitha mjetet elektronike dhe mjetet e teknologjisë së informacionit të nevojshme. Sallat e leksioneve dhe seminareve kanë projektor dhe të gjitha mjetet e tjera për zhvillimin e mësimdhënies.</p> <p>Gjithashtu në shërbim të studentëve janë 5 laboratorë në dispozicion dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>të këtij programi të studimit dhe një laborator praktik për zhvillimin e lëndëve të ndryshme aplikative në të cilin kishin pajisje të ndryshme matëse etj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>32. Planimetria.pdf 34. Raporti i Grupit te Punes per Verifikimin e Standardeve dhe Normativave te Infrastruktures nga MASR 28.07.2020.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Institucioni arsimit të lartë KU IKT në dispozicion të programit të studimit mjedise të nevojshme dhe me standartë të larta për plotësimin e kërkesave të moduleve, ka 5 laboratore informatik të pajisur plotësisht me kompjutera, projektor, pajisjet për rrjetet kompjuterike, aparatura matëse të cilat ndodhën në laboratorin praktik (fizike, kimi, elektrike dhe telekomunikacioni), sallë konferencash, salla leksionesh dhe seminaresh të pajisura plotësisht me projektor dhe me kompjuter. Organizimi ambienteve është paraqitur dhe në planimetrine e dorëzuar nga institucioni.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u vizituan të gjitha ambientet dhe ishin plotësisht të kompletuar dhe në kushte optimale.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>32. Planimetria.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni arsimit të lartë KU IKT në dispozicion të programit të studimit ka 5 laboratore informatikë të pajisur plotësisht me pajisjet didaktike si kompjutera, projektor, pajisjet për rrjetet kompjuterike, aparatura matëse të cilat ndodhen në laboratorin praktik(pajisjet që janë vendosur janë për laboratorë në modulet e fizikës, kimi, elektrike dhe telekomunikacioni).</p> <p>Në laboratorët e informatikës janë instaluar të gjithë software-t e nevojshëm që mund të përdoren në modulet përkatëse të procesit mësimor. Software-t që janë të instaluar janë: paketa Libre Office dhe gjithashtu programet profesionale që përdoren kryesisht dhe që janë të listuar janë: MS SQL Server, Microsoft Visual Studio, Netbeans, Wireshar, Programe të virtualizimit dhe të database-ve etj. Gjithashtu në fillim të cdo simestri stafi akademik i moduleve përkatëse për pjesën praktike të lëndëve të tyre mund të bëjë kërkesë që të shtohen software të tjerë në laboratore. Këtë kërkesë mund t'ia bëjë departamentit dhe tek stafi IT që merret me rregullimin dhe mbarvajtjen e laboratorëve.</p> <p>Organizimi i laboratorëve është paraqitur dhe në planimetrinë e dorëzuar nga institucioni. Në katin përdhës janë të pozicionuar laboratorët dhe 3 laboratore kanë mundësi për 45 studentë, një laborator për 42 studente, 51 studentë dhe 49 studentë.</p> <p>Gjate vizitës në institucion u vizituan dhe sallat e laboratorëve dhe ishin plotësisht të kompletuar dhe në kushte optimale.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>32. Planimetria.pdf</p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Institucioni me kapacitetin që zotëron vetë ka mjedise të mjaftueshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale që mund të merren nga pjesa praktike dhe laboratorët e moduleve përkatës të lëndëve të përfshira në programin e studimit. Gjithashtu ka dhe bashkëpunime me institucionet e tjera për zhvillimin e praktikave të studentëve. Në dokumentacion janë paraqitur dhe çertifikata të studenteve të marra nga organizimet e workshop-et ose trajnimet e bëra nga KU IKT. IKT është anëtarësuar dhe në Cisco Academy e cila mund ti japë studenteve dhe me shume mundesi per praktika profesionale.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>47. Informim mbi mundesite e punesimit dhe zhvillimit te praktikave mesimore ne kompani te ndryshme.pdf  49. Certifikata trajnimesh dhe workshopesh dhene studenteve te IKT.pdf  56. Evidenca te organizimit te tryezave te rumbullakta me kompanite, bizneset.pdf  66. Anetaresimi i IKT ne Cisco Academy.pdf  67. Marreveshja CIT-Harvard 2014-2020.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka vendosur në dispozicion të studentëve një bibliotekë shumë të pasur. Biblioteka është e ndare ne dy pjesë në bibliotekën me librat e printuar dhe në bibliotekën online. Biblioteka online ka marrëveshje me “McGrawHill Education” dhe në Platformën O’Reilly.</p> <p>Studentët mund ti shfrytëzojnë bibliotekat plotësisht falas dhe nga ana institucionit janë bërë marrëveshje vjetore të cilat janë të paraqitura dhe në dokumentacionin e dorëzuar. Mjediset e bibliotekës u panë dhe gjatë vizitës në institucion dhe kryesisht librat në bibliotekë janë lënë të gjitha në literaturë angleze dhe vihet re mungesa e librave në shqip. Biblioteka ofron mundësi shfrytëzimi të barabartë nga studentët të cilët mund të futen online ose mund të kërkojnë tituj të ndryshëm për ta lexuar të printuar. Për menaxhimin e librave fizikë përdoret një sistem i menaxhimit të bibliotekës “Koha”. Studentet ose stafi mund të futen dhe të gjejnë librat dhe vendosjen e tyre në bibliotekë.</p> <p>Në bibliotekë studentet mund të gjejnë literatura kryesore në fushat e ekonomisë dhe të teknologjisë së informacionit që janë dhe drejtimet kryesore që janë ofruar nga fakulteti. Literaturat janë bashkëkohore dhe pothuajse të gjitha botimet e fundit që është një nga aspektet më pozitive që mund të merret për institucionin.</p>

	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>D5.1. Marreveshja CIT - TEXO (perfaqesues i O'Reilly).pdf D5.2. CIT McGrawHill Marreveshje 2021-2024.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me disa kopje fizike të literaturave dhe teksteve mësimore që zhvillohen në programin e studimit gjithashtu dhe me literaturën ndihmëse përkatëse. Për gjetjen e kopjeve të librave është në dispozicion një program për menaxhimin e bibliotekës.</p> <p>Kurse në bibliotekën online më të cilën punohet më tepër dhe studentët kane mundesi që ta hapin nga telefoni dhe në laptop janë të gjitha materialet mesimore për lëndët perkatëse të modulit. Gjithashtu rregullat e bibliotekës janë të publikuara dhe onlinë në faqen e web-it të institucionit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>73. Revista Shkencore CIT Review Nentor 2021.pdf 43. Te dhena mbeshtetese per blerjen e literatures ne biblioteken e IKT.pdf 44. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT.pdf <a href="https://cit.edu.al/library-2/">https://cit.edu.al/library-2/</a> <a href="https://cit.edu.al/library-2/McGrawHill-Education-Textbook/">https://cit.edu.al/library-2/McGrawHill-Education-Textbook/</a> <a href="https://cit.edu.al/library-2/library-policies/">https://cit.edu.al/library-2/library-policies/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni i arsimit të lartë KU IKT ka krijuar akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët në bibliotekat onlinë të cilat ata mund ti hapin kudo nga telefoni ose laptopi. Gjithashtu në të gjitha mjediset e IKT të jepet mundësia që të futesh në wireless dhe studentët kanë mundësi që ta aksesojnë bibliotekën online.</p> <p>Studentët mund të futen dhe në bibliotekën e O'Reilly në kompjuterat e vendosur në bibliotekë. Ata kanë mundësi që të aksesojnë të gjitha mjedisete bibliotekës në oraret e caktuara gjatë gjithë kohës që janë në institucion.</p> <p>Mund të përmendim që studentët nuk paguajnë për bibliotekën kryesore që përmban literaturat e librave në anglisht dhe literaturat e kërkuara nga modulet përkatëse. Biblioteka e McGrawHill është plotësisht e përdorshme nga stafi dhe nga studentët. Institucioni ka bërë abonim në bibliotekë me të cilën ka dhe një marreveshje që e ka paraqitur në dokumentacionin e vet.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/library-2/">https://cit.edu.al/library-2/</a> <a href="https://cit.edu.al/library-2/McGrawHill-Education-Textbook/">https://cit.edu.al/library-2/McGrawHill-Education-Textbook/</a> <a href="https://cit.edu.al/library-2/library-policies/">https://cit.edu.al/library-2/library-policies/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike të librave online ose në formatin pdf të cilat janë në dispozicion të studentëve. Gjithashtu në dispozicion të studentëve është vendosur dhe platforma O'Reilly me të cilën kishin një marrveshje bashkepunimi për libra. Biblioteka menaxhohet nga sistemi Koha që është një sistem Open Source. Në bibliotekë zhvillohen dhe takime në formën e workshop-it. Biblioteka ka një kapacitet prej 20 vendesh ku 6 vende janë për përdorim kompjuteri dhe internet.</p>



	<p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/library-2/library-policies/">https://cit.edu.al/library-2/library-policies/</a></p> <p>44. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT.pdf <a href="https://cit.edu.al/library-2/McGrawHill-Education-Textbook/">https://cit.edu.al/library-2/McGrawHill-Education-Textbook/</a></p> <p>43. Te dhena mbeshtetese per blerjen e literatures ne biblioteken e IKT.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Institucioni KU IKT përsa i perket bibliotekës ka një procedurë të posaçme. Në fund të vitit akademik biblioteka i dërgon stafit akademik një formular dixhital “Formular për kërkesë librash” dhe stafi ka kohë dy muaj që ta plotësojë dhe të zgjedhë librat që do të shtojë në bibliotekë dhe që mund ti perdorë për vitin e ardhshëm akademik.</p> <p>Gjithashtu biblioteka online dërgon të gjitha njoftimet për literaturat e fundit të botuara.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>43. Te dhena mbeshtetese per blerjen e literatures ne biblioteken e IKT.pdf <a href="https://cit.edu.al/library-2/McGrawHill-Education-Textbook/">https://cit.edu.al/library-2/McGrawHill-Education-Textbook/</a></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në dispozicion të studenteve dhe ka orarë të përshtatura me nevojat e studentëve. Ajo qëndron e hapur për studentët dhe stafin akademik gjatë gjithë javës.</p> <p>Oraret e bibliotekës janë E henë-E premtë 09:00- 13:00 dhe 14:00-18:00 dhe te shtunën 08:00-15:00. Studentët kanë mundësi të futen online në bibliotekën virtuale te McGrawHill në çdo kohë.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/library-2/library-policies/opening-hours">https://cit.edu.al/library-2/library-policies/opening-hours</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

<p><b>Standardi IV.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni i Arsimit të lartë KU IKT disponon një sistem të menaxhimit në të cilin administron të gjithë informacionin që lidhet me studentet.</p> <p>Sistemi është i njohur me emertimin UMS (University Management System) dhe është i bazuar në një platformë online, i aksesueshëm nga të gjithë studentet, stafi administrative dhe stafi akademik.</p> <p>Secili mund të futet me një username dhe password që jepet nga stafi IT.</p> <p>Sistemi gjendet në faqen online të KU IKT.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/my-cit-2/">https://cit.edu.al/my-cit-2/</a></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>D6. Rregullore per menaxhimin e mesimit dhe mesimdhënies online.pdf</p> <p>Sistemi i menaxhimit UMS bën administimin e informacioneve që janë të lidhura me aktivitetet akademike me programet e studimit. U mundëson studenteve informacion mbi mungesat, vlerësimet, provimet.</p> <p>Sistemi ka të integruar platformën google classroom dhe modulet që mundësojnë komunikimin midis studenteve dhe pedagogëve.</p> <p>Duke patur parasysh integrimin e sistemit të google classroom studentët mund të aksesojnë materialet e dërguara nga pedagogët si slidet, detyrat, projektet lëndës (të dhëna në afatate të caktuara), mund të kenë komunikime direkte me klasën ose me stafin akademik (pra mund të jepen njoftime etj.) Studenti nga UMS merr vlerësimin e vazhdueshëm që i bëhet nga pedagogu i lëndës dhe mund të komunikojë direkt me pedagogun në rast se ka paqartësi.</p> <p>Mënyra se si janë të aksesueshme këto sisteme online është dhënë dhe në rregulloren e menaxhimit të mësimdhënies online.</p> <p>Evidenca:</p> <p><a href="https://cit.edu.al/my-cit-2/">https://cit.edu.al/my-cit-2/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>D6. Rregullore per menaxhimin e mesimit dhe mesimdhënies online.pdf</p> <p>Sistemi i menaxhimit UMS i përdorur nga KU IKT bën të mundur aksesimin e të gjitha informacioneve dhe dokumenteve për personelin akademik dhe për studentët në programin e studimit.</p> <p>Siguron akses në dokumentet e paraqitura nga sekretaria për studentët, gjithashtu në komunikimin direkt me departamentin dhe më pedagogët e lëndëve, ose njoftime të bëra nga departamenti.</p> <p>Studentët janë të lidhur në sistem me adresat e tyre të email-it, kanë mundësinë të aksesojnë google classroom etj.</p> <p>Evidenca:</p> <p><a href="https://cit.edu.al/my-cit-2/">https://cit.edu.al/my-cit-2/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>D6. Rregullore per menaxhimin e mesimit dhe mesimdhënies online.pdf</p> <p>Sistemi UMS i përdorur nga KU IKT ka të integruar google classroom për komunikimin me pedagogët dhe marrjen e materialeve të tjera ndihmëse për lëndën, ka të dhëna për aktivitetin akademik, vlerësimet, mungesat, provimet dhe mund të aksesohet online. Gjithashtu është i lidhur dhe me sistemin e sekretarisë.</p> <p>Studenti mund të komunikojë online nëpërmjet email-it të fakultetit me stafin akademik dhe stafin administrative, ose ndërmjet studentëve të tjerë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><a href="https://cit.edu.al/my-cit-2/">https://cit.edu.al/my-cit-2/</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për</p>	<p>D6. Rregullore per menaxhimin e mesimit dhe mesimdhënies online.pdf</p> <p>Sistemi i menaxhimit të KU IKT garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrative. Sistemi është online dhe mund të aksesohet nga faqja e web-it e IKT. Në sistem futen të gjitha organet drejtuese dhe kontrolluese të komunikimit të stafit dhe studentëve. Ky</p>

organet drejtuese dhe titullarët.	<p>sistem i lidhur dhe me classroom-in është përdorur dhe gjate periudhës së pandemisë.</p> <p>Sistemi mundeson raportime individuale per te dhenat e stafit akademik te cilat ne fund te vitit akademik ruhen ne kopje ne sekretari ose ne Njesite drejtuese te IKT</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/my-cit-2/">https://cit.edu.al/my-cit-2/</a></p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>KU IKT ka të publikuar në faqen e saj zyrtare të internetit çdo informacion që ka të bëjë me programet e studimit, stafin akademik, informacion mbi kriteret e pranimit, tarifat e studimit, përfitimet e bursave të studimit.</p> <p>Informacionet që hidhen e në faqen e internetit zakonisht janë në gjuhën angleze meqenëse është dhe gjuha që zhvillohen programet e studimit.</p> <p>Në mendimin e Grupit të RVJ sugjerojmë që informacionet në faqen e web-it të vendosen në të dyja gjuhët në shqip dhe në anglisht. Kjo për shkak se informacionet që janë të lidhura me programin e studimit mund të shikohen dhe nga prindërit e studentëve të cilet mbase nuk e kane të përvetësuar plotësisht gjuhën angleze. Pasi për stafin akademik dhe për studentet është në formatin e institucionit që komunikmi dhe informacioni do të behet i gjithi ne gjuhën angleze.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/student">https://cit.edu.al/student</a>  <a href="https://cit.edu.al/admissions-3/">https://cit.edu.al/admissions-3/</a>  <a href="https://cit.edu.al/research-2/">https://cit.edu.al/research-2/</a>  <a href="https://cit.edu.al/academics-2/">https://cit.edu.al/academics-2/</a></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="592 1205 746 1272">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="746 1205 962 1272">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="962 1205 1169 1272">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1169 1205 1428 1272">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

**Standardi IV.6**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Institucioni i Arsimit të Lartë KU IKT është një institucion jo publik që operon si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Institucioni financohet nga tarifat e studimit që paguhen nga ana e studentëve, financim nga ana e ortakut dhe donacione të ndryshme që merren nga ana e IKT. IKT ka paraqitur raporte financiare të kostove të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të cilat janë bashkangjitur dhe me dokumentacionet përkatëse. Gjithashtu është bërë dhe raport i Auditimit të jashtëm rezultati i te cilit eshte paraqitur ne dokumentacion.</p>



	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>45. Fakulteti i Ekonomise - Raporti Financiar 2019 - 2022 dhe Plani i Financimit 2021 - 2025.pdf fq. 55.</p> <p>46.Raport i Auditit te Jashtem per institucionin - i pavarur.PDF</p> <p>27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS.pdf fq.55.</p> <p>D1. Studim i Tregut dhe Plan Financiar 2016.pdf (fq. 22-30)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Në planin e financimit të paraqitur nga KU IKT janë përfshirë të dhëna të financimit për pagat dhe kontributet e sigurimeve, shpenzime operative dhe te mirembajtjes, shpenzime të tjera, investime, kërkimi shkencor dhe konferencash.</p> <p>Këto të dhëna janë dokumentuar në listen të cilën kanë paraqitur me poshtë të dhënë në raportin financiar dhe planin e financimit të IKT dhe të përfshira dhe te programit të studimit.</p> <p>Në raportin vjetor të KU IKT janë paraqitur në faqen 55 të gjitha të dhenat financiare për MAS.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>45. Fakulteti i Ekonomise - Raporti Financiar 2019 - 2022 dhe Plani i Financimit 2021 - 2025.pdf fq.55.</p> <p>27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS.pdf fq.55.</p> <p>D1. Studim i Tregut dhe Plan Financiar 2016.pdf (fq. 22-30)</p> <p>D3. Raport Institucional per MAS, 2018-2019.pdf (fq 38-39)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>CIT SHPK pa paraqitur Auditim financiar të çdo viti dhe gjithashtu dhe autitim financiar nga auditor i pavarur. Të gjitha të dhënat financiare janë të dokumentuara dhe transparente. Deri tani është financuar nga te ardhurat nga programet e studimit, nga Ortaku dhe nuk ka përfituar nga grante të jashtme përveç donacioneve të cilat janë të paraqitura dhe në pasqyrën financiare.Ne raportet financiare te dhenat jane paraqitur te pergjithshme.</p> <p>Sugjerojmë që institucioni duhet të shtojë gamën e burimeve financiare të veta pasi nuk mund t'ia lëri peshën më të madhe të të ardhurave vetëm fee-ve të studentëve.</p> <p>Raportet financiare që janë paraqitur nga institucioni mund ti shikojmë dhe të përmbledhura tek tabela 18 faqe 132 tek Shtojcat e RVB ku të ardhurat me kryesore të institucionit janë tarifat e shkollimit, shërbimet trajnuese, donacionet aktivitete siguruese, donacione dhe përpara dy vitesh përfshihen dhe të ardhura nga aktivitete tregtare.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>45. Fakulteti i Ekonomise - Raporti Financiar 2019 - 2022 dhe Plani i Financimit 2021 - 2025.pdf fq.55.</p> <p>46.Raport i Auditit te Jashtem per institucionin - i pavarur.PDF</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri</p>	<p>KU IKT ka paraqitur raporte vjetore financiare në mbyllje të çdo programi studimi. Gjithashtu kryhet një analizë financiare permanente tek</p>

<p>vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>zyra e financës në fund të çdo programi.          Auditimi i pavarur kryen pasqyrën financiare në çdo vit në CIT shpk.          Të gjitha shpenzimet financiare janë të dokumentuara në lëvizjet bankare të institucionit dhe në raportet e dorëzuara janë paraqitur të përmbledhura.          Shikohet që në vazhdimësi për tre vitet e fundit nga të ardhurat në total të paraqitura në tabelen 18 faqe 132 Aneks i RVB, institucioni ka paraqitur një rritje të të ardhurave në total nga tarifat e shkollimit. Kurse nga donacionet, aktivitetet siguroese, fondacionet të ardhurat kanë qënë më të mëdha përpara tre viteve dhe në dy vitet e fundit kanë qënë në rënie. Shërbimet trajnuese vitin e kaluar kanë qënë me mire kurse për këte vit akademik mendoj se akoma nuk është bërë një përmbledhje e plotë.</p> <p><i>Evidencë:</i></p> <p>45. Fakulteti i Ekonomise - Raporti Financiar 2019 - 2022 dhe Plani i Financimit 2021 - 2025.pdf fq.55.          46.Raport i Auditit te Jashtem per institucionin - i pavarur.PDF</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni KU IKT ka paraqitur qëndrueshmëri financiare gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit gjithashtu dhe gjate periudhes se pandemise qe mesimi u zhvillua online. Raportet financiare që ka paraqitur e tregojne këtë. Auditimi i pavarur ka paraqitur paqëndrueshmëri megjithatë deri tani në të ardhurat e paraqitura në tabelen 18 në faqen 132 tek Shtojca e RVB Institucioni ka paraqitur një situatë financiare të qëndrueshme. Në faqen 2 të Raportit të Auditimit të pavarur është paraqitur situata e pasigurisë financiare në të cilin shkruhet që shoqëria ka një humbje të akumuluar dhe një kapital negative. Këto kushte tregojnë dhe ekzistencën e një pasigurie materiale. Gjithashtu citohet se aftësia e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi është e varur nga mbështetja e vazhdueshme financiare e aksionerëve të saj të cilët kanë konfirmuar se ata kanë burime të mjaftueshme për të siguruar mbështetjen e nevojshme financiare për shoqërinë për të paktën dhe 12 muajt e ardhshëm.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>45. Fakulteti i Ekonomise - Raporti Financiar 2019 - 2022 dhe Plani i Financimit 2021 - 2025.pdf fq.55.          46.Raport i Auditit te Jashtem per institucionin - i pavarur.PDF</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



**Standardi V.1****Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni i arsimit të lartë KU IKT ka hartuar procedura dhe politika të cilat mbulojnë ciklin e plotë akademik për studentët. Këto procedura dhe politika janë në përputhje me legjislacionet në fuqi dhe janë paraqitur si pjesë e dokumentacionit të dorëzuar nga IKT. Një nga këto është dhe Rregullorja Institucionale e KU IKT në të cilin janë dhënë të gjithë procedurat Institucionale për veprimin me studentet. Në kapitullin e tretë për Kurset e programit që ndjekin, vlerësimin dhe keshillimin e studentëve. Në kapitullin e katërt internship dhe shkrimi i tezes, në kapitullin e gjashtë kriteret e transferimit dhe të pranimit etj.</p> <p>Gjithashtu tek libri i rregulloreve Institucionale fusha e katërt i takon organizimit të studimeve, fusha e pestë është cikli i parë i studimit, dhe fusha e gjashtë është cikli i dytë i studimit. Aty janë dhënë të gjitha rregulloret në lidhje me të gjithë procedurat e studimit, gjithashtu ekuivalentimin e diplomave, transferimet, ndjekja e programeve nderdisiplonore etj. IKT ka gjithashtu dhe rregullore fakulteti, departamenti dhe rregullore të programit BA&amp;IT. Më poshtë janë paraqitur të gjithë rregulloret në të cilat janë të përfshira procedurat që përfshijnë ciklin e plotë akademik të studentëve.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>6. Rregullore Institucionale e KU IKT.pdf (fq 39-96)  7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq 34-43 )  8. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise.pdf  Rregullore e Fakultetit te Ekonomise (shqip).pdf  Rregullore e dep te Administrim Biznesit dhe IT (shqip).pdf  10. Rregullore e programit BA&amp;IT.pdf  Rregullore e programit te studimit BSc ne Administrim Biznesi dhe IT (Shqip).pdf  Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes shqip.pdf  23. Rregullorja per Kodifikimin e Lendeve.pdf  12. RREGULLORE e Sekretarise cikli i pare 2021-2022.pdf  Manuali i Praktikes Mesimore Bachelor FE shqip.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat e vendosura në rregulloret dhe në statutet e IKT garantojnë barazinë dhe të drejtat e njëjta për të gjithë kandidatët për student dhe për të gjithë studentët që ndjekin programin e studimit. Ato janë të paraqitura në guidën e studentit dhe gjithashtu dhe në rregulloret institucionale.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>D13.2. Libri i Rregulloreve Institucionale-Institutional Book of Regulations.pdf  D14. Guida e Studentit.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e</p>	<p>Procedurat e përdorura nga KU IKT janë lehtësisht të aksesueshme. Ato</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>janë kopje të printura dhe ndodhen në zyrat përkatëse ose paraqitën nga departamenti ose janë të publikuara në faqen e web-it të IKT-së. Studentët mund ti aksesojnë të gjithë nga faja e web-t çdo rregullore që ju duhet në jetën e tyre studentore.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/cit-documents-2/">https://cit.edu.al/cit-documents-2/</a>  <a href="https://cit.edu.al/admission-3/">https://cit.edu.al/admission-3/</a>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf/">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf/</a>  <a href="https://cit.edu.al/open-week-at-cit/">https://cit.edu.al/open-week-at-cit/</a>  D14. Guida e Studentit.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Institucioni akademik çdo vit ka të publikuara kriteret për pranimin e studentëve. Kriteret janë publikuar në faqen zyrtare të IKT dhe gjithashtu janë shpërndarë dhe me broshura.</p> <p>Kriteret e pranimit të studentëve janë vendosur në bazë të kërkesave të MAS. Kriteret kryesore që duhet të kene studentët për të aplikuar në CIT është të kenë një diplomë të shkollës së mesme dhe mesataret e shkollës së mesme mbi 6.5. Gjithashtu duket një notë mesatare në grupin e lëndëve si: Matematika, Informatika dhe Ekonomia për Fakultetin e Ekonomisë.</p> <p>Institucioni pranon dhe studentë të huaj të cilët mund të aplikojnë vetë ose nga një qendër edukimi. Studentet e huaj për të aplikuar duhet të kenë këto kritere: formularin e aplikimit, kopje origjinale të diplomës së shkollës së mesme me listë notash, dokument identifikimi i aplikantit, një kopje e përkthyer në shqip e dokumentit ose çertifikatës që ka kryer të gjitha provimet kombëtare sipas Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/open-week-at-cit/">https://cit.edu.al/open-week-at-cit/</a>  <a href="https://cit.edu.al/admission-3/">https://cit.edu.al/admission-3/</a>  <a href="https://cit.edu.al/academics-2/">https://cit.edu.al/academics-2/</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>KU IKT ka hartuar dhe miratuar dhe me vendim të senatit të vet akademik kriteret për rregjistrimin e studentëve të cilat janë sipas kërkesave të MAS. Ato janë të publikuara në faqen e web-it.</p> <p>Kriteret parashikojnë dhe regjistrimin e studenteve të huaj të cilët duhet të kenë një ekuivalentim të diplomës së shkollës së mesme për tu regjistruar. Studentët e huaj për të aplikuar duhet të kenë këto kritere: formularin e aplikimit, kopje origjinale të diplomës së shkollës së mesme me listë notash, dokument identifikimi i aplikantit, një kopje e përkthyer në shqip e dokumentit ose çertifikatës që ka kryer të gjitha provimet kombëtare sipas Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Institucioni nuk ka paraqitur një ndarje të kuotave fikse për studentët e huaj dhe për studentët tanë. Në faqen e web-it janë paraqitur vetëm kriteret e pranimit të studentëve dhe dokumentacioni që duhet të dorëzohet.</p>

	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>6. Rregullore Institucionale e KU IKT.pdf (fq 39-96)  7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq 34-43 )  60. VSA nr.103, dt 11.10.2021 Miratimi i Rregulloreve..pdf  <a href="https://cit.edu.al/admissions-3/">https://cit.edu.al/admissions-3/</a>  <a href="https://cit.edu.al/academics-2/">https://cit.edu.al/academics-2/</a></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni KU IKT informimin e publikut dhe të kandidatëve të mundshëm e bën dhe nëpërmjet organizimit të Ditëve të Hapura (Open Week), ku stafi akademik takohet me studentët virtualisht ose në institucion dhe u shpjegon kriteret dhe procedurat e pranimit, tarifat dhe mundësitë e rregjitrimit në programe.</p> <p>Gjithashtu institucioni ka marr pjesë në panairë të ndryshme me synim informimin e maturantëve për mundësitë e studimit në IKT. Aktivitetet janë të publikuara dhe në faqen e web-it të institucionit dhe janë paraqitur dhe si evidencë më poshtë.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/open-week-at-cit/">https://cit.edu.al/open-week-at-cit/</a>  <a href="https://cit.edu.al/work-study-fair/">https://cit.edu.al/work-study-fair/</a>  <a href="https://cit.edu.al/work-study-fair-at-pedonalja-murat-toptani/">https://cit.edu.al/work-study-fair-at-pedonalja-murat-toptani/</a>  <a href="https://cit.edu.al/cit-participated-in-the-eu4education-fair-at-europe-house/">https://cit.edu.al/cit-participated-in-the-eu4education-fair-at-europe-house/</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<p><b>Standardi V.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Institucioni vendos në dispozicion të studentit të gjithë informacionin e nevojshëm për përparimin e tij akademik në Guidën e studentit të cilën studentët mund ta gjejnë të publikuar dhe në faqen e web-it.</p> <p>Në pikën 2 jepen të gjitha të dhënat për vitin akademik, regjistrimi, vlerësimin, llogaritjen e notave, provimet, për procesin akademik etj. Në pikën 2.10 jepen të dhënat për diplomimin. Ky informacion është i përfshirë dhe në dokumente të tjera të miratuara nga institucioni si në: statutin , rregulloren institucionale, rregulloren e programit të studimit, rregulloren e sekretarisë, libri rregullores institucionale etj.</p> <p>Ne ditën e parë të fillimit të vitit akademik shpjegohet e gjithë procedura e përparimit akademik, e kalimit nga një vit në tjetrin. Gjithashtu në ditën e parë të çdo semestri pedagogët shpjegojnë procedurat e përparimit të studentëve në modulet perkatëse. Prezantohet syllabusi i lëndës dhe temat kryesore që do të zhvillohen, ndarja e lëndës në detyra, projekte, laboratore, leksione, seminare dhe menyra e vlerësimit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p><i>Evidencë:</i></p> <p>D14. Guida e Studentit.pdf fq. 15-30.  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf/">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni KU IKT e ka paraqitur dhe në rregulloret e veta informimin e studenteve me kriteret dhe procedurat e njohjes, konkretisht është e shkruajtur dhe në rregulloren e sekretarisë dhe gjithashtu dhe në kriteret e pranimit të publikuara. Sipas rregullores së sekretaries për tu pranuar në ciklin e parë të studimeve kandidati duhet të ketë përfunduar me sukses shkollën e mesme me mesatare sipas përcaktimit ligjor. Në rastin kur studentët kërkon transferimin e krediteve, procesi i njohjes dhe i vlerësimit të programit të studimit bëhet nga institucioni KU IKT (në këtë rast njësia pritëse). Procesi i vlerësimit të kurrikulës dhe njohjes së lëndëve bëhet nga komisioni i Njohjes dhe i Ekuivalentimit i Departamentit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>12. RREGULLORE e Sekretarise cikli i pare 2021-2022.pdf (pika 2 Pranimet ne Ciklin e pare ne CIT)  <a href="https://cit.edu.al/admission-3/">https://cit.edu.al/admission-3/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësi të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni i informon studentët e tij në lidhje me procedurat me të cilat bëhet vlerësimi i dijeve dhe të gjitha këto procedura janë të përmenduar dhe në Guidën e Studentit në pikat 2.4 (Ndjekja e lëndës), 2.5 (Vlerësimi dhe notat) dhe 2.6 (testimi).</p> <p>Gjithashtu në secilin program pedagogët kane përfshirë vlerësimin e studentit dhe peshën që zë vlerësimi sipas komponentëve dhe shpërndarjen e komponentëve të vlerësimit. Kjo i referohet dhe tabelës së vlerësimit në rregulloren “Vlerësimi i studentit”.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf fq 53 (vlerësimi i studentit)  D14. Guida e Studentit.pdf(pika 2.4, 2.5, 2.6) fq 21-26.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>IKT sipas dokumentacionit dhe takimeve i informon studentët në vitin e tretë për procedurat e diplomimit. Një informacion paraprak mund ta marrin të gjithë studentët nga Guida e Studentit. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të temës së diplomës dhe rregullorët përkatëse. Këto rregullore janë paraqitur dhe në dokumentacionet që janë dorëzuar nga Institucioni.</p> <p>Studentëve u shpërndahen tematikat e sugjeruara për tu zgjedhur prej tyre për diplomim dhe gjithashtu u shpjegohen procedurat e punimit të temës së diplomës të cilat janë të dhëna dhe në “Manualin e punimit të temës së diplomës”.</p> <p>Rregullorja e punimit të diplomës u dërgohet me email nga sekretaria a fakultetit ose përgjegjësi i departamentit. Studentet njihen gjithashtu dhe me formularin që duhet plotësuar për te aplikuar për zgjedhjen e temës së diplomës dhe pedagogut udhëheqës. Këto procedura janë vërtetuar dhe në</p>




	<p>takimet me studentët ku kishtë dhe studentë të vitit të tretë të cilët aktualisht ishin të njohur me të gjitha procedurat që duhet të ndiqnin për zgjedhjen e temës së diplomës dhe pedagogut. Në guidën e studentit në pikën 2.10 jepet dhe informacioni për përmbushjen e kriterëve për diplomim si dhe për politikat e plagjiarizmit, pronësinë intelektuale dhe mënyrat e citimit dhe referimit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq.62)  13. Manual i Punimit te Tezes se Diplomes.pdf  69. Model i percaktimit te temes se diplomes.pdf  <a href="https://cit.edu.al/orientation-week-at-cit/">https://cit.edu.al/orientation-week-at-cit/</a>  D14. Guida e Studentit.pdf (pika 2.10 Diplomimi)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni KU IKT ka vërtetuar në dokumentet e dorëzuar dhe nga biseda me stafin dhe studentët së si e bën komunikimin e rregulloreve dhe të udhëzuesve që i duhen studentëve gjatë vitit akademik. Ato janë të publikuara në mënyrë periodike në fillim të çdo viti akademik.</p> <p>Java e parë e simestrit në IKT është dhe java e parë e hapur dhe studentët njoftohen prej stafit akademik dhe prej secilit prej pedagogëve për lëndët përkatëse, mbi elementët e programit të lëndës dhe vlerësimin e lëndës.</p> <p>Gjithashtu gjatë të gjithë vitit akademik studentët kanë një “Keshillues Akademik” (Academic Advisory) me të cilin mbetën në kontakt për çdo paqartësi ose problem që hasin gjatë vitit akademik. Kjo gjë u konfirmua nga studentët gjatë takimit në institucion.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/orientation-week-at-cit/">https://cit.edu.al/orientation-week-at-cit/</a>  D14. Guida e Studentit.pdf  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf</a>  76. Vendim Keshilli Fakulteti mbi Keshilluesit akademik per studentet.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>NDK përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.3</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Institucioni KU IKT i informon studentet gjithashtu dhe kandidatët e interesuar që të regjistrohen për student që në fillim të kontaktit të tyre, duke i publikuar programet e studimit dhe strukturat e tyre në fletpalosje ose në faqen e web-it. Studentët kanë mundësinë që të informohen në mënyrë të hollësishme për të gjithë strukturën e programit të studimit, ndarjen në simestre, lëndët që do të ndjekë. Ky informacion gjendet në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>faqen e web-it në kategorinë “Academics”, ku në secilin program sipas departamenteve janë hedhur të dhënat kryesore në të cilat gjendet dhe formati pdf i programit. Në të dhënat kryesore që jepen janë: kohezgjatja e programit, struktura e programit, tarifat, aftësitë e synuara, kriteret e pranimit, afatet e aplikimit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/bachelor-in-business-administration-and-information-technology-2/">https://cit.edu.al/bachelor-in-business-administration-and-information-technology-2/</a>  <a href="https://cit.edu.al/cit-broschures/">https://cit.edu.al/cit-broschures/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë fornuese.</p>	<p>Në faqen e web-it të institucionit janë publikuar edhe Broshurat për ciklin e studimit në të cilat janë paraqitur të dhëna të përgjithshme për programin që ofron KU IKT. Jepen të dhëna për institucionin, bashkëpunimet, mobilitetet, programet e studimit sipas secilit fakulet, çfarë do të mësohet në këtë program dhe mundësitë e punësimit. Përveç këtyre të dhënave që ndodhen në faqën e web-it studentët kanë në dispozicion të gjithë rregulloret të cilat janë të vendosura dhe në bibliotekë. Gjithashtu në sistemin e menaxhimit të brendshëm dhe në classroom studentet kane mundësi të shikojnë syllabuset për secilën nga lëndët që do të ndjekin në këtë program studimi.</p> <p>Në javën e parë të mësimit në secilin semester studentit i bëhet e njohur përmbajtja e syllabusit të lëndës. Kjo është e vërtetuar dhe nga takimi me studentet dhe pedagogët. Në lidhje me programin e studimit cdo gjë është e paraqitur dhe në rregulloren e programit BA &amp;IT të cilat janë dorëzuar në dokumentacionin e IKT.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>10. Rregullore e programit BA&amp;IT.pdf  <a href="https://cit.edu.al/bachelor-in-business-administration-and-information-technology-2/">https://cit.edu.al/bachelor-in-business-administration-and-information-technology-2/</a>  <a href="https://cit.edu.al/cit-broschures/">https://cit.edu.al/cit-broschures/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>IKT ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe me kompani të ndryshme të cilat i ka paraqitur dhe në dokumentacion. Kryesisht studentët informohen mbi mundësitë e punësimit dhe të praktikave ose internship-eve që vijnë në institucion nga kompanitë me të cilat ka marrëveshje në faqen e web-t të institucionit ose nga njoftimet nga zyra e karrierës dhe departamentit.</p> <p>Ndër institucionet që IKT ka marrëveshje janë: European Center of Sustainable Development, Alpine Center Switzerland, Lufthansa Industry Solution, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Shoqëria Ditak, Bursa Shqiptare e titujve, Balfin Group, Innovation and ethernet in real Academy etj. Këtu kemi përmendur dhe disa nga kompanitë të cilat me praktikat që ofrojnë bëjnë të mundur zhvillimin e metëjshëm të studenteve të këtij programi si në fushën e administrim biznesi dhe në fushën e teknologjisë së informacionit.</p> <p>Studentet paraprakishtë janë të njohur me mundësitë e punësimit që mund të kërkojnë në përfundim të këtij programi studimi të cilat jane të</p>




	<p>publikuara dhe në Programin e studimit në BA dhe IT të vendosur si brochure në web-in e CIT. Aty janë përmendur mundësitë e punësimit për studentet që mbarojnë këtë program studimi në fushat me poshtë të sektorit privat dhe publik: në fushën e menaxhimit dhe të teknologjisë së informacionit, si enterpreneur, specialit IT, Administrimin e faqeve të web-it, administrues sistemesh, zhvillues e-commerce, menaxhues database etj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/Bachelor-in-Business-Administration-and-Information-Technology.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/Bachelor-in-Business-Administration-and-Information-Technology.pdf</a> 26. Marreveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Institucioni KU IKT i vendos në dispozicion studenteve informacionin e nevojshëm dhe të përditësuar për organizimin e procesit mësimor, logjistikës, infrastrukturës dhe shërbimeve në funksion të realizimit të tij. Këto informacione janë të publikuara në faqen e web tek kategoria Jeta studentore(Student Life) ku gjejnë të përfshirë informacione për: kalendarin akademik, orarin mësimor, guidën e studentit, formate të ndryshme ndihmëse (për ngrirjen e studimeve, rifillimin e studimeve, përfundimin e studimit), modelet e testeve, mundësitë për të financuar studimet e tyre me zero interes, periodikun e CIT newsletter, qeverinë studentore dhe mundësitë e mobiliteteve që institucioni u ofron. Infrastrukturën e institucionit studentët e mësojnë që në javën e parë që shkojnë në intitucion. Këto bëhen dhe në javët e hapura të cilat publikohen dhe në faqen e web-it ku studenteve u bëhet e ditur e gjithë infrastruktura dhe logjistika që do të kenë në funksion të realizimit të procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/facilities-and-map/">https://cit.edu.al/facilities-and-map/</a> <a href="https://cit.edu.al/student">https://cit.edu.al/student</a> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/11/Akademic-Calendar-Bachelor-2021-2022.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/11/Akademic-Calendar-Bachelor-2021-2022.pdf</a> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/11/BACHELOR-PROGRAMS-FALL-TERM-2021-2022-FINAL-SCHEDULE-sakte.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/11/BACHELOR-PROGRAMS-FALL-TERM-2021-2022-FINAL-SCHEDULE-sakte.pdf</a> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf</a> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Request-for-freezing-studies.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Request-for-freezing-studies.pdf</a> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Request-for-resumption-of-studies.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Request-for-resumption-of-studies.pdf</a> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Request-for-Termination-of-studies.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Request-for-Termination-of-studies.pdf</a> <a href="https://bankacredins.com/financim-per-studentet-e-cit/">https://bankacredins.com/financim-per-studentet-e-cit/</a> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Staf-Students-Mobility-Manual.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Staf-Students-Mobility-Manual.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të</p>	<p>Institucioni KU IKT mundëson administrimin e dokumentacionit dhe aktiviteteteve mësimore përmes sistemeve: UMS, Google Drive, Google</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Classroom. Institucioni i ka mundur studentëve aksesimin në sistemin e menaxhimit të brendshëm UMS përmes email-it të tyre të IKT. Aty mund të marrin informacion për ecurinë në programin e studimit në çdo kohë. Qasja në sistemi UMS është elektronike dhe student mund të ketë akses në sistem në të gjitha pajisjet elektronike si telefona, tablet, PC etj. Aksesimi në sistemin UMS bëhet nga administrata, studentet dhe stafi akademik. Në google Drive menaxhohet procesi i ruajtjes dhe i shpërndarjes së dokumentacionit. Në google classroom menaxhohet informacioni që ka të bëjë me sistemin mësimor. Të gjitha informacionet e procesit mësimor janë të ruajtura në hard copy dhe në sekretari për: procesin mësimor, frekuentimin, procesverbalet e lëndëve, kalueshmërinë, provimet, tezat e diplomave.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/academics-2/">https://cit.edu.al/academics-2/</a>  <a href="https://cit.edu.al/my-cit-2/">https://cit.edu.al/my-cit-2/</a>  12. RREGULLORE e Sekretarise cikli i pare 2021-2022.pdf (pika 3, 4 dhe 5)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Institucioni KU IKT ka paraqitur statistika të studentëve të këtij programi studimi gjatë të gjitha viteve. Këto statistika i ka në sekretarinë e fakultetit dhe në department. Statistikat mbledhen pas çdo sezoni provimesh dhe u vihen në dispozicion strukturave drejtuese dhe kordinatorit të programit të studimit. Statistikat janë të përfshira në raportet vjetore të fakultetit dhe të institucionit, deklarohen në MAS, apo në ASCAL.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS.pdf(fq.42-48)  D3. Raport Institucional per MAS, 2018-2019.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni i dispononte gjitha statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar të cilat ndodhen në sekretari, tërheqjen nga programi, largimet para përfundimit të programit etj. dhe të gjitha këto statistika ndodhen në sekretarinë e fakultetit, në department dhe deklarohen në MAS.</p> <p>Aktualisht nga vizita në sekretarinë e fakultetit u vëzhduan të gjitha dokumentacionet për regjistrimin e numrit të studentëve, tërheqet nga</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p>programi dhe transferimet në këtë program.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020-2021 per MAS.pdf(fq.42-48)</p> <p>D3. Raport Institucional per MAS, 2018-2019.pdf</p> <p>12. RREGULLORE e Sekretarise cikli i pare 2021-2022.pdf (pika 8 dhe 9)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Institucioni i disponon të gjitha të dhënat për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit. Këto të dhëna janë të ruajtura në sekretari ne kopje të printuara ku dorëzohen rregjistrat e mungesave të lëndëve, rregjistrat e rregjistrimeve, rregjistrat e notave, procesverbale notash dhe “Grade report” e cila i ka të specifikuar të gjitha pikët që ka marr studentit gjatë vitit akademik. Ecurinë e studentëve mund ta kontrollojë dhe nëpërmjet sistemit të menaxhimit të institucionit UMS. Në sistem janë hedhur të gjitha të dhënat nga stafi akademik dhe student mund të shikojë ecurinë e vet dhe mund të informohen për mungesat dhe vlerësimet përmes sistemit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>12. RREGULLORE e Sekretarise cikli i pare 2021-2022.pdf (pika 8 dhe 9)</p> <p>27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020-2021 per MAS.pdf(fq.42-48)</p> <p>D3. Raport Institucional per MAS, 2018-2019.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve mblidhen në 110rofi sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Institucioni i ka mbledhur të gjitha të dhënat statistikore të studenteve në raporte të cilat i disponon dhe NJSBC, Komiteti i Kurrikulave dhe Njësia e kërkimit shkencor CIRD të cilat kanë nxjerrë statistikën dhe rezultatet e tyre. Në takimet e bëra në institucion këto njësi kishin të dhëna të plota për studentët. Gjithashtu vlerësimet dhe analizimet e tyre më pas raportohen në njësitë drejtuese tek Dekani dhe Rektori.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020-2021 per MAS.pdf(fq.36-38 Jepen te dhena per NJSBC)</p> <p>27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020-2021 per MAS.pdf(fq.42-48 jepen statistakt per studentet)</p> <p>11. Manuali i Sigurimit te Cilesise - QAU Handbook.pdf</p> <p><a href="https://cit.edu.al/annual-report-2/">https://cit.edu.al/annual-report-2/</a>(Ketu gjendet te publikuara raportet vjetore te CIT)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Institucioni ka raporte periodike të cilat janë të publikuara dhe të paraqitura dhe në dokumentacion për hyrje daljen e studenteve në këtë program studimit. Gjithashtu paraqet se ka kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar (ALUMNI), cilësinë e punësimit të tyre dhe arritjet e mëteshme. Njësia kyesore ka mbledhur të dhëna të rëndësishme për punësimin e tyre dhe ka organizuar aktivitete dedikuara për ALUMNI. Këto të dhëna janë publikuar dhe në faqen e web-it të</p>

	<p>institucionit, ku janë paraqitur dhe opinionet e studenteve të diplomuar. Në ndihmë të studentëve për punësimin e mëvonshëm ose për informacione periodike të tyre (internship ose praktika) shërben dhe zyra e këshillimit të karrierës. Detyrë e kësaj zyre janë çeshtjet studentore dhe më poshtë është dhënë në evidencë dhe manuali i këshillimit të karrierës që jep detyrat dhe kompetencat e kësaj zyre. Institucioni ka dorëzuar dhe një dokument ku paraqitet gjurmimi i studenteve të diplomuar në KU IKT.</p> <p>Nga rezultatet e nxjerra nga gjurmimi i studentëve të IKT në pesë vitet e fundit mund të shikojmë që një pjesë e konsiderueshme e studentëve janë punësuar në profilin e studimeve që ata kanë ndjekur. Disa nga punët që mund të përmendim janë: Grafic Designer, Finance, Shërbimi i Klientit, Keshillues në Real Estate, Menaxher i Mediave Sociale, në Bankë, Bussines Development Manager, Këshilli kombëtar i Kontabilitetit dhe një pjesë e studenteve janë dhe pedagog në IKT. Studentet janë të përfshirë në punë në të dyja profilet që kanë studiuar në këtë program studimi.</p> <p>Duke marrë parasysh evidencat e nxjerra nga Alumni dhe nga ato të paraqitura në faqen e web-it të universitetit duket që studentët e këtij institucioni dhe të këtij programi kanë patur një karrierë të suksesshme në profesionin e tyre</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>47. Informim mbi mundësitë e punësimit dhe zhvillimit të praktikave mesimore në kompani të ndryshme.pdf  77. Gjurmimi i studenteve të diplomuar nga IKT dhe NJSBC në 5 vitet e fundit.pdf (fq. 13-17 studentet e BA&amp;IT)  74. Strategjia e Angazhimit të ALUMNI.pdf  15. Manuali i Këshillimit të Karrierës.pdf  <a href="https://cit.edu.al/alumni-spotlight/">https://cit.edu.al/alumni-spotlight/</a>  <a href="https://cit.edu.al/cit-alumni-on-focus/">https://cit.edu.al/cit-alumni-on-focus/</a>  <a href="https://cit.edu.al/alumni-association-march-2017/">https://cit.edu.al/alumni-association-march-2017/</a>  <a href="https://cit.edu.al/meet-our-alumni-of-the-faculty-of-economy-iris-dibra/">https://cit.edu.al/meet-our-alumni-of-the-faculty-of-economy-iris-dibra/</a>  <a href="https://cit.edu.al/cit-alumni-ibrahim-cekirri/">https://cit.edu.al/cit-alumni-ibrahim-cekirri/</a>  <a href="https://cit.edu.al/meet-francesko-kalaj-one-of-our-amazing-cit-alumni/">https://cit.edu.al/meet-francesko-kalaj-one-of-our-amazing-cit-alumni/</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

<b>Standardi V.5</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b> <b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b> Institucioni i përfshin studentet në organet e veta vendimmarrëse dhe këshilluese si në Senatin Akademik, Këshillin e Fakulteteve, Këshillin e Etikës, Komitetin e Bursave, Komitete të komisioneve të tjera. Gjithashtu studentët janë përfshirë me një përfaqësues dhe në

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>organizimin e RVB. Në senatin akademik nga një përfaqesues të studenteve institucioni e ka shtuar dhe ka vendosur që të këtë 3 përfaqesues të studenteve duke i dhënë me shume pëshë mendimit të studentëve dhe përfshirjes së tyre në vendimarrje.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 12-15 Organizimi i senatit akademik)</p> <p>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 21 Funkzioni i Keshillit te Fakultetit)</p> <p>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 24 Ngritja dhe funksionimi I keshillit te etikes)</p> <p>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 26 Organizimi I NJSBC)</p> <p>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 33 Komiteti Permanent per Programet dhe Kurrikulat)</p> <p>D4.1. VSA nr. 7, 24.09.2021.pdf (pika 15 gjenden komitetet per komisionet institucionale)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studenteve dhe të përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim dhe vlerësim të procesit akademik. Janë paraqitur dhe në librin e rregulloreve intitucionale përfshirja e studenteve në disa nga njësitë kryesore në senatin akademik, këshillin e fakultetit, këshillin e etikës, NJSBC, komitetin për programet dhe kurrikulat.</p> <p>Në vendimin e senatit akademik nr 7, datë 24.09.2021(pika 15) gjenden komitetet dhe komisionet institucionale në të cilat studentët përfaqësohen pothuajse në secilin prej tyre. Nga takimi me studentët u verejtë që përfshirja e tyre në vëndimarrje, këshillim dhe vlerësim të procesit akademik është reale. Duhet marr parasysh dhe se në senatin akademik studentët kanë 25% të përfaqësimit. Studentët gjithashtu organizohen dhe përfaqësohen nëpërmjet Qeverisë Studentore. Institucioni ka ngritur dhe një organizim të brendshëm në mbrojtje të të drejtave të studenteve që është dhe roli i Dekanit të studentëve.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 12, 21, 24, 26 dhe 33)</p> <p>D4.1. VSA nr. 7, 24.09.2021.pdf (pika 15 gjenden komitetet per komisionet institucionale)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Ngarkesa akademike e studenteve në programin BA&amp;IT është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe VKM nr 41. datë 24.01.2018. Studentët kanë të drejtë të kërkojnë njohjen e studimeve të mëparshme të cilat janë të shprehura dhe në rregulloret e programit dhe rregulloret e sekretarisë mësimore. IKT në përputhje me kartën e Bolonjës pranon transferime të studentëve nga shkollat e tjera pasuniversitare, vendase ose të huaja, publike dhe jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkollat e tjera.</p> <p>Në procedurën e transferimit bëhet një kërkesë me shkrim nga student dhe e pas procedurat e tjera të fakuletit që është njohja e lëndëve dhe</p>





	<p>rregjistrimi i tij. Studentëve mund tu njihen kreditet në këtë program studimi në fusha të njëjta ose të përaferta që janë përcaktuar dhe kriteret në rregulloren e transferimit të IKT.</p> <p>Në rast se student transferon studimet në IKT duhet të frekuentojë aq disiplina te programit sa të fitojë të paktën 50% të krediteve. Në çdo rast studentet duhet të ndjekin jo më pak se 25% të krediteve teorike, si dhe diplomën dhe praktikën profesionale.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>Rregullore e programit te studimit BSc ne Administrim Biznesi dhe IT (Shqip).pdf (fq.8 pika 9 Transferimet)</p> <p>10. Rregullore e programit BA&amp;IT.pdf(fq.8 pika 9 Transferimet)</p> <p>12. RREGULLORE e Sekretarise cikli i pare 2021-2022.pdf (fq.8 pika 9 Transferimet)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Institucioni KU IKT ka paraqitur që studentët e tij janë të përfshirë në dy komisione të rëndësishme në Komitetin Permanent për Programet dhe Kurrikulat dhe NJSBC Njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Përfshirja në këto dy njësi i jep mundësinë studentëve që të marrin pjesë në proceset që kanë të bëjnë me përmirësimin e programeve të studimit, rishikimin e programeve të studimit, hapjen e programeve të reja të studimit, vlerësimin e mësimdhënies etj.</p> <p>Përfaqësimi në senatin akademik me 25% të studenteve i jep peshë mendimit dhe vlerësimit të tyre në organet vendimarrëse.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 26 Organizimi I NJSBC)</p> <p>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 33 Komiteti Permanent per Programet dhe Kurrikulat)</p> <p>14. Manuali i Stafit Akademik Tetor 2021.pdf(fq 32 Komiteti i Kurrikules)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Institucioni KU IKT ka paraqitur në dokumentacionet e tij organizimin në mënyre periodike të takimeve me qeverinë studentore dhe gjithashtu pyetësorë për vlerësimin e programeve të studimit dhe stafit akademik. Këto pyetësorë organizohen nga NJSBC dhe kopje të tyre dhe rezultatet e tyre janë të ruajtura në dokumentacionet e saj. Gjatë takimit me përfaqësuesit të NJSBC u panë dhe pyetësorët dhe disa rezultate të tyre. Duke marr parasysh që pyetësorët janë anonime mendimi i studenteve është stimuluar dhe nuk është penalizuar. Elementët kryesorë të vlerësimit përmbushin parimin e kontrollit të vazhdueshëm: punimet, projektet, nivelin e aktivizimit në seminare dhe punë laboratorike, provimet e ndërmjetme, detyra kursit etj.</p> <p>Studenti gjithashtu ka të drejtë të kërkojë për rivlerësim dhe të ankimojë vlerësimin. Proçedurat që ai duhet të ndjekë përcaktohen në rregulloren e sekretarisë. Më pas organizohet një komision i vecantë për shqyrtimin ankesës. Studenti ka të drejtë të bëjë dhe ankesa të cilat nuk kanë të bëjnë me aspektin akademik dhe ato do të merren në shqyrtim. Nëse studentin nuk është i kenaqur me zgjidhjen e ofruar nga komisioni ai mund të drejtohet tek zv Rektori për të patur një zgjidhje të mëtejshme</p>


	përfundimtare.			
	<i>Evidenca:</i>			
	7. - Libri i Rregulloreve -Institucionale.pdf (fq. 53-56 Vleresimi I Studentit)			
	7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 26 Organizimi I NJSBC)			
	7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 28-32 Procedurat per mbeshtetjen dhe permiresimin e cilesise se programeve te studimit.)			
	31. Model Vetvleresimi i stafit akademik 2020 - 2021.pdf			
	11. Manuali i Sigurimit te Cilesise - QAU Handbook.pdf			
	12. RREGULLORE e Sekretarise cikli i pare 2021-2022.pdf (fq. 6-7 pika 5.6 Kerkesa per rivleresim dhe ankimime te ndryshme.)			
	29. Model Pyetesori Bachelor Administrim Biznesi & IT.pdf			
	30. Model Pyetesori per Stafin.pdf			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.6

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni KU IKT shërbimin ndaj studentëve e ofron nëpërmjet Zyrës së Studenteve dhe Keshillimit të Karrierës. Gjithashtu në strukturën administrative është një post i Koordinatorit të Mardhënieve me Studentët. Detyrë e Koordinatorit është informimi, këshillimi, ndjekja e përparimit të studenteve dhe asistimi i tyre për çështje të natyrës akademike. Të gjitha detyrimet e këtyre njësive janë shprehur në Manualin e Këshillimit të Karrierës.  <i>Evidenca:</i> D4.2. VSA nr. 17, 11.10. 2019.pdf (pika 13) 15. Manuali i Keshillimit të Karrieres.pdf
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	KU IKT në vendimet e veta të këshillit të fakuletetit jep dhe tutoriatin akademik dhe këshillimin akademik. Cdo anëtar i personelit të brendshëm akademik është një këshillues akademik për studentët, ka në ngarkim një grup studentësh dhe qëndron 1 orë në javë në një zyrë sallë të caktuar në funksion të këtij shërbimi. Studenti ruan kontakt me të njëjtin pedagog gjatë gjithë ciklit të studimeve. Lista e studentëve e shpërndare sipas Këshillimit Akademik mbahet në Sekretarinë e fakulteteve dhe nga Rregjistrati. Për këshillimin e studentëve shërbejnë dhe zyrat e këshillimit të karrierës dhe koordinatori i mardhënieve me studentët.

	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>76. Vendim Keshilli Fakulteti mbi Keshilluesit akademik per studentet.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni KU IKT dhe Departamenti BA&amp;IT ofrojnë këshillim karrierë për studentët e programit të BA&amp;IT dhe gjithashtu dhe për studentët e tjerë. Përveç pedagogëve që janë Këshillues Studentësh, është ngritur dhe në nivel institucional dhe funksionon zyra e Shërbimit të Studentëve e cila në bashkëpunim me zyrën e Marketingut dhe Koordinatorin ofron mbeshtetje dhe asistencë për studentët lidhur me procesin mësimor dhe praktikat profesionale. Studentëve u dërgohen me email mundësi të ndryshme punësimi, trajnime, praktika mësimore, erasmuse dhe internship-e të cilat ofrohen nga intitucione të tjera ose kompanitë bashkëpunetore të IKT. Nga dokumentacioni i dërguar nga institucioni IKT ka marrëveshje të ndryshme me kompani prestigjioze dhe mundësitë e studentëve për punësim dhe për praktika profesionale janë shumë të mira. Këto i verifikojmë dhe tek Marrëveshjet me biznesin, sipërmarrjet dhe institucionet e tjera. Gjithashtu ka paraqitur dhe leksionë të hapura dhe takime me biznesin ku janë paraqitur mundësitë që kanë studentët në të ardhmen për një punë në profesionin e tyre.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>47. Informim mbi mundesite e punesimit dhe zhvillimit te praktikave mesimore ne kompani te ndryshme.pdf</p> <p>26. Marreveshjeve me biznesin, siper marrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>KU IKT ka të formuar strukturën Alumni pjesë e të cilës janë të gjithë studentët e diplomuar nga programet e ofruara dhe studentët e programit të BA&amp;IT.</p> <p>Gjithashtu ka patur organizime, takime të organizuara të Alumni të cilat janë tregues shumë efikas për të treguar ecurinë e studentëve pas diplomimit. Në këto takime janë shpërndarë eksperiencat e ndryshme, prezantimi i kërkesave të tregut të punës, risitë e tregut të punës etj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>47. Informim mbi mundesite e punesimit dhe zhvillimit te praktikave mesimore ne kompani te ndryshme.pdf</p> <p>77. Gjurmimi i studenteve te diplomuar nga IKT dhe NJSBC ne 5 vitet e fundit.pdf (fq. 13-17 studentet e BA&amp;IT)</p> <p>74. Strategjia e Angazhimit te ALUMNI.pdf</p> <p>15. Manuali i Keshillimit te Karrieres.pdf</p> <p><a href="https://cit.edu.al/alumni-spotlight/">https://cit.edu.al/alumni-spotlight/</a></p> <p><a href="https://cit.edu.al/cit-alumni-on-focus/">https://cit.edu.al/cit-alumni-on-focus/</a></p> <p><a href="https://cit.edu.al/alumni-association-march-2017/">https://cit.edu.al/alumni-association-march-2017/</a></p> <p><a href="https://cit.edu.al/meet-our-alumni-of-the-faculty-of-economy-iris-dibra/">https://cit.edu.al/meet-our-alumni-of-the-faculty-of-economy-iris-dibra/</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



standardit				X
------------	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Institucioni në funksion të sigurimit të cilësisë ka ngritur një strukturë të qëndrueshme e cila vepron në përputhje të plotë dhe me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë nr. 80/215, Njesia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Sigurimi i Njësisë së Brendshme të Cilësisë është garantimi i cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, të personelit akademik dhe të studentëve, veprimtarive administrative dhe organizative. NJSBC ka nisur punën e vet në IKT në vitin 2013 me vendim të senatit akademik datë 22.05.2013. NJSBC e mbështet punën e vet mbi përcaktimet ligjore, statutore si dhe rregullore përkatëse.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>D4.3. VSA nr. 16 per krijimin e NJSBC 2013.pdf  7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 26 Organizimi I NJSBC)  Statuti i KU IKT 2016.pdf  1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar.pdf (neni 28 dhe 29)</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<p>Institucioni ka të ngritur Njësinë e Sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe ajo zbaton një strategji të qartë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, në të cilën përfshihen studentët, stafi akademik dhe ekspertë të jashtëm. Parimi i funksionimit të NJSBC jepet në Statutin e KU IKT dhe në Librin e Rregulloreve Institucionale ku është përcaktuar qartë parimi i funksionimit. Përcaktohet krijimi i NJSBC, përcaktimi i anëtarëve të saj (ka pesë anëtare), dy janë personel akademik, një personel administrativë, një nga anëtarët është student dhe një është ekspert i jashtëm. Kryetari i njësisë është eksperti i jashtëm dhe propozohet nga rektori dhe miratohet nga senati akademik.</p>



	<p><i>Evidenca:</i></p> <p>11. Manuali i Sigurimit te Cilesise - QAU Handbook.pdf Statuti i KU IKT 2016.pdf 1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar.pdf (neni 28 dhe 29) 7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 26 Organizimi I NJSBC)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i cilësisë i Institutit KU IKT kryesisht bëhet nga NJSBC kurse sigurimi i jashtëm i cilësisë bëhet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike krahasuese etj. Përsa i përket sigurimit të jashtëm të cilësisë programi aktualisht ka qënë i akredituar dhe po i bëhet procesi i riakreditimit dhe institucioni gjithashtu është i akredituar nga ASCAL në vitin 2017 për 5 vite. Kurse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është në kompetencat e NJSBC ta siguroje atë nëpërmjet detyrave kryesore të saj që janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të hartojë politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe akte të cilat miratohen nga senati akademik,</li> <li>• të hartojë standartet e sigurimit të cilësisë në përputhje me kodin e cilësisë, të vlerësojë në mënyre periodike rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore,</li> <li>• të kryejë studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga kolegjii,</li> <li>• në fund të çdo simestri para sezonin të provimeve ajo organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi,</li> <li>• të raportojë përpara senatit akademik rezultatet dhe propozimet përkatëse të vlerësimeve.</li> </ul> <p>Gjithashtu në takimin me përfaqësuesit e NJSBC u verifikuan disa vlerësime të cilat ishin bërë në çdo vit akademik për personelin akademik dhe dokumentacionet e tjera të saj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>77. Gjurmimi i studenteve te diplomuar nga IKT dhe NJSBC ne 5 vitet e fundit.pdf (fq. 13-17 studentet e BA&amp;IT) 1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar.pdf (neni 28 dhe 29) 7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 26 Organizimi I NJSBC) 29. Model Pyetesori Bachelor Administrim Biznesi &amp; IT.pdf 30. Model Pyetesori per Stafin.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka të përgatitur të gjithë dokumentacionin, rregulloret, politikat dhe procedurat që kërkohen për të standartizuar cilësinë në përputhje me kërkesat e ligjit. Sigurimi i cilësisë kërkon nga të gjithë punonjësit maksimumin e performancës dhe kualifikimi të vazhdueshëm. Politikat që standartizojnë funksionimin dhe detyrat e NJSBC janë: Organizimi i njësisë së Brendshme të Cilësisë dhe procedurat për mbajtjen dhe përmirësimin e cilesisë së programeve, politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit. Ndër dokumentet kryesore që është paraqitur dhe që tregon mbarëvajtjen e punës së NJSBC është “Manuali i NJSBC”.</p>




Strategjia për sigurimin e cilësisë shprehet me qëllimet, parimet dhe objektivat që ka kjo njësi. Qëllimet e NJSBC janë: rritja e vazhdueshme e cilësisë së drejtimit të IKT përmes krijimit dhe zbatimit të politikave dhe procedurave bashkëkohore dhe angazhimit në të gjitha nivelet drejtuese dhe organizative, aplikimi i vazhdueshëm i filozofisë së IKT, rritja e vazhdueshme e cilësisë së formimit të studentëve.

Parimet mbi të cilat është krijuar NJSBC janë: krijimi i nje tabloje te qarte dhe reale të gjendjes aktuale të IKT, ngritja e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, garantimi transparencës.

Objektivat e NJSBC janë: monitorimi vazhdueshëm i drejtimit të institucionit, ndjekja e vazhdueshme e gjendjes së programeve të lëndëve dhe vlerësimi periodik, ndjekja e vazhdueshme e nivelit të stafit akademik, monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies, ndjekja e ecurisë së kërkimit shkencor, përfshirja e studentëve në veprimtari, ndjekja e bashkëpunimeve të IKT me institucionet e tjera, shkrirja e sigurimit të brendshëm të cilësisë në të gjitha hallkat organizative.

IKT përdorë metodologji vlerësimi dhe instrumente matës për sigurimin e cilësisë në institucion. Përdorë pyetësorë dhe formularë vetëvlerësimi për të kontrolluar mbarëvajtjen e mësimdhënies në programet e studimit dhe gjithashtu dhe vlerësimin e stafit akademik.

Statuti i IKT lidhur me akreditimin e jashtëm cilëson se sigurimi i jashtëm realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit, në përputhje me afatet, procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë. NJSBC bashkëpunon me ASCAL duke marr pjesë në trajnime dhe takime të organizuara prej tyre rreth cilësisë, standarteve dhe proceseve të vetëvlerësimit.

IKT për njësitë kryesore ka përdorur dhe vlerësues të jashtëm për programet e studimit. Për sigurimin monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit ka hartuar "Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e programit të studimit".

*Evidenca:*

- 1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar.pdf (neni 89)
- 7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 26-27 Organizimi I NJSBC)
- 7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 28-32 Procedurat per mbajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve)
- 7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 29 Procedurat per mbështetjen dhe përmirësimin e programit të studimit)
- 7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 147-148 Politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit)
- 11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook.pdf
- 31. Model Vetëvlerësimi i stafit akademik 2020 - 2021.pdf

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet			
	pa përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				<b>X</b>

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni KU IKT ka ngritur njësi të posaçme në funksion të monitorimit të programit të studimit, për shqyrtimin, rishikimin e programeve të studimit. Strukturat që janë ngritur për këto detyra janë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>-Komiteti Permanent për Programet dhe Kurrikulat (KPPK)</li></ul> <p>Ky është organi më i lartë që kontribuon në procesin e vlerësimit dhe përmiresimit të programeve të studimit. Përbëhet nga 6 anëtarë dhe anëtarët zgjidhen nga senati akademik. Kjo njësi vlerëson nëse është nevoja për hapjen e programeve të reja të studimit dhe situatën e programeve ekzistuese. Mandaton Komitetin e programit ose Kurrikules dhe ben një vlerësim sipas një procesi periodic (i paraqitur dhe në librin e rregulloreve institucionale).</p> <ul style="list-style-type: none"><li>-Komiteti i Programit ose Kurrikulës</li></ul> <p>Antarët zgjidhen nga KPPK dhe mund të jenë anëtarë te komisioni ose nga stafi akademik. Kryesuesi i Komisionit duhet të sigurojë që programi i studimit të rishikohet periodikisht.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 33 Komiteti Permanent për Programet dhe Kurrikulat (KPPK))</li><li>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 33 Komiteti i Programit ose Kurrikules)</li><li>11. Manuali i Sigurimit te Cilesise - QAU Handbook.pdf (fq. 8-9)</li></ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni KU IKT përdor mekanizma dhe procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit të studimit. Kontrolli i brendshem i performancës është në funksion të cilësisë së mësimdhënies dhe synon arritjen e objektivave dhe standarteve bashkëkohore dhe zbatimin e metodologjive bashkëkohore. Këto janë vërtetuar dhe nga organizimi i programit dhe literaturat e fundit që përdoret për secilën nga lëndët e programit. Kontrolli realizohet duhet bërë dhe vlerësimin e stafik akademik në këto forma: nga vlerësimi i studentëve në pyetesorët e studentëve dhe nga vetëvlerësimi i performancës së çdo pedagogu, vlerësimi prej eporeve etj. Të gjitha dokumentacionet u verifikuan nga takimi me NJSBC në Institucion.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 28-32 Procedurat per mbajtjen dhe permiresimin e cilesise se programeve)</li><li>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 29 Procedurat per mbeshtetjen dhe permiresimin e programit te studimit)</li><li>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 147-148 Politikat dhe procedurat e vetvleresimit)</li></ul>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>31. Model Vetvlerësimi i stafit akademik 2020 - 2021.pdf 11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook.pdf</p> <p>Institucioni KU IKT përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente për vlerësimin, për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit. NJSBC ka plan vjetor pune në këtë aspekt i cili bëhet i ditur që në fillim të vitit akademik. Në varësi të planit të punës bëhet i ditur aktiviteti i njësisë në lidhje me zhvillimin e pyetësorëve, vlerësimin të arritur prej tyre, analizimi të pyetësoreve dhe problematikave, ndërtimi i raporteve të vlerësimin etj. Në përfundim të procesit hartohet raporti i programit të studimit i cili firmoset nga përgjegjësit e departamentit, komitetit të programit dhe vlerësuesit të jashtëm. Manuali i sigurimit të cilësisë organizon komponentet kryesorë për sigurimin e cilësisë: programe studimi cilësore, staf kompetent dhe i aftë për realizimin e programit të studimit dhe proces akademik i orientuar drejt studentit.</p> <p>Institucioni KU IKT kryen vlerësime në dy nivele: në mënyrë të vazhdueshme për institucionin dhe vlerësime për programet e studimit (cilësinë e mësimdhënies dhe programet e lëndeve).</p> <p>Vlerësimi i programit të studimit kryhet përmes këtyre instrumenteve matës: vlerësimi prej studentëve, vlerësimi periodik nga komiteti kurrikulës, vetëvlerësimi i stafit akademik.</p> <p><i>Evidencë:</i></p> <p>11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook.pdf (fq. 8-9) 31. Model Vetvlerësimi i stafit akademik 2020 - 2021.pdf 29. Model Pyetësi Bachelor Administrim Biznesi &amp; IT.pdf 30. Model Pyetësi për Stafin.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Vlerësimet e bëra nga NJSBC bëhen online përmes Google Forms dhe me pas përpunohen prej saj. Të dhënat në formë e raportit i dërgohen Rektorit, Senatit Akademik, dhe Dekaneve.</p> <p>Vlerësimi i studentëve për pedagogun e lëndës në mënyrë të përmbledhur dhe të përpunuar i dërgohet në email çdo pedagogu privatisht.</p> <p>NJSBC kryen dhe pyetësorë të ndryshëm vlerësues si ata me ALUMNI ose dhe pyetësorë që kanë të bëjnë me mësimin online. Të gjitha të dhënat e mbledhura prej pyetësorëve përpunohen në formatin e raportit dhe u dorëzohen autoriteteve drejtuese.</p> <p>Të dhenat e marra nga pyetësoret gjithashtu publikohen dhe në faqen e web-it të IKT. Më poshtë tek evidencat kam dhënë linket ku janë dhënë përmbledhje e pyetësorit, një raport pyetësori etj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pyetesorit-2020-2021-1.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pyetesorit-2020-2021-1.pdf</a> 11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook.pdf (fq. 20-24) 11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook.pdf (fq. 57-63 Modeli vetvlerësimin të programit) <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pyetesorit-">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pyetesorit-</a></p>






	<p>2020-2021-1.pdf  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/survey.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/survey.pdf</a>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Institucioni IKT tregon transparencë në mënyrën se si i publikon të dhënat dhe të informojë studentët, stafin si dhe të gjitha palët e interesuara mbi ecurinë e procesit mësimor në institucion dhe të publikojë vlerësimin e studenteve në këtë proces. Ndër problematikat më të evidentuara ka paraqitur që janë ato lidhur me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orëve të mësimi, cilesinë në shpjegim dhe kontroll etj. Në formatin e vetëvlerësimit strukturat menaxhuese kur e shikojnë të arsyeshme kanë mundësinë të bëjnë komente dhe sugjerime për secilin anëtar të stafit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pyetesorit-2020-2021-1.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pyetesorit-2020-2021-1.pdf</a>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf</a>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/survey.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/survey.pdf</a>  29. Model Pyetesori Bachelor Administrim Biznesi &amp; IT.pdf  30. Model Pyetesori per Stafin.pdf</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Institucioni ka paraqitur që vlerësimin e programit të studimit e kryen në mënyrë periodike përmes pyetësorëve të studentëve në fund të çdo semestri ku vlerësohet programi i studimit dhe pedagogu i lëndës. Në dokumentacionet janë Modeli i pyetesorit për BA&amp;IT dhe Modeli i Pyetesorit për Stafin. Vlerësimi për stafin dhe lëndët bëhet në fund të çdo semestri përpara provimeve përfundimtare. Vlerësimi i programit të studimit bëhet në mënyrë periodike nëpërmjet formateve google forms. Institucioni e ka përfshirë këtë informacion në dosjen e vetëvlerësimit institucional dhe vlerësimet e programit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>29. Model Pyetesori Bachelor Administrim Biznesi &amp; IT.pdf  30. Model Pyetesori per Stafin.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës</p>	<p>Institucioni për kryerjen e procesit të vetëvlerësimit përdor metoda dhe instrumente të ndryshme ndër të cilat mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Pyetësorët, anketime</li> <li>-raporte vjetore institucionale, programesh, vlerësimesh</li> </ul>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>akademike të programit të studimit.</p>	<p>-Vëzhgime -Analiza Vjetorë për studentët etj. Dokumentacionet që ka dorëzuar fakulteti dhe dokumentacionet e publikuara në faqen e web-it na japin gjithë procedurat me të cilat intitucioni bën proçesin e vlerësimit.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>29. Model Pyetesori Bachelor Administrim Biznesi &amp; IT.pdf 30. Model Pyetesori per Stafin.pdf <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf</a> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/survey.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/survey.pdf</a> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pyetesorit-2020-2021-1.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pyetesorit-2020-2021-1.pdf</a> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucioni në mbarevajtje të programin të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta dhe metoda të tërthorta. Bëhet vlerësimi i cilësisë së mesimdhënies i cili bëhet me anë të pyetësorëve për Stafin akademik dhe pyetësorit për programet Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni. Gjithashtu në këto pyetësor bëhet vlerësimi i didaktikës, kurrikulës, vlerësime të detyrave të studentëve etj. Metodat e drejtpërdrejta të përdorura në procesin e vlerësimit në IKT përfshijnë: takimet e autoriteteve drejtuese me Studentët, takimet a autoriteteve drejtuese me qeverinë studentore, takimet me studentët ALUMNI, takimet e përgjegjësve të departamenteve me studentët, vëzhgimi në auditor, vlerësimi i testeve, kalueshmëria, frekuentimi, ngelja etj.</p> <p><i>Evidencë:</i></p> <p>27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS.pdf 77. Gjurmimi i studenteve te diplomuar nga IKT dhe NJSBC ne 5 vitet e fundit.pdf (fq. 13-17 studentet e BA&amp;IT) 74. Strategjia e Angazhimit te ALUMNI.pdf 31. Model Vetvleresimi i stafit akademik 2020 - 2021.pdf <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/survey.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/survey.pdf</a> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pyetesorit-2020-2021-1.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pyetesorit-2020-2021-1.pdf</a> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf</a> 61. Katalogu i Veprimtarive 2016-2017.pdf 62. Katalogu i Veprimtarive 2018-2019.pdf 63. Katalogu i Veprimtarive 2019-2020.pdf 64. Katalogu i Veprimtarive 2020-2022.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ,</p>	<p>Institucioni në mbarëvajtje të programin të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta dhe metoda të tërthorta të vlerësimit si sondazhe dhe intervista të studenteve dhe atyre të diplomuar, të personelit akademik, ndihmes akademik dhe administrative. Gjithashtu në metodat e tërthorta të përdorura nga KU IKT përfshihen: pyetësoret dhe anketimet, raportet vjetore, raporte vlerësimi programi, raporte vlerësimi prej stukturave</p>


<p>punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>drejtuese, vetëvlerësim i stafit akademik, pyetësorë me studentët Alumni, RVB për procesin e akreditimit, vlerësimet e studenteve alumni, gjurmimi i studentëve dhe mbledhja e të dhenave për punësim.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>77. Gjurmimi i studenteve të diplomuar nga IKT dhe NJSBC në 5 vitet e fundit.pdf (fq. 13-17 studentet e BA&amp;IT)</p> <p>74. Strategjia e Angazhimit të ALUMNI.pdf  <a href="https://cit.edu.al/alumni-spotlight/">https://cit.edu.al/alumni-spotlight/</a>  <a href="https://cit.edu.al/cit-alumni-on-focus/">https://cit.edu.al/cit-alumni-on-focus/</a>  <a href="https://cit.edu.al/alumni-association-march-2017/">https://cit.edu.al/alumni-association-march-2017/</a>  <a href="https://cit.edu.al/meet-our-alumni-of-the-faculty-of-economy-iris-dibra/">https://cit.edu.al/meet-our-alumni-of-the-faculty-of-economy-iris-dibra/</a>  RVB Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni (PDF-word).pdf</p> <p>80. RVB në Programin e studimit të Bachelor Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni (skanuar).pdf</p> <p>D3. Raport Institucional për MAS, 2018-2019.pdf</p> <p>27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni në funksion të sigurimit të cilësisë ka përfshirë dhe palët e treta por dhe studentët si një element shumë të rëndësishëm. Është i angazhuar dhe një ekspert i jashtëm për sigurimin e cilësisë. Në katalogjet e institucionit mund të shikojmë që ka organizuar disa herë tryeza të rrumbullaketa me bizneset dhe studentët në vite të ndryshme.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/Canadian-institute-of-technology-paid-an-visit-to-credins-invest/">https://cit.edu.al/Canadian-institute-of-technology-paid-an-visit-to-credins-invest/</a></p> <p><a href="https://cit.edu.al/highlights-of-financa-5-training-for-cit-alumni">https://cit.edu.al/highlights-of-financa-5-training-for-cit-alumni</a></p> <p>27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 për MAS.pdf (fq. 10-11)</p> <p>61. Katalogu i Veprimtarive 2016-2017.pdf</p> <p>62. Katalogu i Veprimtarive 2018-2019.pdf</p> <p>63. Katalogu i Veprimtarive 2019-2020.pdf</p> <p>64. Katalogu i Veprimtarive 2020-2022.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të tjera të angazhuara në sigurimin e</p>	<p>Institucioni ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët e tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë. Këto janë dhënë dhe në rregulloren institucionale</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>të cilat janë paraqitur më poshtë. Gjithashtu janë paraqitur dhe në Statutin e KU IKT.</p> <p>Përfshirja e studenteve në NJSBC ka qënë e hershme dhe siguron që zëri i tyre të dëgjohej në institucion.</p> <p>Përgjegjësitë dhe detyrat janë të përcaktuara në dokumentet bazë: Organizimi i NJSBC, Proçedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit, politikat dhe proçedurat e vetëvlerësimit, manuali i NJSBC.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>D4.1. VSA nr. 7, 24.09.2021.pdf (pika 15 për komisionet dhe komitetet)</p> <p>1. Statuti i KU IKT 2016.pdf (neni 28)</p> <p>1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar.pdf (neni 28)</p> <p>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 26-27)</p> <p>11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook.pdf (fq. 20-24)</p> <p>11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook.pdf (fq. 57-63 Modeli vetëvlerësimit të programit)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni KU IKT në NJSBC ka përbërje institucionale dhe ka përfshirje nga përfaqësues të të dy fakulteteve, një administratë dhe një student. Në të ardhmen ka paraqitur që mund të ngrejë një njësi për sigurimin e cilësisë për secilin fakultet.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 26-27)</p> <p>Statuti i KU IKT 2016.pdf (neni 28)</p> <p>11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook.pdf (fq. 20-24)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni KU IKT në NJSBC ka përbërje institucionale dhe ka përfshirje nga përfaqësues të të dy fakulteteve, një administratë dhe një student. Përfshirja e këtyre aktorëve në proceset e vlerësimit ruan integritetin akademik dhe shmang diskriminimin ose pabarazinë kundër personelit dhe studentëve. KU IKT nuk ka asnjë rast të ngritur të rregjistruar të diskriminimit apo pabarazisë së ushtruar ndaj personelit dhe studentëve. Institucioni i ka përfshirë studentet në të gjitha instancat kolegjiale dhe vendimarrëse.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf (fq. 26-27)</p> <p>Statuti i KU IKT 2016.pdf (neni 28)</p> <p>11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook.pdf (fq. 20-24)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Institucioni në sigurimin e cilësisë ka përfshirë dhe aktorë apo bashkëpunëtorë të jashtëm, në nivel eksperti.</p> <p>Programi Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni është vlerësuar prej komitetit të kurrikulave dhe mban dhe firmën e vlerësuesit të jashtëm.</p> <p>Tryeza dhe takime të ndryshme janë zhvilluar dhe me boneset dhe ato janë të dokumentuar dhe në katalogjet e veprimtarive.</p>

	<p><i>Evidencë:</i></p> <p>7. Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf(fq. 26-27)  Statuti i KU IKT 2016.pdf (neni 28)</p> <p>11. Manuali i Sigurimit te Cilesise - QAU Handbook.pdf (fq. 20-24)  61.Katalogu i Veprimtarive 2016-2017.pdf .  62. Katalogu i Veprimtarive 2018-2019.pdf  63. Katalogu i Veprimtarive 2019-2020.pdf  64. Katalogu i Veprimtarive 2020-2022.pdf</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Institucioni KU IKT politikat, strategjitë, organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe janë të publikuara në faqen e web-it të IKT dhe mund të shikohen nga të gjithë të interesuarit.</p> <p>Në këtë kategori janë të publikuara këto informacione:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• një historik i NJSBC</li> <li>• misioni i NJSBC</li> <li>• anëtarët e kësaj njësie</li> <li>• kompetencat që ajo ka</li> <li>• manuali i sigurimit të cilësisë</li> <li>• raporte vlerësimesh pyetësorësh ndër vite</li> <li>• raporti i pyetësorit me ALUMNI</li> </ul> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/">https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/</a>  11. Manuali i Sigurimit te Cilesise - QAU Handbook.pdf  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf</a>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Survey.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Survey.pdf</a>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Evaluation-of-administrative-staff.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Evaluation-of-administrative-staff.pdf</a>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/HIRING-PROCESS.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/HIRING-PROCESS.pdf</a>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/WELCOMING-A-NEW-HIRED.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/WELCOMING-A-NEW-HIRED.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Institucioni publikon Manualin e Sigurimit të cilësisë, ashtu si dhe të dhënat e tjera, si misioni, anëtarësia, kompetencat. NJSBC e KU shfaqet transparente për studentët e për të gjithë të interesuarit. KU IKT publikon të dhënat e përmbledhura prej raporteve të vlerësimit prej pyetësoreve, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe duke mos cënuar të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>dhënat personale.</p> <p>Vlerësimi individual i çdo stafi i shkon atyre personalisht në email-in e tyre zyrtar, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe të dhënat personale të stafit akademik. Më pas këto vlerësime të përmbledhura në analiza dhe raporte simestrale dhe vjetore i kalojnë njësisë bazë dhe rektoratit dhe diskutohet performance e institucionit dhe e përmbledhur në përqindje dhe e stafit akademik ose administrativ.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook.pdf  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/QAU-Handbook.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/QAU-Handbook.pdf</a>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf</a>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Survey.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Survey.pdf</a>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Evaluation-of-administrative-staff.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Evaluation-of-administrative-staff.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>KU IKT vlerësimet që kanë të bëjnë me programin e studimit, mësimdhënien, literaturën etj. i ka dhënë mundësinë që të shoqërohen me komente, vërejtje në rast se ka nga të cilat rrjedhin dhe masat që njësisia bazë dhe ajo kryesorja marrin parasysh dhe adresojnë për zgjidhje tek stafi akademik, akademiko-administrative, ai ndihmës ose tek studentet.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Evaluation-of-administrative-staff.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Evaluation-of-administrative-staff.pdf</a>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf</a>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Survey.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Survey.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni KU IKT i mundëson NJSBC takime dhe veprimtari periodike për ndërgjegjësimin e personelit akademik ashtu si dhe studentëve për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe programeve të studimit.</p> <p>Rekomandimet që merren nga pyetësorët janë detyrë e NJSBC, i institucionit dhe organeve drejtuese të tij që ti adresojnë në menyre të drejtë për të shmangur kërcënimet dhe dobësitë.</p> <p><i>Evidencë:</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Evaluation-of-administrative-staff.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Evaluation-of-administrative-staff.pdf</a>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf</a>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Survey.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Survey.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni me stafin akademik të departamenti të BA&amp;IT ka organizuar takime të ndryshme për të diskutuar procese të vlerësimit të programeve të studimit, vlerësimin e programit të lëndëve, si dhe rregulloret që standartizojnë sigurimin e cilësisë së IKT. Në fillim të vitit akademik NJSBC ka bërë dhe konsulta dhe trajnime të stafit akademik të të gjithë institucionit për të njohur hapat që merren për sigurimin e cilësisë, organizimin e programit mësimor, organizimin e programit të lëndës, si dhe aspekte të tjera të jetës e veprimtarisë akademike.</p>



	<i>Evidencë:</i> 11. Manuali i Sigurimit te Cilesise - QAU Handbook.pdf <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/QAU-Handbook.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/QAU-Handbook.pdf</a> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Evaluation-of-administrative-staff.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Evaluation-of-administrative-staff.pdf</a>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni" të Institucionit të Arsimit të Lartë "Kolegji Universitar Instituti Kanadez i Teknologjisë"**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Institucioni KU IKT stafin e ka të saj pothuaj 100% me kohë të plotë dhe vazhdon në mënyrë periodike të përmirësojë cilësinë e vet akademike duke i ofruar stafit trajnime të vazhdueshme lidhur me metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe trajnime profesionale në fusha të ndryshme.
2. Studentët dhe stafi akademik punojnë së bashku në projektet ku është përfshirë IAL IKT. Gjithashtu institucioni ka marrëveshje të ndryshme Erasmus+ dhe ka patur gjatë viteve shkëmbime për stafin akademik dhe për studentët me universitete të ndryshme.
3. Zhvillimi i mësimin në gjuhën angleze, me premisën që në të ardhmen të tërheqë më shumë studentë të vendit, por dhe të rajonit.
4. Infrastruktura e përshtatshme e mjediseve të mësimin, e laboratorëve dhe bibliotekës. IAL ofron mjedise mësimore dhe laboratorë informatike të pajisur me infrastrukturë të përshtatshme dhe të mbuluar nga rrjeti i internetit falas.
5. Institucioni KU IKT ka garantuar një qasje shume të mirë të studentëve dhe stafit të tyre akademik në librarine fizike dhe atë online, e pasur me tituj të ndryshëm për fushën e programit të studimit në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni. Vlen të theksohet dhe përfitimi i studentëve dhe stafit nga librarite online McGrawHill dhe O'Reilly.
6. Studentet që në fillim të angazhimit të tyre në institucion kanë një Keshillues Akademik (Tutor) dhe gjithashtu studentet kanë të drejtë të zgjedhin dhe një personel akademik në rolin e Dekanit të Studentëve, elemente që rrisin qasjen e tyre ndaj faciliteteve të institucionit dhe ndjekin zhvillimin e tyre akademik.
7. Përfshirja reale e studentëve në senatin akademik dhe në njësitë e komitetet e tjera. Kjo vendimarrje e institucionit i ka dhënë më shumë peshë vlerësimit, përfshirjes dhe mendimit të studentëve.

**Pika të dobëta:**

1. Institucioni bazohet vetëm në fee-të e studentëve dhe donacioneve nga ortakët për mbarëvajtjen e aktivitetit të tij.
2. Disa titullarë lëndësh/modulesh janë me gradën MSc.

**Rekomandime:**

1. GVJ sugjeron që shtohen burimet e financimit dhe të mos mbetet pesha më e madhe nga donacionet të aksionerve dhe fee-ve të studentëve.
2. Institucioni rekomandohet që të këtë angazhim më të madh në fushën e projekteve ose granteve të cilat të sjellin të ardhura permanente në institucion. Dhe të bëhet më shumë






- punë për të rritur numrin e regjistrimeve të studentëve që ndjekin studimet BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, kjo për të ndikuar në të ardhurat e IAL IKT, por dhe për të fuqizuar këtë program studimi dhe për ta përmirësuar më tej.
3. Duke qenë se disa titullarë lëndësh/modulesh janë me gradën MSc, në të ardhmen sugjerohet që titullarët e lëndëve/moduleve të jenë të paktën me gradën shkencore Dr.
  4. Sugjerohet që veprimtaritë formuese C (përqindjet e krediteve të lëndëve) të përshtaten sipas Vkm Nr.41, Datë 24.01.2018 - Për Elementët E Programeve Të Studimit Të Ofruara Nga Ial, e ndryshuar.
  5. Megjithëse IAL IKT ka bërë përpjekje të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, përsëri ka vend për përmirësimin dhe shtimin e titujve të librave në bibliotekë në literaturën fizike në gjuhën shqipe për të mbështetur nevojat e programit Bachelor në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni. Numri i vendeve/posteve, si dhe numri i kompjuterave / laptopëve është i vogël dhe sugjerohet shtimi i hapësirës /posteve /vendeve dhe kompjuterave /laptopëve në bibliotekë për t'i shërbyer sa më mirë navigimit të studentëve në burimet fizike dhe online të literaturës dhe për t'i dhënë mundësi një numri më të madh studentësh të aksesojnë burimet e bibliotekës në të njëjtën kohë.
  6. Sugjerohet që të caktohet me vendim një fond i caktuar për financimin e botimeve të pedagogëve për çdo vit akademik, duhet më shumë ndihmë financiare dhe angazhim praktik, real dhe promovim nga IAL për stafin akademik për botime të ndryshme në revista prestigjioze shkencore të huaja dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore.
  7. Institucioni përse i përket stafit të vet administrativ ka një numër të kufizuar stafi në shumicën e zyrave dhe shumica janë me një person permanent dhe në disa prej tyre përfshihen pjesërisht personeli akademik (për shembull ZBNj përbëhet nga vetëm 1 person dhe zyra ka hapësirë të vogël dhe GVJ sugjeron të shtohet staf në mënyrë që të përmbushen më mirë funksionet dhe përgjegjësitë e kësaj zyre).
  8. IKT dokumenton raporte të përvitshme financiare në nivel në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti, por duheshin të detajuara dhe për programin specifik të studimit BSc në Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni.
  9. Sugjerohet që në faqen ëeb të IAL IKT informacionet të publikohen dhe në gjuhën shqipe.
  10. Nga vëzhgimi i dokumentave, kriteret nuk parashikojnë regjistrimin e studentëve të trojeve, apo me aftësi të kufizuara & me status jetimi, gjë që sugjerohet të parashikohen në të ardhmen.
  11. RVB mund të hartohet më qartë dhe në mënyrë më të detajuar.

**Conclusions of the evaluation of the the first cycle study program Bachelor in “Business Administration and Information Technology” offered by the Higher Education Institution “Canadian Institute of Technology - CIT”**

**Strengths and affirmations:**



1. The institution has almost 100% full time staff engaged and continues to periodically improve its academic quality by providing staff with ongoing training on contemporary teaching methods and professional training in various fields.
2. Students and academic staff work together on projects where the institution is involved. The institution also has various Erasmus + agreements and has had over the years exchanges for academic staff and students with different universities.
3. Development of teaching in English, with the premise that in the future it is attractable more by foreigner students, but also of the region.
4. Adequate infrastructure of learning facilities, laboratories and library. The HEI offers learning facilities and computer labs equipped with appropriate infrastructure and covered by the free internet network.
5. The institution has guaranteed a very good access of students and their academic staff to the physical and online library, rich in different titles regarding the Business Administration and Information Technology field study program. It is also worth noting the benefit of students and staff from the McGrawHill and O'Reilly online bookstores.
6. Students at the beginning of their engagement in the institution have an Academic Advisor (Tutor) and also students have the right to choose an academic staff in the role of Dean of Students, elements that increase their access to the facilities of the institution and follow their academic development.
7. Real involvement of students in the academic senate and in other units and committees. This decision of the institution

#### **Weaknesses:**

1. The institution is based only on student fees and donations from partners for the progress of its activity.
2. Some course/modules are delivered by academic staff with MSc degree.

#### **Recommendations:**

1. EEG suggests increasing funding sources so that the institution's activity be covered not only by donors and students fees.
2. The institution is recommended to have greater commitment in the field of projects or grants which bring permanent income to the institution. To do more work to increase the number of enrollments of students attending BSc studies in Business Administration and Information Technology, so that it affects the institution's income, but also to strengthen this study program and to further improve .
3. Since some course / module holders have the MSc degree, in the future it is suggested that the course / module holders be at least with the scientific degree Dr.
4. It is suggested that the formative activities C (percentages of course credits) be adjusted according to DCM No. 41, Date 24.01.2018 - On the Elements of Study Programs Offered by the HEI as amended.
5. Although the institution has made significant efforts to increase the literature in the library, there is still room for improvement and addition of book titles in the library in the physical literature in Albanian to support the needs of the Bachelor program in Business Administration and Information Technology. The number of seats / posts as well as the number of computers / laptops is small and it is suggested to add space /



posts / seats and computers / laptops in the library to better serve students' navigation in physical and online literature resources and to enable a larger number of students to access library resources at the same time.

6. It is suggested to allocate by decision a certain fund for financing the publications of pedagogues for each academic year, more financial assistance and practical, real commitment and promotion from the HEI for the academic staff for various publications in prestigious foreign scientific journals and participation in scientific conferences are needed.
7. The institution in terms of its administrative staff has a limited number of staff in most offices and most are with one permanent person and some of them include partially academic staff (for example HR office consists of only 1 person and the office space is too small. EEG suggests adding staff in order to better fulfill the functions and responsibilities of this office).
8. The institution publishes annual institution, faculty and department financial reports, but the EEG recommends that such reports are drafted for study programs too.
9. It is suggested that the information be published in the Albanian language on the institution's website.
10. From the observation of the documents, the criteria do not foresee the enrollment of region students, or with disabilities & orphan status, which is suggested to be foreseen in the future.
11. The SER could be drafted more clearly and in more detail.



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				<b>X</b>
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				<b>X</b>
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				<b>X</b>
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				<b>X</b>
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				<b>X</b>
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>